

Vesna Kipa

Tatjana Novović

# HULUMTOJ MJEDISIN TIM

Natyra dhe shoqëria për klasën e tretë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore  
PODGORICË, 2012

Vesna Kipa • dr. Tatjana Novović

# ИСТРАЖУЈЕМ СВОЈУ ОКОЛИНУ

Природа и друштво за трећи разред основне школе

ПРИРУЧНИК ЗА НАСТАВНИКЕ

## HULUMTOJ MJEDISIN TIM

Natyra dhe shoqëria për klasën e tretë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT

<i>Botuesi</i>	Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë
<i>Kryeredaktor</i>	Aleksandar Çoguriq
<i>Redaktor përgjegjës</i>	Llazo Leković
<i>Redaktore</i>	Snezhana Martinović
<i>Redaktor në gjuhën shqipe</i>	Dimitrov Popović
<i>Recenzentë</i>	dr. Danka Xhakoviq dr. Zhelko Jaqimović Petar Shpadijer Ranka Bozhović Rada Mujović
<i>Ilustrimet</i>	Ozren Mizhdallo
<i>Përkthyes</i>	Zarija Brajović
<i>Disenjoja dhe përgatitja teknike</i>	Sllagjana Bajiq-Bogdanović
<i>Redaktor teknik</i>	Rajko Radullovic
<i>Për botuesin</i>	Nebojsa Dragović
<i>Shtypur në</i>	Shtypshkronja "Studio Mouse", Podgoricë
<i>Tirazhi</i>	50

**CIP – Каталогизacija у публикацији**

Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

**ISBN 978-86-303-1672-2**

**COBISS.CG-ID 20467216**

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin numër 16-2694 të datës 12. 06. 2012, e ka miratuar këtë Tekst mësimor për përdorim në shkollën fillore.



# PËRMBAJTJA

## **REKOMANDIME HYRËSE . . . . . 5**

## **MË SHUMË DIJE, MË SHUMË NJOHURI . . . . . 7**

Pas pushimeve . . . . .	10
Më shumë njohuri . . . . .	11
Shtëpia e dijeve dhe e shoqërimit . . . . .	12
Rregullat dhe marrëveshjet . . . . .	14
Shoqërimi dhe bashkëpunimi . . . . .	15
Gjyshja ka ditëlindjen . . . . .	17
Albumet na tregojnë . . . . .	18

## **PROFESIONI DHE HOBI . . . . . 20**

Punët që bën Jovani . . . . .	23
Dëshiroj të bëhem . . . . .	24
Blejmë . . . . .	25
Në fabrikë . . . . .	27
Ndihmojmë edhe ne . . . . .	28

## **NË FSHAT DHE NË QYTET . . . . . 30**

Moti ndryshon . . . . .	34
Në tregun e fruta-perimeve . . . . .	35
Në fermën blegtorale . . . . .	37
Vendbanimi im . . . . .	39
Festojmë . . . . .	41
Rruga "Njegosh" . . . . .	42
Udhëtojmë . . . . .	44



## **SHOH DHE DËGJOJ . . . . . 46**

Shikoj, shoh. . . . .	51
Vë vesh, dëgjoj. . . . .	52
Kujdesem për shëndetin . . . . .	54
Ku ka ajër? . . . . .	55
Uji ka avulluar . . . . .	57
Sheqeri është tretur . . . . .	59

## **MJEDISI IM . . . . . 60**

Malet dhe fushat. . . . .	64
Nga burimi deri tek grykëderdhja. . . . .	65
Era dhe shiu . . . . .	67
Po vjen pranvera. . . . .	68
Kompjuteri . . . . .	70
Grumbullojmë të dhëna. . . . .	71
Matim kohën . . . . .	72

## **KU JETOJNË?. . . . . 74**

Nën hijen e lisit . . . . .	77
Banorët e pyllit. . . . .	79
Lindja dhe Perëndimi . . . . .	80
Gjithnjë e më pak ka prej tyre . . . . .	82
Në breg të detit. . . . .	84

# REKOMANDIME HYRËSE


Ashtu sikurse edhe vitin e kaluar, kompleti mësimor i lëndës *Natyra dhe shoqëria* për klasën III të shkollës fillore nëntëvjeçare *Hulumtoj mjedisin tim 3*, përfshin Tekstin mësimor, Fletoren e punës dhe Librin e mësuesit.

Kompleti mësimor mbështetet në mënyrë logjike në dy të mëparshmit në kuptimin konceptual dhe në përmbajtjen didaktiko-metodike, ndërsa bazohet natyrshëm në ligjësitë e zhvillimit të procesit të të mësuarit dhe të njohjes tek nxënësit e kësaj moshe. Në përputhje me metodologjinë e njohur tashmë dhe me metodën holistike, temat e mësimorit i kemi integruar në kapituj të zgjeruar. Edhe ky Libër i mësuesit është hartuar me qëllim që mësuesve të kësaj lënde mësimore t'u ofrojë mbështetjen e plotë në procesin e krijimit të ambientit funksional për mësim dhe për arritjen e qëllimeve të Programit mësimor.

Libri i mësuesit ka gjashtë kapituj, që përmbajnë 37 tema mësimi dhe shoqëron Tekstin e mësimorit dhe Fletoren e punës, të cilët janë të konceptuara në të njëjtën mënyrë. Kapitujt, ashtu sikurse edhe në kompletet e mëparshme mësimore janë menduar si një e tërë e temave të lidhura në mënyrë logjike, në të cilat gërshetohen qëllimet me lëmin natyror, shoqëror e teknik të Programit mësimor, por edhe zhvillohen, zgjerohen e thellohen më tej nocionet, konceptet, kategoritë e përgjithësimet të përvetësuar më parë. Rikujtojmë, kjo është rruga funksionale e ndërmjetësimit të njohurive, të shkathtësive e të kompetencave me anë të nxitjes së fëmijëve për vrojtim, zbulim, arsyetim, krahasim e lidhje të aspekteve të ndryshme të nocioneve në rrjete e në koncepte të plota. Koherenca në parashtrimin e temave e të nocioneve në Tekstin mësimor dhe në Fletoren e punës duhet të mundësojë mësimin e menduar dhe efikas, t'i motivojë nxënësit dhe të ndihmojë në ndërtimin e strategjisë së përgjithshme të kuptimit të qëllimeve të Programit mësimor.

Gjatë konceptimit të Librit të mësuesit kemi pasur si qëllim që edhe këtë vit shkollor t'u ndihmojmë mësuesve në planifikimin, në renditjen, në kombinimin dhe në operacionalizimin e qëllimeve të Programit mësimor me anë të veprimtarive adekuate, të përshtatshme, zhvilluese e kontekstuale. Me qëllim që t'i zgjerojmë e t'i plotësojmë qëllimet operative ekzistuese të Programit mësimor të lëndës *Dituri natyre dhe shoqërie* për klasën e tretë të shkollës fillore dhe në përputhje me përvojën e mëparshme të njohur prej jush, kemi futur edhe këtu disa qëllime shtesë konkrete.

Lidhja e qëllimeve të Programit mësimor nga fushat e ndryshme mundëson integrimin e përmbajtjes nga lëmi natyror, shoqëror e teknik dhe përfaqëson pikënisjen për studimin e objekteve të ndryshme përmes shkollimit të mëtejshëm. Qëllimet dhe veprimtaritë brenda një kapitulli, përkatësisht të disa temave, mund të përfaqësojnë boshtet integruese për vendosjen e korelacioneve me fushat/objektet e tjera. Me këtë do t'u ndihmojmë nxënësve që në mënyrë më përfshirëse e më të përgjithshme ta shohin kuptimin dhe përmbajtjen e objekteve/fenomeneve të caktuara nga aspekte



të ndryshme. Plotësimi shkallë-shkallë dhe zhvillimi cilësor i hierarkisë së nocioneve, realizohet përmes procesit të arsyetimit e të veprimtarisë mendore të nxënësve në kuadër të ambientit cilësor të mësimit. Përvetësimi i qëndrueshëm dhe funksional i nocioneve është i mundshëm, nëse nxënësit e mbështesin përvojën e re mbi të vjetrën (të njohurën) dhe në atë kontekstualisht të afërt. Kriteret për ndërlidhje duhet të jenë të qarta e të sakta. Nocionet shkencore lindin mbi bazën e lidhjes së nocioneve spontane përmes zbatimit të analizës kauzale. Formimi siç duhet i nocioneve në mësim është kushti për përvetësimin e njohurive funksionale për sendet, për qeniet, për nocionet ose për proceset nga ana e nxënësve.

Pas këtyre fjalëve hyrëse të autoreve, në Librin e mësuesit do të gjeni shpjegimin më të hollësishëm për strukturën e çdo kapitulli, propozimin për Planin vjetor, si edhe listën e literaturës së shfrytëzuar.

Duke ndjekur logjikën konceptuale të Librave të mëparshëm të mësuesit *Hulumtojtë mjedisin tim*, edhe në klasën e tretë çdo kapitull përmban pjesën hyrëse, me shpjegimin për qëllimet dhe për përmbajtjet tematike. Trajtimi më i hollësishëm i çdo teme mësimi është dhënë përmes një vargu veprimtarish të propozuara dhe punës me Tekstin mësimor dhe me Fletoren e punës. Në fillim të çdo teme mësimi janë dhënë qëllimet e Programit mësimor që do të realizohen, si edhe nocionet kryesore. Pasonjë veprimtaritë e propozuara me anën e të cilave janë operacionalizuar qëllimet e parashikuara, ndërsa pastaj edhe shpjegimet për punën me Tekstin mësimor dhe me Fletoren e punës. Në fund të çdo teme mësimi janë dhënë mjetet e duhura të mësimit.

Veprimtaritë e propozuara mund të realizohen në klasë, në ambientin e shkollës, në oborrin e shkollës ose në natyrë të hapur. Me variacionin e formave e të strategjive metodike të ndryshme të punës, u ndihmojmë nxënësve që të orientohen më mirë në mjedisin e tyre shoqëror, t'i kuptojnë dhe t'i pranojnë ndodhitë shoqërore duke iu përshtatur atyre në mënyrë konstruktive.

Gjatë hartimit të veprimtarive të propozuara, duke e respektuar autonominë e mësuesit, kemi ofruar idetë për një angazhim të plotë të nxënësve gjatë zgjidhjes së situatave problemore, gjatë arsyetimit kritik, gjatë vlerësimit, gjatë argumentimit dhe gjatë krijimit të zgjidhjeve divergjente të afërta me përvojën e tyre dhe me specifikat e kontekstit shkollor e lokal.

Besojmë se edhe gjatë këtij viti shkollor do të arrini suksese në punë dhe se kompleti mësimor *Hulumtojtë mjedisin tim* për klasën e tretë do t'ju ndihmojë në realizimin e qëllimeve të Programit mësimor dhe në krijimtarinë e mësimdhënies. Ju urojmë sukses në punë!

Autoret



# MË SHUMË DIJE, MË SHUMË NJOHURI

Kapitulli i fillimit të kompletit mësimor për klasën e tretë me emërtimin **Më shumë di, më shumë njohuri** përbëhet nga 7 tema mësimi të përafërta, logjikisht të integruara, të cilat kanë lidhje me temat e mësimi të vitit të kaluar shkollor, duke i thelluar dhe duke i zgjeruar ato: *Pas pushimeve, Më shumë njohuri, Shtëpia e dijeve dhe e shoqërimit, Rregullat dhe marrëveshjet, Shoqërimi dhe bashkëpunimi, Gjyshja ka ditëlindjen, Albumet na tregojnë.*

**Qëllimet:** nxënësit/nxënëset\* i zgjerojnë njohuritë për jetën në mjedisin e ngushtë e të gjerë natyror e shoqëror; njohin trashëgiminë kulturore të mjedisit të vet; shpjegojnë mënyrat e mundshme vetjake të ndikimit mbi mjedisin natyror dhe shoqëror; mësojnë karakteristikat specifike të mjedisit bregdetar; gjejnë dhe sistemojnë informacionet për të kaluarën e afërt e të largët të familjes; pranojnë dhe respektojnë ndryshmet dhe trashëgiminë tjetërsoj familjare; njihen me mënyrën e punës së shkollës në të kaluarën; gjejnë informacionet duke shfrytëzuar burimet e ndryshme të dijeve.

Përvojat që kanë “grumbulluar” nxënësit gjatë pushimit veror do të na ndihmojnë që përmes kujtimeve interesante nga këto pushime, t’i kushtohemi së bashku hulumtimit të mjedisit të drejtpërdrejtë e të largët. Në fillim të vitit shkollor, kujtimet kanë të bëjnë zakonisht me ndodhitë e verës lidhur me detin. Ky është rasti që të flasim për Bregdetin e Malit të Zi. Si duket ai, deri ku shtrihet, si duken vendbanimet dhe qytetet, cilat janë karakteristikat klimatike të brezit të Bregdetit; cilat dhe ç’ujëra të këtyre viseve njohin, cilat kultura bujqësore mbillen në këtë zonë?

Nga Kepi Oshtra, vendi ku fillon Gryka e Kotorrit, bregdeti ynë zgjatet deri në kufirin me Shqipërinë, d.m.th. vendin ku lumi Buna derdhet në Detin Adriatik. Mbi breg, janë malet: Orjen, Llovqen e Rumi. Përgjatë bregut të detit, nga Ulqini, kalojmë pranë qyteteve: Bar, Petrovac, Budva, Tivat, Kotor, Perast, Risan, Herceg Novi. Aty janë edhe vendbanimet e shumta, lagjet e plazhet. Nga se dallohen këto vise prej viseve të tjera të Malit të Zi? Cilat janë karakteristikat specifike të zonës së Bregdetit?

Me nxënësit evokohen kujtimet për qytetet e Bregdetit ku ata kanë qenë, për karakteristikat e tyre specifike e interesante. Një nga qytetet më të vjetra në Bregdetin tonë është Ulqini, i cili shtrihet i harkuar pranë detit. Në qendër të qytetit është Plazhi i Vogël, ndërsa Plazhi i Madh, i gjatë mbi 13 km dhe njëkohësisht plazhi më i gjatë i Adriatikut, gjendet në jug të qytetit dhe zgjatet deri në grykëderdhjen e Bunës. Qyteti i vjetër është shumë interesant për shkak të arkitekturës së vet e të bedenave të veta që dëshmojnë për jetën në të kaluarën. Fusha pjellore e Ulqinit është e mbuluar nga kulturat e shumëllojshme bujqësore, nga perimet dhe pemishtat. Nxënësve u kujtojmë disa nga kulturat bujqësore që rriten në këto vise. Cilët drufrutorë mund t’i shohim shpesh në Bregdet? Pse këto drufrutorë rriten pikërisht në këto vise?

Në afërsi është Kriporja e njohur e Ulqinit.

Qytetet e Bregdetit, qendra turistike, të njohura për bukuritë e tyre të veçanta: Kotori, Perasti, Risani dhe Herceg Novi, janë të vendosura në brezin e Gjirit të Grykës së Kotorit.

\* Në tekstin në vazhdim nxënësit



Kotori gjendet poshtë shkrepave të Llovqenit. I nxitim nxënësit që ta përshkruajnë këtë qytet shumë të bukur turistik duke e ilustruar me kartolina, me fotografi e me video prezantime. Si duket qyteti i vjetër? U kujtojmë nxënësve se bedenat e gurtë kanë tri dyer. Sheshi i Armëve është më i madhi, ndërsa jo larg prej tij është sheshi në të cilin gjendet katedralja e Shën Tripunit, pajtorit të qytetit, me origjinë nga shekulli XII. Ndër të tjera, Kotorri ka një të kaluar të gjatë e të pasur, ndërsa e kanë themeluar romakët në shekullin II të erës sonë. Emërtimi i sotëm i qytetit është me origjinë sllave, kurse emërtimi antik i Kotorrit ka qenë Katarum.

Qyteti i Bregdetit; Perasti, i njohur për bukurinë vet dhe trashëgiminë historike unike, për pasurinë dhe shumëllojshmërinë e suvenireve që kanë sjellë lundëtarët e detit nga lundrimet e tyre të gjata, është gjithmonë interesant për vizitorët. Në afërsi të Perastit janë ishujt Shën Gjergji dhe Zonja e Shkërpjelit. Vetë perastët, duke i sjellë gurët deri tek shkëmbi i ujit, ngritën ishullin artificial (shkripio-gur), në të cilin ndërtuan kishën kushtuar Zonjës së Shkërpjelit, pajtores së qytetit të Perastit.


Vendbanimet Kamenari dhe Lepetani janë të vendosura në Ngushticën Verige dhe ndërmjet tyre qarkullojnë tragetet.

Shumica e qyteteve të Bregdetit të vendosur pranë detit, të rrethuar me bedena që i mbronin nga armiqtë, kanë pjesët e vjetra të qytetit që dëshmojnë për jetën në të kaluarën në këto territore. Me nxënësit bisedojmë për karakteristikat e varosheve të vjetër në qytetet e Bregdetit. I nxitim ata që të mendojnë dhe t'i krahasojnë ndërtesat e vjetra dhe ndërtimet e sotme. Ç'ndryshime vërejnë? Si dallojnë pjesën e vjetër nga pjesa e re e qytetit? U ndihmojmë nxënësve që, me ekipe, në grupe, të mendojnë dhe të përgatitin prezantimet për qytetet e Bregdetit.

Përballë hyrjes në Gjirin e Grykës së Kotorit, rrëzë shpatit të Orjenit, gjendet Herceg Novi, interesant për ndërtimet e tij specifike me shkallaret e shumta të rrëpira që lidhin rrugët dhe të çojnë drejt plazheve dhe detit.

I nxitim nxënësit që të kërkojnë vetë informatat për vendbanimet e veçanta të Bregdetit. Duke vrojtuar mjedisin përreth, drejtpërdrejt dhe më gjerë, duke kërkuar informatat për vendet e ndryshme, për vendbanimet në viset tona, nxënësit krahasojnë, hulumtojnë dhe njohin ndryshimet në mjedisin natyror e shoqëror. Kështu kanë rastin t'i zgjerojnë dhe t'i plotësojnë njohuritë e veta duke përvetësuar nocionet dhe konceptet e veçanta, t'i përdorin aftësitë e ndryshme sociale, ta dallojnë lidhjen shkak-pasojë midis ndodhive e dukurive të ndryshme. Gjithashtu, me pjesëmarrjen e vet aktive dhe me mësimin në situatat e ndryshme, në çifte e në grupe, nxënësit sprovajnë mundësit e veta të ndikimit mbi mjedisin dhe përftojnë një pamje reale për vetveten, për mundësitë e vetjake dhe për raportet me të tjerët e me mjedisin. Ata vënë re ngjashmëritë dhe dallimet midis individëve. Përmes shembujve të njerëzve të suksesshëm në fushat e ndryshme (p.sh. në sport), nxënësit shohin rëndësinë e përkushtimit, të durimit në punë dhe të këmbënguljes në rrugën për arritjen e qëllimeve të caktuara. Gjithashtu, duke parë se, krahas motivimit dhe të qenët i hapur para së resë, nevojitet durimi, planifikimi i kujdesshëm i kohës dhe renditja e detyrave. Në këtë rast, të mësuarit nuk ndodh vetëm në shkollë, por edhe në rrethanat e tjera të shumta. Prandaj ka rëndësi që ata t'i orientojmë drejt burimeve të ndryshme të dijes dhe mënyrave të kërkimit e të përdorimit të informatave të shumëllojshme (librat, revistat, interneti ...). Në kontekstin bashkëkohor, ne jemi dëshmitarë të ndryshimeve të shpejta, të zhvillimit në sferën e shkencës e të teknologjisë dhe se kemi rastin që brenda një kohe të shkurtër të marrim disa informata e të mësojmë përmes një shkëmbimi të pasur me mjedisin përreth. Falë mundësive të shumëfishta që ofrojnë mediet e ndryshme, mësuesve u krijohet mundësia të zbatojnë strategjitë e ndryshme metodike, të krijojnë larminë e formave të punës duke përdorur mjetet e ndryshme ndihmëse dhe internetin.






Meqë ky është viti i tretë që nxënësit janë të përfshirë në kolektivin e shkollës, ata e kanë shumë më të lehtë të mësojnë e të punojnë, sepse kanë vendosur reciprocitetin më cilësor e më të pasur në mjedisin e klasës. Ata shoqërohen, e ndihmojnë njëri-tjetrin në shkollë dhe jashtë saj. Nxënësit i përkasin tani më natyrshëm e më thellë komunitetin të klasës, e njohin mirë ritmin e organizimin e jetës shkollë dhe kuptojnë e përshtatin, harmonizojnë e plotësojnë vetë rregullat e sjelljes. Edhe më tej i nxitim ata, duke e demonstruar këtë gjë edhe me shembullin vetjak, që t'i harmonizojnë rregullat e jetës së përbashkët në klasë dhe në shkollë përmes respektit reciprok, shoqërimit, njohjes e respektimit të kërkesave të ndryshme, të të tjerëve e atyre tjetërsoj. Në këtë mënyrë, shkolla bëhet për ta shumë më e afërt dhe për të dinë shumë më tepër, edhe nga brenda edhe nga jashtë. Dinë se kujt, si, përse dhe kur mund t'i drejtohen në shkollë, kur një gjë e tillë është e nevojshme. Dinë më shumë për pozitën e shkollës në mjedisin lokal; qysh kur ekziston, ku ndodhet ajo, cilat institucione të rëndësishme janë në afërsi të saj, çfarë është karakteristike për të dhe e bën unike e të dallueshme, cilat janë datat e ngjarjet e rëndësishme nga e kaluara lidhur me shkollën e tyre (Dita e shkollës ...). Ata zhvillojnë edhe një qëndrim më të përgjegjshëm ndaj mjedisit përreth dhe ndaj trashëgimisë kulturore. Vënë re ndryshimet midis organizimit të dikurshëm e të sotëm të punës në shkollë. Dinë se ç'mundësi kanë në shkollë dhe si mund t'i ndjekin interesimet e veta të veçanta përmes veprimtarive të veçanta, rretheve jashtëshkollë, mësimi shtesë e veprimtarive sportive.

Për t'u njohur, kuptuar e shoqëruar edhe më mirë, është e nevojshme që edhe prindërit e nxënësve të jenë më të përfshirë në jetën e shkollës. Familjet tona ndryshojnë për nga trashëgimia e vet, për nga zakonet, për nga struktura, për nga profesionet dhe për nga datat familjare. Reciprocitetin më cilësor në komunitet do ta realizojmë, nëse i pranojmë dhe i respektojmë ndryshimet. Familjen e ngushtë e bëjnë më shpesh prindërit dhe fëmijët. Diku jetojnë nën të njëjtën çati edhe prindërit e prindërve tanë ose vëllezërit dhe motrat e prindërve tanë. Kjo është familja e zgjeruar. Prej kushërinjve më të moshuar mësojmë më shumë për mënyrën e jetesës, për lojërat, për përvojat shkollë dhe për kushtet e jetesës në të kaluarën. Tringu familjar është "piktura" e familjes sonë të tashme, por edhe e të kaluarës, e paraardhësve dhe e kushërinjve në linja prindërore.

Por, të rikujtojmë se vitin e shkuar kemi mësuar edhe për format e tjera të familjes, për familjet jo të plota, të adaptuara e të rikonstruara. Pavarësisht nga numri dhe nga struktura e familjes, mbi funksionalitetin e saj ndikon gatishmëria e anëtarëve të saj, që të mbështeten e të ndihmohen reciprokisht në vartësi të mundësive.



# PAS PUSHIMEVE

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihet rëndësia e trashëgimisë</li><li>• të dihet se cilat janë ujërat e vendbanimit</li><li>• të bëhet lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatin e tyre</li><li>• të vihet re sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën e vendbanimit të vet</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	det, bregu i detit, plazh, dallgë (valë), traget, skelë, bota bimore e bregdetit, turist

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit bisedojnë për përvojat vetjake gjatë pushimeve verore. Në ç'vend kanë qenë për pushime? Me se kanë udhëtuar? Sa ka zgjatur udhëtimi? Ku kanë qenë të vendosur? Në ç'plazh janë larë? Ç'plazh është ky? Ç'lojëra kanë luajtur në plazh? A kanë mundur të bëjnë figura prej rëre? A mund të bëhen figura prej rëre në çdo plazh? Pse nuk mund të bëhen figura në plazhin me zhavorr? Sa kohë kanë qëndruar në plazh? Kur ka më shumë njerëz në plazh? Kur janë larguar nga plazhi? Pse pikërisht atëherë? Kur nuk duhet të qëndrojnë kurrsesi në plazh? Pse? Si duket plazhi në mëngjes dhe si para mbrëmjes?
2. Përshkruhen karakteristikat e ujit të detit (i ngrohtë, i ftohtë, i kripur, i njelmët, i tejdukshëm) dhe dukuritë tek uji (dallgët; valët, batica, zbatica, por pa këmbëngulur për termat). A e ka deti burimin dhe grykëderdhjen?
3. Bisedohet për bimët bregdetare (agrumet, fiku, ulliri, kamelia, mimoza), të cilat nuk ekzistojnë ose janë të rralla në vendbanimin e tyre. Pse nuk ka prej këtyre bimëve në vendbanimin e tyre? A u pengon apo u mungon diçka atyre në vendbanimin e tyre?
4. Tregohet përvoja vetjake e pakëndshme (ose e turistëve të tjerë) me iriqa deti, me kandila deti dhe me kafshët e tjera të detit.
5. Përshkruhet pamja e shtëpive të bregdetit, ku janë ndërtuar, me çfarë janë ndërtuar, bëhen supozime përse janë të vogla dritaret.
6. Nxënësit që kanë mbledhur gurë, guaska, kërmij, lëvozhga iriqësh etj. i sjellin ato në shkollë dhe bëjnë koleksionin e klasës. Vërehen ngjashmëritë dhe dallimet në pamje (të përbëra nga një pjesë, nga dy pjesë, të ashpra, të lëmuara, njëngjyreshe ...).
7. Mblidhen kartolinat e qyteteve të Bregdetit dhe formohet stenda e klasës. Vërehen ngjashmëritë dhe dallimet në pamjen e qyteteve, të plazheve dhe të territoreve në të cilat ndodhen.
8. Bisedohet për vendet e tjera, ku nxënësit i kanë kaluar pushimet; në bjeshkë, në fshat, pranë liqeneve, pranë lumenjve. Si e kanë kaluar kohën atje?
9. Bisedohet për librat që kanë lexuar gjatë pushimeve verore. Çfarë u ka pëlqyer më shumë. Cilin libër do t'ia rekomandonin shokëve të vet.

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit shohin fotografitë dhe vizatimet, me të cilat Markoja dhe Ana tregojnë për përjetimet e veta gjatë pushimit veror në det.

Ku i ka kaluar pushimet Markoja? Në ç'plazh është larë? Si është rëra e këtij plazhi? Pse është mbuluar me rërë gjyshi i tij? Kur s'ka guxuar të lahet Markoja dhe pse? Për ç'gjë është e rëndësishme Ada e lumit Buna? Nxënësit që i kanë kaluar pushimet verore



në Ulqin, tregojnë përvojën e vet. Çfarë kultivohet në rrethinën e Ulqinit? Kush kanë qenë piratët? Për piratët e Ulqinit mund të lexohet në revistën “Nacionalna geografija – junior” nr. 5.

Ku i ka kaluar pushimet Ana? Si ka udhëtuar deri në Herceg Novi? Me ç’rrugë tjetër ka mundur të shkojë? Nëpër cilat qytete do të kalonte atëherë? Në cilin qytet ka parë shfaqjen e fëmijëve? Cilat pemë rriten në oborrin e shokut të tyre? Ç’pemë të tjera rriten në Bregdet? Pse pikërisht atje? A njihni ndonjë bimë tjetër bregdetare? Ku nuk ka mundur të lahet Ana dhe pse?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Me vizatim pasqyrohet pushimi veror vetjak. Ky mund të jetë vendi ku është pushuar, ngjarja ose veprimtaria që është mbajtur mend apo diçka tjetër që nxënësi kujton të parën kur mendohet vera.
2. Plotësohet fjalja dhe përshkruhet pushimi veror.
3. Duke zhvendosur shkronjat, zbulojnë dhe shkruajnë fjalët: dallga, plazhi, Ulqini, fiku, Budva, skela, Kotori, palma, pulëbardha.

## **MË SHUMË NJOHURI**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të kuptohet se për një mësim të suksesshëm nevojitet planifikimi i duhur i kohës</li><li>• të mësohet sesi duhet të planifikohet në mënyrën e duhur koha për mësim, për lojë dhe për pushim</li><li>• të vihet re se krahas njohurive që merren në shkollë, mund të shfrytëzohen edhe burimet e tjera të njohurive (pjesëtarët e familjes, farefisi, libri, mediet)</li><li>• të dihet të bëhet planifikimi i veprimtarisë ditore</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	njohje, zbulim, dije, mësim, burimi i dijes, orari i punës, rregull (rregullsi), rend, pushim.

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Bisedohet për kohën e lirë dhe për mënyrën sesi kalohet ajo. Me ç’veprimtari merren nxënësit në kohën e lirë? Sa kohë të lirë kanë gjatë ditës? Si e kalojnë kohën e lirë prindërit e tyre? Kush ka më shumë kohë të lirë gjatë ditës dhe pse? Si dhe sa shpesh e kalojnë së bashku kohën e lirë?
2. Cilat burime të njohurive mund të shfrytëzohen jashtë shkolle? Si mund të ndihmojnë prindërit dhe të rriturit në përvetësimin e njohurive? Prej kujt, ku dhe si kanë mësuar më shumë (prej prindërve, prej vëllezërve e motrave, prej miqve, prej librave, në shkollë, nga kompjuteri ...).



3. Cilat veprimtari kanë dëshirë t'i kryejnë në kohën e lirë, por nuk mundën. Pse nuk mundën?
4. Bëhen përpjekje për përcaktimin e dallimit ndërmjet mësimit dhe njohurive. Çfarë ke mësuar dhe çfarë di tani? P.sh., kam mësuar rrotullimin prapa, tani di rrotullimin para, ose mësoj anglisht, ndërsa di të flas në gjuhën malazeze. Kur e di diçka? Kur di ta bësh një gjë vetëm?

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihet me vëmendje dhe përshkruhet vizatimi. Me kë është në dhomë Ana? Çfarë duhet të bëjnë ato që dhoma të jetë e rregullt. Cila prej të dyjave është më e rregullt? Nga se nxirret ky përfundim? Ç'stërvitje bën Ana? Sa herë e bën stërvitjen? Si ndjehet ajo pas stërvitjes?

Shihen figurat në të cilat janë paraqitur mënyrat sesi mund të fitohen dijet. Çfarë bën Ana në kohën e lirë? Si e organizon ajo punën? Cilat janë detyrat e saj për ditën pasardhëse? Nxënësit tregojnë sesi e organizojnë ata punën. Pse duhet të planifikohen detyrat? A ju ndihmon dikush tjetër për të bërë planifikimin?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Shihet tabela Java e Markos. Lexohet sqarimi poshtë tabelës. Thuhet se cilat janë detyrat e Markos për çdo ditë të javës? Kur shkon në shkollë? Kur bën stërvitje futbollit dhe kur shkon në shkollën e muzikës? Cilit instrument i bie Markoja. Në cilat ditë bën ushtrime në piano në shtëpi? Në cilat ditë ka më shumë kohë të lirë? Çfarë bën në orët e mbrëmjes? Cilat janë detyrat e Markos për fundjavë? Plotësohet tabela e detyrave të Markos.
2. Plotësohet tabela e detyrave vetjake gjatë ditëve të javës. Shkruhet kur ka më shumë dhe kur më pak kohë të lirë. Si kalohet fundjava? Krahasohen tabelat e nxënësve.

## **SHTËPIA E DIJEVE DHE E SHOQËRIMIT**

### **Qëllimet:**

- të dihet emërtimi i lagjes ose i pjesës së qytetit në të cilën gjendet shkolla
- të dihet emërtimi i rrugës në të cilën gjendet shkolla
- të dihet të shpjegohet rruga deri në shkollë
- të dihet sesi është dukur shkolla në të kaluarën
- të vihen re dallimet në pamjen e shkollës dikur dhe sot
- të dihet sesi festohet Dita e shkollës
- të thuhet njerëzit me rëndësi të vendbanimit, që kanë qenë nxënës të shkollës.
- të dihet se në shkollë mund të luhet dhe të merresh me sport
- të dihet se në shkollë ekziston koha e punës, e veprimtarive të lira dhe e pushimit

**Fjalët kyçe:**

të punësuarit në shkollë, drejtor/drejtoreshë, mësues/mësuese, psikolog/psikologe, pedagog/pedagoge, logoped/logopede, bibliotekar/bibliotekare, punonjës/punonjëse, kujdestar/kujdestare\*, të drejtat shkollore, detyrat (detyrimet) shkollore.

**Veprimtaritë e propozuara:**

1. Bisedohet për pozicionin e shkollës në raport me qendrën e vendbanimit dhe me ndonjë objekt të rëndësishëm. Përshkruhet rruga nga shtëpia deri në shkollë, emërtohen objektet e rëndësishme pranë të cilave kalohet. Komentohet pamja e jashtme e shkollës, materiali prej të cilit është ndërtuar, numri i kateve, vendosja e ambienteve, oborri i shkollës etj.
2. Në Ditarin e shkollës kërkohen të dhënat për shkollën dikur (fotografi, kur e ka filluar punën, sa nxënës ka pasur, numri i të punësuarve). Sipas kujt ose sipas ç'gjëje e ka marrë emërtimin shkolla?
3. Vizatohet grafiku për numrin e nxënësve në periudhën, kur shkolla e ka filluar punën dhe tani. Krahasohet numri i nxënësve dikur dhe sot.
4. Nxënësit hartojnë listën e pyetjeve që do t'u bëjnë të punësuarve në shkollë (Me ç'punë merreni? Ç'shollë kërkohet për ta kryer këtë punë? Sa vjet zgjat shkollimi për këtë profesion? Pse keni zgjedhur pikërisht këtë profesion? Çfarë është e bukur dhe çfarë është e vështirë në këtë profesion? Cilat janë kushtet e nevojshme për punë? I luten të punësuarit, që t'u tregojë ndonjë ndodhi interesante). Nxënësit ndahen në grupe. U bëjnë vizitë të punësuarve në shkollë (mësuesit, drejtorit, sekretarit të shkollës, pedagogut, psikologut, logopedit, bibliotekarit, kujdestarit të shkollës, punonjësit të mirëmbajtjes së higjienës), bisedojnë me to dhe paraqitin raportin.
5. Ftohet në klasë drejtori/drejtoresha e shkollës dhe bisedohet me të për disa personalitete të rëndësishme, që kanë qenë nxënës të shkollës së tyre.

**Puna me Tekstin mësimor:**

Bisedohet për fotografitë dhe për vizatimet. Vihet re, sesi është mësuar dikur dhe si mësohet tani. Çfarë është e ngjashme dhe çfarë ndryshon? Çfarë pëlqehet më shumë që të bëhet në shkollë?

Bisedohet për rëndësinë e bibliotekës dhe për respektimin e rregullave që vlejnjë për marrjen e librave. Pse ka rëndësi që libri të kthehet në kohën e caktuar? Pse ka rëndësi që të ruhen librat që merren në bibliotekë. A i keni dhuruar ndonjëherë libër bibliotekës? Cilat libra mund të dhurohen?

Cilët nga pjesëtarët e familjes kanë mësuar në shkollën tuaj? Lexohet teksti i shkruar pranë fotografisë së Dejan Radonjiqit. A ka ardhur ndonjë personalitet i njohur në shkollën tuaj?

Shikohen fotografitë. Lexohet sesi shkolla "Meksiko" e feston Ditën e shkollës. Si festohet në shkollën tuaj Dita e shkollës?

\* Në vazhdim do të shkruhet drejtor, mësues, pedagog, psikolog, logoped, bibliotekar, punonjës, kujdestar



### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Lexohet teksti i shkruar. Vihet re vendi ku shkruhet adresa si dhe renditja e të dhënave. Ku ngjitet pulla postare. Supozohet se pse duhet të blihet e të ngjitet patjetër pulla postare. Shërbimi i kujt paguhet në këtë mënyrë? Shkruhet kartolina dhe dërgohet në adresë të shkollës.
2. Shkruhen të dhënat për Ditën e shkollës. Vihet re se fjala dita është shkruar më shkronjë të madhe, pasi kjo është një ditë e përcaktuar veçmas.

## **RREGULLAT DHE MARRËVESHJET**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të kuptohet se duhet të respektohen kërkesat dhe të drejtat e tjetrit në kolektiv</li><li>• të kuptohet se duhet të ruhet pasuria shkollore</li><li>• të zhvillohet ndjeshmëria për respektimin e rregullave kryesore të shkollës (frekuentimi i rregullt i mësimit, ardhja në kohë në mësime, sjellja në shkollë dhe jashtë shkollës)</li><li>• të arrihet në përfundimin se jeta në shkollë zhvillohet sipas orarit të caktuar, i cili duhet të respektohet detyrimisht.</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	rregull, marrëveshje, bashkëpunim, detyrë, votim, shumicë

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Bisedohet për sjelljen në shkollë dhe jashtë saj. Jepen shembuj të sjelljes së dëshiruar e të padëshiruar si edhe pasojat (për pronën e shkollës dhe për shoqërimin).
2. Nxënësit bëjnë propozimet për shikimin e filmit në klasë. Propozimet shkruhen në dërrasë të zezë dhe votohet.
3. Bisedohet për mënyrën e arritjes së marrëveshjeve në shtëpi. A marrin pjesë nxënësit në arritjen e këtyre marrëveshjeve. (Nëse nuk marrin pjesë, a do të dëshironin të merrnin pjesë.) Përse bëhen më shpesh marrëveshjet? Nxënësit duhet të kuptojnë rëndësinë e arritjes së marrëveshjeve, sidomos kur bëhet fjalë për grupet e mëdha.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Lexohet teksti i shkruar. Ku ka propozuar Markoja që të shkojë klasa? Çfarë tjetër ka propozuar? Si kanë vendosur, ku do të shkojnë? Cili propozim ka marrë më shumë vota? A ka votuar mësuesja? Nxënësit duhet të kuptojnë se fiton propozimi që ka fituar numrin më të madh të votave.



### Puna me Fletoren e punës:


1. Supozohet se cila është arsyeja që Aleks i ka ardhur me vonesë në shkollë. Thuhet shkakët e vonesave vetjake. Shkruhen detyrat (detyrimet) dhe të drejtat vetjake në shkollë.
2. Shkruhen rregullat që nuk respektohen në figurat ilustruese (nuk ruhet pasuria e shkollës, nuk tregohet kujdes për mjedisin). Ç'pasoja ka kjo gjë? Çfarë do të ndodhte po ta bënin këtë gjë të gjithë? A sillen po kështu edhe në shtëpi? Pse?
3. Shkruhen rregullat e sjelljes që duhet të respektohen në klasë.
4. Me votim vendoset se cila kafshë do të mbahet në Këndin e gjallë të klasës. Rezultatet e votimit shkruhen në dërrasë të zezë. Shkruhet kanakari që ka fituar më shumë pikë.

## SHOQËRIMI DHE BASHKËPUNIMI

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të dallohet kolektivi i klasës si komunitet</li><li>• të zhvillohet të diturit se në shkollë fitohen dije të reja, njohje të reja dhe miq të rinj</li><li>• të vihet re nevoja e bashkëpunimit dhe e tolerancës në kolektivin e klasës</li><li>• të kuptohet se përse duhet të respektohen kërkesat dhe të drejtat e tjetrit në kolektiv</li><li>• të kuptohet se shoqëria nënkupton gatishmërinë për ta ndihmuar tjetrin dhe për të bashkëpunuar me të</li><li>• të kuptohet se në shkollë mund të kërkohet ndihma e mësuesit, e psikologut, e pedagogut, e bibliotekarit dhe e logopedit</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	shoqëri, bashkëpunim, tolerancë, komunitet, kolektiv

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Bisedohet për emërtimin e klasës (paraleles); shpjegohet se ç'kuptim kanë numri dhe shkronja në emërtimin e klasës. Sa nxënës ka klasa? Sa djem dhe sa vajza ka në klasë? Sa paralele të tjera të së njëjtës klasë janë në shkollë? Nxënësit duhet të kuptojnë se klasa (paralelja) e tyre përfaqëson komunitetin e nxënësve. Ç'komunitete të tjera njihen?
2. Bisedohet se me kë shoqërohen më shumë nxënësit në shkollë. A shoqërohen me nxënësit e klasave të tjera? Në ç'klasë dhe në ç'paralele shkojnë ata? Ku i kanë njohur ata? Tash sa kohë shoqërohen? Si janë bërë shokë?
3. Loja me role. Në fletë letre shkruhen situatat problemore karakteristike në shkollë.
  - Je grindur me shokun në oborrin e shkollës. Si mund të zgjidhet ky problem? Kujt do t'i drejtohesh?
  - Ke lënduar gjurin. Kujt do t'i drejtohesh?
  - Nuk e ke librin që të duhet për lexim jashtë klase. Kujt do t'i drejtohesh?



- Para orës së mësimi të fizkulturës nuk ndjehesh aspak mirë, të djersijnë duart. Kujt do t'i drejtohesh?
- Duhet të shkruash për të kaluarën e shkollës sate. Kujt do t'i drejtohesh?
- Dritarja e klasës nuk mund të hapet. Kujt do t'i drejtohesh?
- Dikush ka derdhur në shkallë lëngun e frutave. Kujt do t'i drejtohesh?

Disa nxënës janë në rolin e të punësuarve të shkollës, kurse disa nxënës tërheqin fletët e letrave në të cilat është e shkruar situata problemore. Nxënësit duhet të kuptojnë se për ç'problem bëhet fjalë dhe se kujt duhet t'i drejtohen. Nxënësit e tjerë vlerësojnë dhe shkruajnë sjelljen e reagimin e nxënësve që janë në rolin e të punësuarve. Në fund të lojës thonë mendimet e veta për mundësitë e zgjidhjes së problemit.

4. Në fletët e letrave shkruajnë emrat e të gjithë nxënësve të klasës. Nga kutitë tërhiqen fletët e letrës. Detyra është që në po të njëjtën letër të shkruajnë një fjali lavdërimi për nxënësin, emri i të cilit është në fletën e letrës. Fletët e letrës i ngjitin në stendë.
5. Në stendën e klasës shkruhen rregullat e sjelljes lidhur me respektimin e ndryshimeve.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen figurat ilustruese në Tekstin mësimor. Lexohen tekstet e shkruara dhe komentohen situatat. Thuhen mendimet për sjelljen e nxënësve. Si do të sillëshin ata, po të ishin në vendin e tyre? Cila sjellje ju ka pëlqyer dhe pse? Cila nuk ju ka pëlqyer? A jeni gjendur ndonjëherë në një situatë të ngjashme? Kush u ka ardhur në ndihmë? Si jeni ndjerë, nëse dikush ju ka përqeshur dikur? Si ndjeheni, kur nuk mund të kryeni diçka? (Të trishtuar, të inatosur, përpiqeni përsëri, kërkoni ndihmën e ...). Flitet për atë që mendohet kur thuhet fjala tolerancë.

### **Puna me Fletoren e punës**

1. Me zhvendosje e shkronjave shkruhen fjalët e duhura në fjalëkryq (stoli, shkolla, zilja, mësuesi, harta, tabela, banka, secili, librat) dhe zbulohet zgjidhja (toleranca). Shkruhet zgjidhja përfundimtare.
2. Qarkohet shkronja para asaj që mendohet se është përgjigjja e saktë (b). Komentohen përgjigjet. Pse ka rëndësi që të tregohemi tolerant?
3. Shkruhet sesi tregohet toleranca nga ana e nxënësve.



# GJYSHJA KA DITËLINDJEN

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të dallohet familja si komunitet</li><li>• të dallohen profesionet e prindërve e të kushërinjve</li><li>• të vihet re nevoja e bashkëpunimit dhe e tolerancës ndërmjet anëtarëve të familjes</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	rregull, marrëveshje, bashkëpunim, detyrë (detyrim), votim, shumicë

## Veprimtaritë e propozuara:


1. Nxënësit shohin albumet familjare dhe bisedojnë për paraardhësit (të parët) e vet. Njerëzit kanë fotografuar dikur shumë më pak sesa sot. Për ç'raste janë bërë fotografi? (festa familjare, piknikë, ekskursionet, shkollim ...) Me cilin prej paraardhësve të vet ngjasojnë? Ç'gjë kanë të përbashkët? Cilat karakteristika nuk shihen në fotografi? (sjellja, aftësitë). Emërohen kushërinjtë nga ana e babait dhe e nënës. Me cilët prej kushërinjve kanë afri gjaku (daja, halla, xhaxhai, tezza dhe fëmijët e tyre) dhe me cilët nuk kanë afri gjaku (dajesha, xhaxhesha, burri i hallës, burri i tezes).
2. Bisedohet për ditët, kur familja e gjerë mblidhet bashkë. Për ç'raste mblidhen më shpesh? Ku mblidhen? Pse u gëzohemi grumbullimeve të tilla? Tregohet përvoja për rolin e familjes së ngushtë e të gjerë në grumbullimin e tyre. Me kë keni kaluar më shumë kohë? Çfarë ju ka mbetur në kujtesë prej tyre? Si ua shpërblejmë këtë? Cili është qëndrimi i tyre tani? Sa shpesh janë bashkë?
3. Bisedohet për marrëdhëniet e bashkëpunimit e të tolerancës në familje. Tregohen problemet me të shpeshta në komunikimin ndërmjet anëtarëve të familjes dhe si i zgjidhin ato.
4. Përgatitet trangu me fjalët e bukura drejtuar anëtarëve të familjes.
5. Organizohet "loja me role"; konfliktet në familje dhe si duhet të zgjidhen ato.

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit vënë re, se ekzistojnë familjet e gjera e të ngushta. Nxjerrin përfundimin, se familja është komuniteti i prindërve dhe i fëmijëve të tyre. Anëtarët e familjes janë të lidhur midis tyre. Në familje respektojmë kërkesat e të tjerëve dhe me këtë shfaqim nderimin dhe dashurinë. Çfarë bën familja e Anës? Përse duan ta gëzojnë gjyshen për datëlindje? Si mund ta shfaqim respektin dhe t'i gëzojmë personat që duam pa e pritur ditëlindjen.

Shpjegohet trangu familjar i Anës dhe i vëllait të saj. Thuhen anëtarët e familjes së babait dhe të nënës. Ç'lidhje afrie kanë Ana dhe vëllai i saj me anëtarët e familjes së babait dhe të nënës? A mund të zgjerohet trangu familjar (familja e dajës, e xhaxhait, e hallës dhe e tezes, prindërit e gjyshes dhe të gjyshit)?

Në bazë të vizatimeve të situatave të zakonshme ndërmjet fëmijëve, vihet tek të diturit se duhet të respektohen dhe të nderohen kërkesat e të tjerëve. Jepen shembuj të sjelljeve në familje.



### Puna me Fletoren e punës:


1. Nxënësit shkruajnë në trungun familjar emrin e vet, emrat e prindërve dhe të kushërinjve të afërt; plotësojnë fjalitë.
2. Shkruhen propozimet për sjelljen në situata të ndryshme.
3. Shkruhet shenja pranë veprimtarive që nxënësit kryejnë në shtëpi (kurrë, nganjëherë, rregullisht). Shënohen veprimtaritë sipas dëshirës. Krahasohet tabela vetjake me tabelën e shokut/shoqes.

## ALBUMET NA TREGOJNË

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të dallohen e të vlerësohen sendet që i kanë takuar të parëve të nxënësve (reliket, stolitë dhe veshjet e vjetra)</li><li>• të njihet mënyra e jetesës, e veshjes dhe e argëtimit e gjysheve dhe te gjyshave</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	trashëgimi, muze, kustos, shiriti i kohës (lenta), album, ilaçi popullor.

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Përgatitet shiriti i kohës dhe shënohet në të me një lloj ngjyre koha, kur kanë lindur ata vetë, me një ngjyrë tjetër viti kur kanë lindur prindërit e tyre, ndërsa me një ngjyrë të tretë viti kur kanë lindur gjyshet dhe gjyshat.
2. Hartohen me ndihmën e mësuesit pyetjet për intervistën me një person të moshuar. Sa vite kanë kaluar nga koha, kur i ftuari ka qenë në moshë të tyre? Si kanë luajtur në atë kohë? Me çfarë kanë luajtur? Prej çfarë punoheshin lodrat? Ku i siguronin ato? Ç'lodra kanë bërë ata vetë? Kush u ndihmonte që t'i bënin lodrat? Si janë veshur? Prej ç'materiali ishte veshja? Si i kishin këpucët? Prej çfarë punoheshin ato? Ku i blinin ato? Cila ka qenë gjella e tyre e preferuar? Çfarë nuk u pëlqente të hanin? Në ç'gjë përgatitej ushqimi? Si e ruanin ushqimin që të mos prishej? Si janë mjekuar? Si janë argëtuar kur janë rritur? Me çfarë janë marrë prindërit e tyre?
3. Ftohet për vizitë një person i moshuar (gjyshi/gjyshja, ose stërgjyshi/stërgjyshja e ndonjë nxënësi). Bisedohet me të për jetën dhe për punën e të parëve të tyre.
4. Sillen në klasë albumet familjare me fotografitë e të parëve. Shihen ndryshimet në punimin e fotografive dikur dhe tani (bardhezi dhe me ngjyrë, të regjistruara në disketë). Vihet re mënyra e veshjes së personave në fotografi, stolitë, këpucët ... .
5. Grumbullohen dhe sillen sende të së kaluarës, bisedohet për materialin, punimin dhe përdorimin e tyre dhe përgatitet koleksioni i klasës me sendet dhe me objektet e së kaluarës. Mund të grumbullohen edhe monedhat e vjetra. Krahasohen monedhat dhe kartëmonedhat e vjetra me monedhat dhe me kartëmonedhat që përdoren sot.
6. Grumbullohen fotografi e vizatime të veshjeve popullore dhe përgatitet stenda e klasës.

- 
7. Nëse mund të realizohet, organizohet vizita në Muzeun e Vendit ose në Qendrën Arkeologjike (në vendbanimet ku nuk ekzistojnë institucionet e tilla, nxënësit i shohin ato të filmuara).
  8. Lexohen tekstat e shkruara, interesante për jetën e njerëzve të vendbanimit në të kaluarën.
  9. Mblidhen receta për përgatitjen e gjellëve e të pijeve të vjetra.
  10. Modelohet ose vizatohet ndonjë send a objekt nga e kaluara.
  11. Njihen me mjekimin në të kaluarën dhe me ilaçet popullore të përdorura më shpesh.
  12. Nxënësit përfshihen në veprimtarinë e rrethit folklorik. Mund të organizohet vizita në ndonjë Shoqëri kulturore-artistike, ku mund të bisedohet me koreografin dhe me interpretuesit për shfaqjet që ka dhënë ansambli i tyre në qytetet ku kanë qenë.
  13. Interesohen për lojërat e fëmijëve në të kaluarën (emërtimi i lojës, numri i nxënësve, rregullat e lojës) dhe hartojnë Librin e klasës.
  14. Luhen lojërat e së kaluarës.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen vizatimet dhe lexohen tekstat e shkruara pranë tyre. Fëmijërinë e kujt përshkruan gjyshja? Si e përshkruan? Çfarë i kujtohet gjyshit? Cilat lojëra të sotme na kujtojnë lojërat e gjyshes e të gjyshit? Ç'gjë ngjason me lojërat e dikurshme dhe ku qëndron ndryshimi? Si i ka ndihmuar gjyshja e Anës, kur ka qenë e vogël, gjyshes së vet? Si ka ndihmuar vëllai i saj? Kur i ka qethur delet gjyshi? Pse pikërisht atëherë? Çfarë kanë bërë me leshin? Ku e kanë larë leshin? Pse e kanë larë në lumë? Për ç'gjë e kanë përdorur leshin? A bëhet sot po e njëjta gjë?

Nxënësit thonë, se ç'gjë u pëlqen ose nuk u pëlqen nga fëmijëria e gjyshes dhe e gjyshit të Anës. Shpjegojnë arsyen.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nga Shtojca nr. 1, priten vizatimet dhe renditen në kolonat përkatëse.
2. Mbi bazën e bisedës me personin e moshuar, shkruhet ajo që është mësuar për lojërat, për mënyrën e veshjes, për ushqimin dhe për mjekimin në të kaluarën.
3. Zgjidhet rebusi dhe shënohet zgjidhja (kustos, "Oktoih"). Bisedohet për rëndësinë dhe për kohën kur është botuar libri "Oktoih"



# PROFESIONI DHE HOBI

Kapitulli i dytë me emërtimin **Profesioni dhe hobi** përmban pesë tema: *Punët që bën Jovani, Dëshiroj të bëhem, Blejmë, Në fabrikë, Ndhimojmë edhe ne.*

**Qëllimet:** nxënësit i zgjerojnë njohuritë për profesionet e ndryshme, vënë re ndryshimet midis veprimtarive prodhuese e të shërbimit, dallojnë ndërvarësinë e veprimtarive, kuptojnë rëndësinë e profesioneve të veçanta dhe nevojën për sjelljen e përgjegjshme në punë, vërejnë rëndësinë e jetës në komunitet, të tolerancës dhe të respektimit reciprok.

Në jetë përcaktohem për profesione/veprimtari të ndryshme. Disa jemi të detyruar që t'i kryejmë, ndërsa disa i kryejmë sipas përzgjedhjes vetjake në kohën e lirë. Nxënësit nxiten që të vërejnë ndryshimet midis profesionit e hobia. Ata thonë profesionet që dinë. Bëjnë të ditur se me çfarë merren prindërit e tyre. Ç'njohuri dhe shkathtësi duhet të zotërohen për kryerjen e profesionit? Nxënësit rikujtojnë personat e njohur nga mjedisi përreth dhe mendojnë se si dhe ku punojnë ata. Nxjerrin përfundimin se për kryerjen e profesioneve të caktuara nevojiten njohuritë, arsimimi dhe aftësitë përkatëse. Disa profesione kanë më shumë kërkesa dhe janë më të ndërlikuara se të tjerat dhe kërkojnë përkushtim më të madh, kohë më të gjatë pune apo udhëtimi.

Krahas kësaj se çfarë është zgjedhur dhe dëshiruar, një profesion i caktuar përfaqëson për njerëzit detyrimin dhe fitimin e të ardhurave, d.m.th. mënyrën e sigurimit të ekzistencës dhe të mbajtjes së familjes. Gjatë kohës së lirë mund të jemi shumë aktivë, por kjo gjë nuk përfaqëson një mundim për ne, sepse ne kënaqemi me këtë gjë. Me nxënësit bisedohet: Ç'është hobi? Cili është hobi i tyre ose i prindërve të tyre? A ekzistojnë punët që mund të jenë njëkohësisht profesione dhe hobi, siç janë profesionet artistike. P.sh., Jovani është piktor profesionist, ka mbaruar Akademinë e arteve, punon çdo ditë në atelie, hap ekspozita dhe shet piktura. Kështu siguron mjete për jetesë dhe kontribuon në buxhetin familjar. Edhe babai i tij pikturon, por për hobi. Ai nuk është i detyruar të pikturojë çdo ditë, as të hapë ekspozita e të shesë piktura.

Ekzistojnë veprimtaritë e ndryshme që na sigurojnë të mira materiale dhe pa të cilat jeta e sotme as që mund të mendohet. Flasin për veprimtaritë ekonomike, të cilat mund të jenë veprimtari prodhuese (bujqësia, ekonomia pyjore, industria, minierat) dhe veprimtari shërbimi (postare, të shërbimit social, shëndetësore, bankare, komunale, intelektuale, argëtuese). Bisedohet me nxënësit për natyrën e këtyre veprimtarive. Pse na nevojitet edhe njëra, edhe tjetra palë e veprimtarive? Ku qëndrojnë ndryshimet midis tyre? Në ç'gjë janë të ngjashme? Veprimtaritë prodhuese plotësojnë kërkesat materiale. Por, nuk mund të funksionojmë as pa profesionet e shërbimit. Pse? Nxiten nxënësit që të thonë disa prej këtyre profesioneve dhe të shpjegojnë rëndësinë e tyre për jetën tonë të përditshme. Ku qëndrojnë shërbimet që na sjellin p.sh. berberët? Nxirret përfundimi se shërbimi, d.m.th. puna e harxhuar e berberit dhe materiali paguhen. Njerëzit që merren me veprimtaritë e shërbimeve zotërojnë njohuritë dhe shkathtësitë përkatëse të nevojshme për dhënie e shërbimeve cilësore. Natyrisht, në një mjedis të madh janë më të mëdha nevojat për veprimtaritë e shumëllojshme, pra edhe mundësia e përzgjedhjes për konsumatorët e



shërbimeve. Bisedohet me nxënësit për veprimtaritë e shërbimeve që njihen prej tyre në mjedisin ku jetojnë, për ato prej të cilave nuk ka në vendbanimin e tyre dhe se çfarë i karakterizon ato. Shërbimet paguhen. Nxënësit e dinë se duhet të paguajnë riparimin e biçikletës ose frizurën e re. Për këtë gjë atyre u duhen të holla. Bisedohet se përse na duhen të hollat. A u tërheqin vëmendjen prindërit se një diçka është e shtrenjtë dhe çfarë do të thotë kjo gjë? Si duhet të sillemi me paratë: Nxënësit mendojnë dhe argumentojnë shkaqet për një përdorim të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm të të hollave.

Dikur nuk ka pasur para si mjet pagese. Është bërë shkëmbimi i mallrave dhe partnerët në këtë tregti kanë rënë dakord për vlerën, gjë që ka qenë e komplikuar, e pasigurt dhe e kushtëzuar nga vlerësimet dhe nga rrethanat e ndryshme. Për këtë arsye, në rrethanat e zhvillimit të qytetërimit u poq vetëdija për harmonizimin e disa mjeteve unike të dakorduara e universale të pagesës. Lindi paraja si matës i vlerës së mallit ose vlerës së shërbimit. Paraja si mjet pagese lindi në qytetërimet e Azisë së Mesme të periudhës së gurit e të bronzit. Fillimisht ka qenë në formën e gurëve të çmuar, të guacave, të veglave të punës, të thuprave prej bakri e bronzi, ndërsa më vonë u shfaqen copat e arit. Dihet se 2000 vjet para erës sonë, njerëzit i kanë vulosur copat e arit, me ç'gjë shënonin peshën e arit, kështu që gjatë shkëmbimit nuk ishte e nevojshme të peshoheshin. Përveç florinjve, në përdorim kanë qenë edhe monedhat e derdhura të punuara prej metaleve të tjera. Sot përdoren edhe kartëmonedhat.

Ekonomia e sotme monetare e kryen afarizmin pa të hollat kartëmonedhë në dorë. Shitja, blerja, këmbimi i një valute me tjetrën bëhet vetëm me regjistrim. Kjo gjë mundëson pagesën me çeqe, me mandatpagesë, me kambiale dhe me urdhërpagesë. Për nevojat personale mund të përdorim kartat bankare dhe kartëkreditet. Gjatë blerjes fatura nënshkruhet dhe automatikisht pakësohet shuma e të hollave në xhirollogarinë bankare për aq sa kemi shpenzuar. Xhirollogaritë tona bankare tregojnë sesa të holla kemi fituar duke punuar, ose përndryshe kemi shpenzuar duke blerë ose duke shfrytëzuar shërbimet. Me nxënësit bisedohet se sa dhe çfarë punojnë prindërit e tyre për ta fituar rrogën. Me shpesh, njerëzit e marrin rrogën një herë në muaj, sipas llojit të punës që kryejnë dhe sipas mënyrës së vlerësimit të koeficientit të tyre. Ekzistojnë ndryshime në lartësinë e pagesës edhe në varësi të vendit të punës, të shkallës së arsimimit dhe të organizatës në të cilën punohet. Nxënësvë u rikujtojmë se sasia e të hollave që kemi në dispozicion është e kufizuar dhe se në kërkesa dhe në shpenzime duhet të jemi të matur.

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së njeriut është e lidhur me prodhimin e të mirave të ndryshme materiale. Nga prodhimi dhe nga shitja jetojnë shumë njerëz. Prodhuesit e mallrave përpiqen që të prodhojnë produkte sa më cilësore që do ta tërheqin blerësin. Nga ana tjetër, për blerësit ka rëndësi që të marrin një prodhim/mall sa më të mirë dhe sa më të lirë për paratë e paguara. Me nxënësit bisedohet për veprimtaritë ekonomike në mjedisin tonë. Ndoshta kanë pasur tashmë rastin të dëgjojnë, p.sh. në familje, diçka për atë sesi punohet në fabrika dhe në fermat bujqësore. Ata nxiten që të informohen edhe vetë për mënyrën e prodhimit në fabrikë, p.sh. për lëndët e para që shërbejnë për përpunim, për veglat e punës dhe për makineritë që përdoren në punë, për mbetjet që krijohen në këtë proces. Mund të shihet edhe filmi me këtë temë dhe të shkohet për vizitë në një fabrikë ose në ndonjë repart pune. Bisedohet për atë sesi duket prodhimi, sa zgjat procesi i prodhimit, a krijohen mbetje gjatë prodhimit dhe çfarë bëhet me to, a ndotet ajri gjatë procesit të prodhimit dhe si të parandalohen pasojat e mundshme shëndetësore për të punësuarit. Mund të ftohet edhe ndonjë prind, i cili do t'i njohë nxënësit më hollësisht për natyrën e profesionit të tij. Që nxënësit ta kenë më të qartë pamjen e të gjithë procesit të prodhimit, mund të shfrytëzohet edhe diagrami që tregon në mënyrë "të lexueshme" figurative rrugën e prodhimit dhe rezultatin përfundimtar.



Nxënësit vënë re se ka shumë rëndësi që në punët e përmendura dhe në veprimtaritë e tjera të punës e të lira, njerëzit e mbështesin reciprokisht njëri-tjetrin. Bashkëpunimi i suksesshëm nënkupton respektin reciprok pavarësisht nga aftësitë, nga përvoja, nga dija dhe nga interesimet e ndryshme. Nëse jemi të hapur ndaj ndryshimeve, atëherë përfitojnë të gjithë, sepse kombinojnë natyrshëm mundësitë dhe idetë e ndryshme dhe arrihen rezultate më cilësore. Që të jemi vërtetë të vetëdijshëm për përparësitë e punës bashkëpunuese, duhet të jemi tolerantë ndaj ndryshimeve. Në këtë mënyrë krijohen predispozitat për një reciprocitet më të mirë e më produktiv. Bisedohet me nxënësit për rëndësinë e respektit e të ndihmës reciproke. Ç'është solidariteti? Jepen shembuj. Nxënësit shpjegojnë sesi u kanë ndihmuar të tjerëve në situatat e caktuara. A u ka krijuar kënaqësi kjo gjë? Duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme dhe duke theksuar rëndësinë dhe vlerën e solidarizimit me të tjerët, nxënësit do të kenë mundësinë të mësojnë dhe të ndërtojnë një raport pozitiv ndaj këtyre vlerave. Nganjëherë dikujt mund t'i ndihmojmë lehtë dhe shpejt në situatat e ndërlikuara, në të cilat mund të merret pjesë dhe t'u ofrohet ndihma të rrezikuarve. Këtu është veçmas i rëndësishëm roli i organizatave humanitare. Një nga organizatat më të vjetra është Kryqi i Kuq, i cili ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për sigurimin e ndihmës në raste lufte dhe të katastrofave të mëdha natyrore. Unicefi u ndihmon të gjithë fëmijëve të botës dhe punon në kuadër të OKB<sup>së</sup>. Ekzistojnë edhe organizatat e tjera humanitare. Bisedohet edhe për veprimtarinë e tyre. Parimet e solidaritetit, respektimi i të tjerëve dhe i atyre që janë ndryshe, puna në grup dhe bashkëpunuese gjatë mësimit dhe lojës, nuk zhvillohen brenda një kohe të shkurtër as gjatë zhvillimit të një teme mësimi, por këto vlera përforcohen përmes veprimtarive, temave e fushave të shumta, duke i demonstruar ato me ekzigjencë me shembuj dhe me veprime vetjake.



# PUNËT QË BËN JOVANI

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të vihet re se disa punë kryhen sepse duhet, ndërsa disa të tjera, sepse ashtu dëshirohet</li><li>• të dallohet puna si veprimtari e domosdoshme nga veprimtaria e lirë</li><li>• të vihet re se të rriturve u duhet të punojnë dhe të fitojnë për të siguruar jetesën</li><li>• të dallohen disa lloje të profesioneve</li><li>• të dallohet profesioni nga hobi</li><li>• të dallohen profesionet e veçanta të prindërve e të kushërinjve të vet</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	punë, profesion, hobi, lojë

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit thonë profesionet që njohin. Kush merret me këto profesione? Ku ushtrohen këto profesione? Çfarë duhet të dinë njerëzit për t'i ushtruar këto profesione dhe ku e mësojnë këtë gjë? Vihet re, se për disa profesione duhet shkollimi më i gjatë, ndërsa për disa më i shkurtër.
2. Bisedohet për veprimtaritë që kryhen çdo ditë dhe që nuk janë, as profesion, as hobi (punët e përditshme në shtëpi; larja e rrobave, hekurosja, fshirja, gatimi, blerja e ushqimeve etj.).
3. Hartohen pyetësorë për fqinjët lidhur me profesionin që ushtrojnë: Ç'profesion ushtrojnë? Ku e ushtrojnë këtë profesion? Ç'shkollë duhet për ushtrimin e këtij profesioni? Sa kohë zgjat shkollimi? A nevojitet uniforma e veçantë e punës? Sa kohë gjatë ditës kalojnë në punë? Çfarë është e bukur dhe çfarë është e vështirë në profesionin përkatës? Pse e kanë zgjedhur këtë profesion?
4. Lexohen në klasë pyetësorët e plotësuar. Vihet re, se cilat janë profesionet më të shpeshta dhe më të rralla të njerëzve në vendbanimin e nxënësve. Pse është kështu? Cilat nga profesionet e përmendura janë të rrezikshme dhe pse? Për cilat profesione duhet uniforma e punës? Me ç'profesion keni dëshirë të merreni, kur të rriteni?
5. Bisedohet për hobin e prindërve të tyre, të gjyshit dhe të gjyshes. Kur merren me to dhe përse?
6. Nxënësit thonë veprimtaritë që kryejnë gjatë ditës. Cilat veprimtari janë detyrë e tyre dhe cilat i kryejnë nga që kanë dëshirë vetë ata?
7. Bëjnë një pantomimë me temën e profesionit.

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit shohin vizatimet dhe veprimtaritë e Jovanit në atelie. Bisedohet për atë që i është dashur të bëjë Jovanit për t'u bërë piktor. Ç'përfitim ka Jovani nga piktura? A është piktura për të profesion apo hobi?

Cili është profesioni i babait të Jovanit? Çfarë ka punuar ai para se të dalë në pension? Sa kohë ka kaluar në punë? Çfarë ka punuar atje? Çfarë punon tani në kohën e lirë? Ku





pikturon ai? Pse pikturon pikërisht atje? Çfarë bën ai me pikturat e veta? Shpjegohet ndryshimi ndërmjet punës si piktor të Jovanit dhe të babait të tij? Cili është hobi i Jovanit?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nxënësit shohin fotografitë dhe komentojnë profesionet. Plotësohet bashkërisht tabela. Duhet të vihet re se për profesione të ndryshme, shkollimi zgjat në afate të ndryshme.
2. Plotësohet tabela për profesionet e anëtarëve të familjes së vet.
3. Zgjidhet rebusi dhe plotësohet fjalia.

## **DËSHIROJ TË BËHEM...**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihet re se njerëzit e vendbanimit kanë detyrimet, të drejtat dhe detyrat e veta</li> <li>• të nxirret përfundimi se të rriturit duhet të punojnë e të fitojnë për të jetuar</li> <li>• të emërtohen disa nga profesionet karakteristike për ndërtesat në vendbanimin e vet</li> <li>• të vihet re se në qytet ekzistojnë ndërtesat që janë të rëndësishme për jetën e të gjithë banorëve</li> <li>• të dallohet funksioni kryesor i ndërtesave të rëndësishme</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	makiashiste, drejtues emisioni, shkrimtar, programues, bibliotekar, postë, dërgesa postare (kartolinë, letër, telegram, pako), polici, Shtëpia e shëndetit, teatër, kinema, qendra sportive

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Nxënësit bisedojnë për profesionet që u pëlqejnë. Me ç'profesion do të dëshironin që të merreshin ata? Çfarë u pëlqen atyre në këtë profesion? A merret ndonjë nga anëtarët e familjes së tyre me këtë profesion?
2. Vizitohet posta. Nëse ka mundësi, nxënësit duhet ta shohin të gjithë rrugën e dërgesës në këtë postë, si edhe shërbimet e tjera që ofron ajo. Para vizitës, përgatiten pyetjet për të punësuarit lidhur me dërgesat postare, për rrugën e postës dhe për shërbimet e tjera. Për shembull: Çfarë bëhet me postën nga kutitë postare? Kush i vulos dërgesat? Kush i sistemon e ndan ato? A bëhet kjo gjë me dorë apo në mënyrë të mekanizuar? Çfarë bëhet me postën që i dërgohet marrësit që banon në të njëjtin vendbanim? Sa mund të jetë dërgesa më e madhe dhe sa ajo më e vogël? Si udhëton telegrami? Sa postierë ka? Si e shpërndajnë postën (në këmbë apo me ndonjë mjet udhëtimi)? A ndahet e sistemohet posta para se të shpërndahet? Cila është radha e punës gjatë ndarjes e sistemimit? Ç'shërbime të tjera ofrohen në postë? Sa sportele janë? Për cilin shërbim është i caktuar çdo sportel?





3. Bisedohet për të gjitha mënyrat me të cilat mund të udhëtojë mesazhi; jepen shembuj të komunikimit të mesazheve me anë të telefonit celular ose të postës elektronike. Nëse në shkollë ekziston lidhja e internetit, tregohet sesi dërgohet mesazhet elektronike. Vihen re ndryshimet midis postës elektronike e postës së zakonshme.
4. Në shkollë ftohet polici. Nxënësit i bëjnë pyetjet që i kanë përgatitur paraprakisht. Pse ka vendosur ta zgjedhë këtë profesion? Sa kohë ka zgjatur shkollimi për këtë profesion? Ç'detyra kryen në kuadër të profesionit të vet? Çfarë është e bukur në punën e policit? Çfarë është e vështirë? A është i rrezikshëm profesioni? Cilat janë pjesët e uniformës së policit? Polici lutet që të tregojë ndonjë ndodhi interesante të profesionit të tij.
5. Nxënësit hartojnë listën e të gjitha shërbimeve që ata kanë në dispozicion në vendbanimin e vet (në qytetet e mëdha vetëm për pjesën e qytetit në të cilën gjendet shkolla). Nxirret përfundimi se pse pikërisht këto shërbime ofrohen në vendbanimin e tyre. Sa shpesh shfrytëzohen këto shërbime? A u nevojiten shumë njerëzve këto shërbime? Pse njerëzit u ofrojnë shërbime njerëzve të tjerë?
6. Nxënësit emërtojnë orenditë dhe pajisjet e tjera në klasë. Thuhen shërbimet që janë shfrytëzuar për t'u punuar, transportuar ose montuar orenditë dhe pajisjet në klasë. Në të njëjtën mënyrë bisedohet edhe për veshmbathjen dhe frizurën e nxënësve.
7. Hartohet lista e shërbimeve që nuk ekzistojnë në vendbanimin e nxënësve dhe shkruhet se ku ofrohen këto shërbime.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Lexohet teksti i shkruar dhe komentohen figurat ilustruese. Çfarë i pëlqen Anës? Cilat profesione janë të lidhura me televizionin, me filmimin dhe me natyrën? Me çfarë tjetër mund të merret ajo? (Të jetë kameramane, skenografe, regjisore ...). Çfarë i pëlqen Markos që të bëjë? Me çfarë tjetër mund të merret ai? (Të jetë ilustrues, disenjator, korrektor ...).

Ç'shërbime mund të marrim në postë? Çfarë dërgojmë me postë? Nxënësit shohin fotografitë e pullave postare dhe komentojnë pamjen e tyre (çfarë është paraqitur në to, cilat prej tyre kushtojnë më shumë). Lexohet teksti shkruar dhe bëhet e ditur se pse ngjiten pullat postare. Thuhen disa ndërtesa që janë të rëndësishme.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Lidhen profesionet dhe shërbimet.
2. Plotësohet tabela e tregtisë, shëndetësisë dhe e komunikacionit (me tregti: shitësi i ushqimeve, i veshmbathjeve, i mobilieve ..., me shëndetësi: mjeku, stomatologu, infermiera, veterineri ... , me komunikacion: shoferi, makinisti, konduktori, piloti, stjuardesa, polici i qarkullimit rrugor ...).
3. Plotësohet tabela dhe shkruhen institucionet përkatëse në vendbanimin e nxënësve.



## BLEJMË

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të kuptohet rëndësia e të hollave</li><li>• të arrihet në përfundimin se të rriturit duhet të punojnë dhe të fitojnë për të jetuar</li><li>• të dihet se të hollat fitohen si shpërblim për punën e kryer</li><li>• të njihen njësitë kryesore monetare (monedhat metalike dhe kartëmonedhat)</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	shkëmbim, të hollat, monedhë, karta bankare, bankë, paradhënie, marrja e të hollave, llogaria bankare, bankomat

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit tregojnë përvojën e vet lidhur me shkëmbimin e sendeve (shkëmbimi i lodrave, i vizatimeve me figura, i materialeve shkollore etj.). Cilat sende shkëmbehen? (Librat që nuk u nevojiten, vizatimet me figura të dubluara...).
2. Bëhet dyqani në klasë me disa pulte. Mund të shiten fletoret, gomat, mprehësat e lapsave etj. Poshtë artikujve a asortimenteve vihen çmimet e shkruara në copa letre. Bëhen imitacionet e monedhave metalike e të kartëmonedhave. Disa nxënës janë "shitës", kurse disa janë "blerës". Blihen disa artikuj a asortimente. Komentohe se në çfarë mënyre mund të merret kusuri prej 5 eurove, nëse kanë blerë artikullin a asortimentin me çmim 2 euro e 50 centë etj. Pas tregtimit "blerësit" komentojnë se cilët "shitës" kanë qenë ose nuk kanë qenë të dashur. Si duhet të sillen blerësi? Si duhet të sillen shitësi?
3. Fëmijët njihen me monedhën që përdoret në Malin e Zi. Përshkruhet pamja e kartëmonedhave dhe e monedhave metalike. Cilat prej tyre kanë vlerë më të madhe; monedhat metalike apo kartëmonedhat? Cilat prej tyre përdoren më lehtë? Bisedohet për kursimin dhe për ruajtjen e të hollave. Të hollat ruhen në portofol dhe tregohet kujdes që të mos dëmtohen. Nëse nuk na duhen, është më mirë që të lihen në shtëpi. Nxënësit ushtrohen në këmbimin e kartëmonedhave dhe të monedhave metalike, p.sh. si mund ta këmbëjnë kartëmonedhën prej 10 eurosh në monedha metalike ose si mund ta këmbëjnë monedhën metalike prej 2 eurosh në monedha metalike më të vogla.
4. Bisedohet për mënyrat, me të cilat mund të fitohen të hollat (Si pagesë për punën, si shpërblim, si short në lotari etj.). Si i fitojnë të hollat prindërit e tyre? Ku i marrin të hollat? Me anë të kujt i marrin të hollat? Bisedohet për mënyrën e pandershme të fitimit të të hollave.
5. Hartohet lista e sendeve që prindërit (ose kujdestarët) duhet të sigurojnë ose të blejnë (veshmbathja, ushqimi, librat ...) dhe çfarë duhet të paguajnë çdo muaj.
6. Disa fëmijëve u jepen para xhepi. Tregohet sesi përdoren paratë e xhepit (nëse i kanë). Në copa letre shkruhen fjalët: fitim, kursim, para në dorë, rrogë, borxh, para xhepi.
7. Nxënësit tërheqin copat e letrave dhe përshkruajnë kuptimin e këtyre fjalëve.

### Puna me Tekstin mësimor:

Shihen vizatimet dhe komentohe ajo që është pasqyruar në to. Lexohet teksti i shkruar. Ç'gjë tjetër mund të ishte shkëmbyer?



Shihen kartëmonedhat dhe monedhat metalike. Bisedohet për vlerën e monedhave të ndryshme? Me ç'monedha blejnë nxënësit? (Me kartëmonedha apo me monedha metalike.)

Si i fiton të hollat Milena? Bisedohet për të gjitha mënyrat e mundshme me të cilat mund të paguhet malli i blerë. Lexohen tekstet poshtë fotografive. Si mund t'i marrim këto të holla?

Shihet tabela dhe komentohet, sesa të holla i mbesin Milenës kur i paguan shërbimet e përmendura.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nxënësit shkruajnë se çfarë kanë blerë familjet e tyre dhe sa ka kushtuar kjo gjë. Shkruajnë sesa të holla janë shpenzuar gjithsej.
2. Nxënësit supozojnë se çfarë mund të blejnë me 5 euro.
3. Gjejnë fjalët: paga, fitimi, kesh, kursim, të holla xhepi. Shkruajnë kuptimin e fjalëve kursim e të holla (para) xhepi.

## **NË FABRIKË**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të arrihet në përfundimin se njerëzit i prodhojnë të mirat materiale të cilat u nevojiten për të jetuar</li><li>• të dihet se njerëzit janë edhe konsumatorët e të mirave materiale që prodhojnë</li><li>• të vihet re se gjatë prodhimit krijohen edhe mbeturinat dhe të bëhet ndërgjegjësimi për nevojën dhe për rëndësinë e kujdesit për mjedisin</li><li>• të emërtohen disa nga profesionet karakteristike</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	fabrikë, punishte (reparti i prodhimit), prodhim, transport, tregti, produkt, material, makineri, vegla e punës; mbeturinë fabrikë, punishte (reparti i prodhimit), prodhim, transport, tregti, produkt, material, makineri, vegla e punës; mbeturinë

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Vizitohet fabrika më e afërt. Bisedohet me nxënësit për vizitën: çfarë prodhohet atje, çfarë kemi për të parë, si duhet të sillemi? Në fabrikë shihen makineritë, lënda e parë që përdoret, prodhimet e gatshme. Pyeten punëtorët se ç'mjet mbrojtës përdorin gjatë punës dhe pse është i domosdoshëm ai. A kanë mbetje? Çfarë bëjnë me mbetjet? Ku i magazinon prodhimet e gatshme? Ku shiten ato? Si transportohen deri në dyqan?
2. Vizitohet punishtja artizanale. Sa të punësuar ka ajo dhe me çfarë merren ata? Cilat materiale përdorin. Vërejnë veglat e punës që përdoren gjatë punës. A ka mbetje? Çfarë bëhet me to? A i heqin ato sipas rregullit? Si mund t'i përdorin mbetjet? Cilat prej tyre mund të përpunohen dhe të shfrytëzohen përsëri?
3. Grumbullohen materialet reklamuese të dyqaneve të ndryshme. Krahasojnë çmimet në afishimet e ndryshme. Çfarë është më e lirë dhe ku është më e lirë? Çfarë do të



- blenin? A duhet të blihen detyrimisht prodhimet më të lira? Në ç'mënyra mund të reklamohen prodhimet? (Televizioni, radio, gazetat ...)
- Prej kanatierëve, çorapeve e penjve punohen kukullat prej lecke.
  - Nxënësit sjellin në shkollë lodrat me të cilat nuk luajnë më. Paketohen dhe dërgohen në Kryqin e Kuq.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shikohen dhe komentohen vizatimet dhe lexohen tekstet e shkruara. Pse ka rëndësi për njerëzit pylli? Cilët drurë priten? Si sillen trungjet deri në sharrë? Çfarë përftohet në sharrë? Çfarë punohet në fabrikën e mobilieve prej dërrasave, prej trarëve, prej listelave dhe prej pllakave.

Shihet figura ilustruese e punishtës. Me çfarë merren prindërit e Milicës? Çfarë bëjnë me mbetjet prej pëlhere e stofi? Si u ndihmon Milica prindërve të vet? Ku shiten kukullat e tyre? Shihen fotografitë dhe komentohet sesi mund ta bëjnë vetë kukullën prej lecke.

### **Puna me Fletoren e punës:**

Nxënësit rikujtojnë tregimin "Pinokio". Prej çfarë materiali është punuar Pinokio? Kush e ka punuar? Ç'vegla pune ka përdorur? Lidhi veglat e mjetet që duhen për të punuar Pinokion.

## **NDIHMOMJË EDHE NE**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re nevoja e bashkëpunimit dhe e tolerancës midis njerëzve</li> <li>të vihet re se çdo njeri jeton në një komunitet të caktuar dhe se askush nuk mund të jetojë i vetëm</li> <li>të dallohen disa tipa të komuniteteve: familja, kolektivi i klasës (paraleles), banorët e pallatit</li> <li>të vihet re se është mirë që njerëzit e ndihmojnë njëri-tjetrin</li> <li>të zhvillohet ndjenja e solidaritetit</li> <li>të vihet re se komuniteti mbijeton, nëse ekziston toleranca, barazia dhe respekti reciprok</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	marrëdhëniet midis njerëzve, bashkëpunim; ndihmë, solidaritet, tolerancë, barazi (gjinore, fetare, racore), UNICEF, Kryqi i Kuq, Gjysmëhëna e Kuqe

### **Veprimtaritë e propozuara:**

- Bisedohet me nxënësit për komunitetin e tyre të klasës. Si e ndihmojnë njëri-tjetrin? Kur u është dashur atyre ndihma? Kush u ka ndihmuar? Kë kanë ndihmuar ata vetë?
- Nxënësit japin shembuj të komuniteteve (paralelja, klasa, shkolla, familja, fafesisnia, fqinjët ...) Si e ndihmojnë njëri-tjetrin?



3. Lexohen artikujt nga gazetat për rajonet e rrezikuara? Thuhen shkaqet për të cilët njerëzit mund të jenë të rrezikuar. Kush u ka ardhur në ndihmë? Thuhen propozimet sesi mund të ndihmojnë njëri-tjetrin.
4. Bisedohet për organizatat humanitare dhe për mënyrat e dhënies ndihmë njerëzve të rrezikuar. Sqarohet se organizatat humanitare punojnë për t'u siguruar të drejta të barabarta të gjithë njerëzve, luftojnë për paqe në botë dhe për barazinë gjinore, fetare e racore. Ato sigurojnë kushtet bazë për jetën e njerëzve të rrezikuar, si edhe për mjekimin dhe për shkollimin e fëmijëve në vendet që janë përfshirë nga katastrofat natyrore ose në zonat e luftës.
5. Bisedohet për aksionet e ndryshme të mbledhjeve, kujt i dedikohen ato dhe përse mblidhen mjetet financiare. Në ç'mënyrë mund të ndihmojnë nxënësit. Organizohet aksioni i grumbullimit të rrobave që nuk përdoren më.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen vizatimet dhe lexohen tekstet e shkruara. Pse duhet t'i respektojmë rregullat dhe detyrat në komunitet? Nxirret përfundimi se banorët e pallatit bëjnë komunitetin. Pse e ndihmon Teodora xha Vojon? Në ç'mënyrë e bën ajo këtë gjë? Nxënësit komentojnë sesi u ndihmojnë ata të tjerëve.

Shihen simbolet e organizatave humanitare. Lexohen emërtimet e tyre dhe thuhet se kujt i ndihmojnë dhe si e ofrojnë ndihmën. Thuhen shkaqet për arsye të cilave ndihmojnë.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Shkruhet sesi mund të ndihmohet në situatat e përmendura.
2. Lidhen organizatat humanitare me llojin e ndihmës që ofrojnë.
3. Shkruhet sesi mund të ndihmojnë nxënësit të tjerëve. Lexohet se kush janë vullnetarët dhe thuhet shkaqet se përse ndihmojnë ato. Çfarë mendohet për veprimin e tyre?



# NË FSHAT DHE NË QYTET

Kapitulli **Në fshat dhe në qytet** përbëhet nga shtatë tema mësimi të lidhura për nga përmbajtja dhe për nga qëllimet: *Moti ndryshon, Në tregun e fruta-perimeve, Në fermën blegtorale, Vendbanimi im, Festojmë, Rruga "Njegosh", Udhëtojmë.*

**Qëllimet:** nxënësit përsëritin dhe zgjerojnë njohuritë për ndryshimet në jetën natyrore e shoqërore që lindin si pasojë e ndërrimit të stinëve të vitit; vënë re lidhjet shkak-pasojë midis dukurive e proceseve të ndryshme natyrore e shoqërore; shpjegojnë rëndësinë e ndikimit të njeriut mbi ndryshimet në natyrë dhe në shoqëri; "i vendosin" siç duhet ndodhitë e së kaluarës, hulumtojnë në mënyrë të pavarur aspektet e veçanta të së kaluarës, i zgjerojnë njohuritë për varësinë reciproke midis profesioneve të njeriut në fshat dhe në qytet, i zgjerojnë njohuritë për mjetet e qarkullimit rrugor dhe për llojet e qarkullimit rrugor.

Stinët e vitit sjellin ndryshime që manifestohen në jetën dhe në mjedisin natyror e shoqëror. Ndryshimet e motit kushtëzojnë edhe ndryshimet e botës bimore e shtazore. Pylli është bashkësia natyrore në të cilën mund të vihen re aspekte të ndryshme. Gjithashtu, u kujtojmë nxënësve se ekzistojnë llojet e ndryshme të pyjeve dhe se për këtë gjë kanë mësuar edhe në vitet e shkuara. Me ndërrimin e stinëve të vitit ndryshon edhe sasia e dritës, ndërsa ndryshimet më të dukshme ndodhin në pyllin gjetherënës. Lloji i veçantë i bimëve rritet në pranverën e hershme (bimët pranverore), kur drurët akoma nuk kanë çelur gjethe, sepse në katet e poshtme ka më shumë dritë se sa në verë. Atëherë bimët pranverore çelin lule, nxjerrin frytet me fara, ndërsa në pjesët nëntokësore grumbullojnë ushqimin rezervë.

Në vjeshtë ditët bëhen më të shkurta dhe më të ftohta. Bimëve gjetherënëse u bien gjethet në vjeshtë. Vetëm disa drurë gjetherënës i mbajnë gjethet në vjeshtë (dushku i zi). Në pyll mund të vihen re fieret (tjegullorja, fieri mashkull, fieri i butë), shqopa e lulëzuar, urthi. Nxënësit nxiten që të kërkojnë ekzemplarë të disa prej këtyre bimëve dhe t'i ruajnë në herbarium. Nxënësit pyeten, nëse kanë patur rastin ta shohin urthin nëpër shkallë, kangjella apo përtokë dhe ç'gjë specifike kanë vënë re në pamjen e tij. Theksohet se urthi është bimë zvarritëse dhe se me rrënjë të veçanta kapet fort pas drurëve e bazamenteve të tjera.

Në dallim nga bimët gjetherënëse, drurët halorë i mbajnë gjethet (halat) gjatë gjithë vitit, megjithëse edhe këtu ka përjashtime (larthi). Gjethet e druhalorëve (halat) kanë lëkurën mbështjellëse të trashë, e cila e pengon avullimin e ujit. Në pyjet halore ka më pak dritë. Halat që bien njelmëzojnë tokën. Në këto pyje jetojnë më pak kafshë të imta, sepse është ftohtë. Edhe pse drurët halorë nuk i humbasin gjethet shpejt dhe në mënyrë të dukshme sikurse drurët gjetherënës, ndryshimet ndodhin edhe në pyjet halore. Gjatë disa viteve, për shkak të rënies graduale të halave, druri halor ripërtërihet plotësisht.

Në vjeshtë, zogjtë që ushqehen me insekte ikin në viset e ngrohta, ndërsa ato që ushqehen me fara mbeten. Disa kafshë përgatitin rezervat për dimër, ndërsa disa të tjera marrin shumë ushqim duke siguruar dhjamin e nënlëkurës si burim të energjisë së nevojshme.



Në vjeshtë janë të shpeshta reshjet, kështu që në mjediset me lagështirë zhvillohen kërpudhat (ngrënese, helmuese, eshke). Kërpudhat dhe bakteret janë shpërbërës të rëndësishëm që ndihmojnë në qarkullimin e lëndëve në natyrë. U rikujtojmë nxënësve se cilat kafshë bien në gjumin e dimrit (gjeri i ngrënshëm, lakuriqi veshgjatë, iriqi), ndërsa cilat dremitin (ariu, ketri, xixëllonja, baldosa).

Zvarranikët, amfibët, nuk kanë temperaturë të përhershme trupore, kështu që gjatë dimrit prehen. Për ta përballuar më lehtë dimrin, disa kafshë fitojnë me ardhjen e vjeshtës qime më të dendura, me qëllim që të mbrohen nga dimri. Është interesante se tek disa kafshë ndryshon ngjyra e qimeve ose e puplave; ato bëhen më të ndritshme, me qëllim që t'i përshtaten mbulesës prej bore (kunadhja, bukla e borës, lepuri).

Pse është i dobishëm pylli? Druri përdoret në ndërtim, në industrinë e drurit dhe të letrës, për ngrohje dhe për rekreacion. Prerja e pyllit duhet të bëhet me plan, sepse në të kundërtën mund të vijë deri tek erozioni, d.m.th. gërryerja e tokës. Bisedohet me nxënësit sesi mund të kontribuojmë në pakësimin e prerjes së pyjeve (me grumbullimin e letrave të vjetra, me riciklim).

Vitin e kaluar, nxënësit kanë mësuar për llojet e ndryshme të frutave, të perimeve e të bimëve zbukuruese. Gjatë këtij viti shkollor nxënësit duhet të mësojnë më shumë për mënyrat e kultivimit e të mirëmbajtjes së bimëve të ndryshme. Kushtet e domosdoshme për jetën e bimëve të llojeve të ndryshme janë uji, drita, ajri dhe toka. Gjatë përmirësimit të kushteve për kultivimin e bimëve duhet të tregohet kujdes që të mos rrezikohen kushtet e habitatit. Përdorimi jo i rregullt dhe jo i matur i plehrave, i pesticideve dhe i kimikateve të tjera mbrojtëse mund ta zvogëlojë cilësinë e fryteve dhe të ndikojë në mënyrë të dëmshme mbi shëndetin tonë.

Bisedohet me nxënësit për mënyrat e sigurimit të produkteve të ndryshme (nxjerrja e prodhimeve në treg). Ajo që nuk rritet në viset tona ose që nuk është e pranishme në mënyrë sezonale, sillet nga viset e tjera (banania, ananasi). Disa bimë i kultivojmë në kushte të kontrolluara e veçmas të përgatitura (serrat me xham e me plasmas). Kështu, disa bimë, me një ruajtje e magazinim të kujdesshëm, mund t'i hamë të freskëta në të gjitha stinët e vitit.

Bimët i kultivojmë në toka të kultivuara dhe qëllimisht të përgatitura (pemishtja, kopshti, ara, vreshti, parku). Parqet janë sipërfaqet e kultivuara të tokës, të vendosura në vendbanime. Parqet e zbukurojnë hapësirën me drurë të ndryshëm, me gëmusha, me lule dhe me barë. Ato janë oaze të çmuara, sepse drurët në to e pastrojnë ajrin dhe e pakësojnë zhurmën.

Cilat kafshë mund t'i shohim shpesh në qytet dhe cilat në fshat? Kafshët shtëpiake janë shumë të rëndësishme për ushqim dhe për ekonomi. Në të kaluarën e largët, njerëzit, duke parë dobitë e mundshme prej disa llojeve të kafshëve, filluan t'i zbutin kafshët. Sot janë të njohura llojet e shumta të kafshëve shtëpiake. Shumica e tyre janë gjitarë. Trupi i tyre është i mbuluar me qime, pjellin të vegjlit dhe kanë gjëndrat e qumështit që prodhojnë ushqimin për të vegjlit.

Blegtoaria është degë e rëndësishme e ekonomisë. Tek ne vazhdon të jetë më i shpeshtë mbarështimi i bagëtive për nevojat personale, por njerëzit po përcaktohen gjithnjë e më shumë për mbarështimin në fermat e bagëtive. Kjo gjë kërkon kushtet përkatëse: ambientin e duhur të pajisur në mënyrë funksionale, përdorimin e teknologjisë bashkëkohore të domosdoshme për mirëmbajtjen e fermës dhe, sigurisht, dije. Duhet të kujdesemi me përgjegjësi për kërkesat (lloji i ushqimit, mënyra e mbajtjes së higjienës) dhe për shëndetin e kafshëve shtëpiake, për rrethanat specifike që duhen pasur parasysh dhe për kushtet e motit.

Bisedohet me nxënësit për kanakarët shtëpiake që mbarështojnë në shtëpitë e veta ose që i shohin shpesh në mjedisin përreth.





Vendi ku njerëzit jetojnë dhe kryejnë veprimtaritë e ndryshme quhet vendbanim. Bisedohet për vendbanimet e qytetit dhe të fshatit, të cilat i dallojmë për nga madhësia, për nga numri i banorëve, për nga pamja dhe për nga funksioni i objekteve, si edhe për nga veprimtaritë e banorëve vendas. Qyteti është vendbanimi i madh, i cili mund të jetë qendra politike, kulturore dhe ekonomike e një rajoni. Nëse nisemi nga numri banorëve, atëherë dallojmë qytetet e vogla (deri në 20.000 banorë), qytetet me madhësi mesatare (nga 20.000 deri në 100.000 banorë dhe qytetet e mëdha (mbi 100.000 banorë). Për qytetet është karakteristike dendësia e popullsisë që banon në ndërtesat shumëkatëshe, në blloqet e banesave, se njerëzit janë të punësuar në industri, në tregti, në shëndetësi, në arsim, në kulturë... Në fshat është mënyra e ndërtimit tjetërsoj të shtëpive të banimit, organizimi tjetërsoj i jetës dhe mënyra tjetërsoj e veprimtarive mbizotëruese të banorëve. Njerëzit në familjet e fshatit jetojnë në shtëpi të veçanta dhe merren më shpesh me bujqësi, me blegtori dhe me ekonomi pyjore. Ndryshimet shoqërore, zhvillimi i infrastrukturës dhe mënyra bashkëkohore e jetesës kushtëzojnë aktivizimin më të madh të popullsisë së fshatit dhe përfshirjen e saj në shumë veprimtari, të cilat kanë qenë më parë karakteristike vetëm për mjediset (kulturore, ekonomike, arsimore) qytetare. Gjithashtu, edhe kërkesat për arsimim të mëtejshëm, për punësim dhe për sigurimin e kushteve më të mira të jetesës, kanë sjellë migrimin e popullsisë dhe braktisjen graduale të fshatit edhe tek ne.

Këtë vit flitet përsëri për festat. Vitin e shkuar kanë mësuar për festat që kremtojnë në shtëpi (ditëlindja, Viti i Ri, Krishtlindjet). Këtë vit i zgjerojnë njohuritë për festat, shtetërore, fetare dhe lokale dhe për kremtimet tradicionale.

Një Maji është festa e Ditës ndërkombëtare të punës që festohet në shenjë nderimi për ndodhitë në Çikago, kur në vitin 1886 punëtorët protestuan duke kërkuar ditën tetëorëshe të punës. Edhe pse këto demonstrata u ndaluan në mënyrë brutale, në kongresin e Internacionales së Dytë u vendos që çdo vit pasardhës, në po të njëjtën ditë, të organizoheshin grevat dhe demonstratat, kështu që Një Maji u bë simboli i luftës dhe i solidaritetit të punëtorëve të të gjithë botës. Pas Luftës I Botërore; Një Maji festohet në shumë vende si festë shtetërore. Festë e njohur ndërkombëtare është edhe 8 Marsi; Dita e grave. Në Konferencën e 2<sup>-të</sup> ndërkombëtare të grave socialiste të mbajtur në Kopenhagë, në vitin 1910, me propozim të Klara Cetkinit, revolucionares së njohur gjermane, 8 Marsi u shpall Dita ndërkombëtare e grave. Ky ka qenë një hap i rëndësishëm në rrugën e afirmimit të barazisë së grave. Ndërkohë, edhe pse kjo festë festohet në të gjithë shtetin, 8 Marsi nuk është ditë pushimi. Bisedohet me nxënësit për këtë festë dhe për sjelljen e tyre kur janë në pritje të kësaj dite.

Në familje festohen edhe festat fetare. Pjesëtarët e besimit ortodoks e festojnë Krishtlindjen, festën fetare kushtuar lindjes së Krishtit, me 7 janar, kurse katolikët me 25 dhjetor sipas kalendarit gregorian. Festat e Krishtlindjeve shoqërohen me kremtime rituale e me veprimtari të ndryshme, siç janë kreshmet e Krishtlindjeve dhe Nata e Buzmit. Myslimanët festojnë Bajramin. Pas mbarimit të agjërimit të ramazanit festohet tri ditë Fihter Bajrami. Kurban Bajrami festohet pas ramazanit dhe zgjat 4 ditë.

Me synimin që të gjithë fëmijëve t'u sigurohet e drejta për t'u rritur të sigurt e pa trazime, shkollimi, mbrojtja e kërkesave dhe e të drejtave bazë, si Dita botërore e fëmijëve është caktuar 2 tetori.

Për shkak të rrezikut nga ndotja dhe të kërcënimit të planetit tonë, vëmendja e opinionit publik botëror është drejtuar gjithnjë e më seriozisht në kërkim të rrugëve për mbrojtjen dhe për ruajtjen e tij, kështu që janë të rëndësishme festat ndërkombëtare: Dita e planetit Tokë me 22 prill, Dita botërore e ujit me 22 mars, Dita botërore e mjedisit me 5 qershor, Dita ndërkombëtare e mbështjellësit prej ozoni me 16 shtator, Dita botërore e mbrojtjes së kafshëve me 4 tetor, Dita e shumëllojshmërisë biologjike me 29 dhjetor...





Ekzistojnë edhe manifestimet e tjera festive, karakteristike vetëm për vendbanimet e caktuara. Të tilla janë Ditët e mimozës, Ditët e kamelias, Nata bokelase, Dita e verës dhe e gjuhëzave, Ditët e luleve të bjeshkës, Ditët e boronicës, Vjeshta filmike e Mojkovcit, Takimet nën ullirin e lashtë, festivalet muzikore e teatrore.

Për jetën në të kaluarën mësojmë nga burimet e ndryshme: nga rrëfimet e njerëzve të vendbanimeve, nga dokumentet e shkruara, nga monumentet, nga sendet e objektet që dëshmojnë për jetën e dikurshme. Për ngjarjet dhe për personalitetet e rëndësishme të se kaluarës dëshmojnë shtëpitë, urat, objektet e kultit, emërtimet e rrugëve, tabelat përkujtimore, pllakat përkujtimore...

Disa qytete kanë lindur mbi gërmadhat e vendbanimeve që janë shkatërruar nga luftërat, nga termetet ose nga katastrofat e ndryshme natyrore. Për pamjen e këtyre vendbanimeve dhe për mënyrën e jetesës në to mësojmë nga gjurmët e ndryshme të shkruara që dëshmojnë për këtë kohë (fotografitë, dokumentet e shkruara, vizatimet, filmat). Për të kaluarën e vendbanimeve mësojmë në mënyra të ndryshme. Një prej tyre është udhëtimi në këto vendbanime, me qëllim hulumtimin dhe mbledhjen e të dhënave për karakteristikat e rëndësishme të këtij vendbanimi. Kur është fjala për udhëtimet, theksojmë se ato mund të jenë të ndryshme. Nxënësit do të nxjerrin përfundimin se udhëtim është edhe ardhja deri në shkollë, por se udhëtimi mund të jetë edhe shumë më i gjatë. Pse udhëtojnë njerëzit? Për shkak të punës dhe të detyrave të ndryshme, por edhe sepse kjo gjë u sjell kënaqësi, relaksim dhe shumë përvoja interesante. Natyrisht, mënyra apo mjeti i transportit ndikon esencialisht në përjetimin dhe në efikasitetin e udhëtimit. Në zhvillimin e vendbanimit influencon gjithashtu edhe zhvillimi i infrastrukturës së komunikacionit. Sa më i degëzuar që të jetë rrjeti i komunikacionit, aq më efikas dhe më intensiv do të jetë edhe komunikacioni i udhëtarëve dhe i transportit, pra edhe më i zhvilluar edhe vetë ai mjedis. Nga ana tjetër, dihet se mjetet e komunikacionit e ndotin ajrin dhe e pakësojnë cilësinë e jetesës në atë mjedis, kështu që gjithnjë e më shumë vëmendje i kushtohet zgjedhjes së mjeteve të komunikacionit që janë ndotës më të paktë.



# MOTI NDRYSHON

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të vihen re ndryshimet tek bimët në varësi të stinëve të vitit</li><li>• të dallohen bimët gjetherënëse dhe gjethembajtëse</li><li>• të vihet re se veprimtaritë e kafshëve ndryshojnë në varësi të stinëve të vitit</li><li>• të kuptohet se për jetën e bimës janë të nevojshëm uji, drita dhe ajri</li><li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën</li><li>• të zhvillohet vetëdija ekologjike</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	pyll, pylli gjetherënës (gjethor), pylli halor, pylli i përzier, dimërim, muajt e vjeshtës, muajt e dimrit, zogjtë shtegtarë, zogjtë jo shtegtarë

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Ndiqen ndryshimet e motit. Si është moti në krahasim me verën? Hartohet kalendari i motit për një javë.
2. Bisedohet me nxënësit për ndryshimet e pyllit në stinën e vjeshtës. Ç'ndryshime ndodhin në pyllin halor dhe në pyllin gjethor? Kur dhe përse shkojmë në pyll? Çfarë mund të shohim në pyll?
3. Vrojtohen drurët halorë në park. Vrojtohen e krahasohen degët e dëllinjës, të pishës, të bredhit e të selvisë. Preken dhe përshkruhen halat (gjethet e ngushta, lëkura mbështjellëse e fortë). Në ç'gjë ndryshojnë? Çfarë kanë të përbashkët? Ç'bimë rriten nën drurë?
4. Vizitohet pylli gjethor. Vrojtohen drurët gjethorë në park. Përshkruhet pamja e drurëve dhe e gjetheve. Ç'bimë rriten nën drurë?
5. Bisedohet për kafshët në vjeshtë. Si përgatiten ato për dimër? Cili do të bjerë në gjumë? Pse (mungesa e ushqimit, mospërshtatja e organizmit me temperaturat e ulëta)? Ku do ta bëjnë gjumin? Çfarë do të ndodhë me dallëndyshen, me gjerin e ngrënshëm, me bretkosën, me ketrin, (shtegton në vendet e ngrohta, dremit gjatë dimrit, bie në gjumin e dimrit, prehet në strofull.
6. Vrojtohet druri prej të cilit kanë rënë gjethet. Shihet renditja dhe gjatësia e degëve. Vizitohet druri në vjeshtë.
7. Shkohet me nxënësit në pyll në dimër. Shihen gjurmët në borë. Bëjnë supozimin se të kujt janë këto gjurmë. Si i dallojmë gjurmët e njeriut? Si i dallojmë gjurmët e kafshëve? Vrojtohen zgavrat e trungjeve dhe foletë. Kush mund të jetojë aty?
8. Bisedohet për kafshët në dimër. Si kalojnë dimrin kafshët që jetojnë në pyll? Si e gjejnë ato ushqimin? Krahasohen kafshët e pyllit me kafshët shtëpiake?
9. Vrojtohen drurët dhe bimët të cilave nuk u kanë rënë gjethet. Preken gjethet. Studiojnë trashësinë e tyre. Supozohet se pse nuk kanë rënë gjethet.
10. Vrojtohen bimët që jetojnë nën drurë. Vihet re sasia e dritës që depërton deri tek ato. Supozohet se kur ka më pak dritë në pyll dhe pse? Kur ka më shumë dritë?
11. Bisedohet, se për çfarë përdoret druri. Si mund të ndihmohet, që të pakësohet prerja e drurëve. (Me grumbullimin e letrës së vjetër).



### Puna me Tekstin mësimor:

Shihet kalendari. Lexohen emërtimet e muajve të vjeshtës. A është shtatori muaji “i vërtetë” i vjeshtës? Pse nuk është? Kur fillon vjeshta?

Shihen fotografitë dhe lexohen tekstet e shkruara. Cilët zogj shtegtojnë në viset e ngrohta? Pse shtegtojnë? Me çfarë ushqehen zogjtë joshtegtarë? Pse nuk shtegtojnë ato në viset e ngrohta? Çfarë bëjnë kafshët që do të bien në gjumin e dimrit ose që do të prehen në strofullën e vet? Pse e bëjnë këtë gjë?

Shihet kalendari. Lexohen emërtimet e muajve të dimrit. A është dhjetori muaji “i vërtetë” i vjeshtës? Pse nuk është? Kur fillon dimri?

Lexohet teksti i shkruar për lepurin dhe komentohet. Përshkruhet pamja e lepurit: Pse ndryshon ngjyra e gëzofit? Supozohet se në cilën stinë të vitit është më i trashë gëzofi i lepurit? Pse? Kur është më i hollë? Nga se varet trashësia e gëzofit? Me çfarë ushqehet lepurit gjatë dimrit? Bisedohet edhe se çfarë tjetër është mësuar për lepurin. Sa kohë duhet që të vijë në jetë i vogli i lepurit? Si duken të vegjlit në dy javët e para të jetës? Si i mbron nëna të vegjlit nga armiqtë?

### Puna me Fletoren e punës:

1. Nxënësit zgjedhin drurin në mjedisin përreth dhe e vizatojnë. Vrojttojnë drurin dhe shënojnë ndryshimet; kur kanë filluar ta ndryshojnë ngjyrën gjethet, kur kanë filluar të bien dhe kur kanë rënë plotësisht?
2. Shkruhet sesi përgatiten kafshët për dimër.
3. Plotësohen fjalitë dhe shkruhet se çfarë është mësuar për lepurin. Kush tjetër nuk do të bëjë gjumin e dimrit?
4. Shënojnë pohimet e sakta.

## NË TREGUN E FRUTA-PERIMEVE

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen nga nxënësit frutat, perimet dhe drithërat</li><li>• të vihet re lidhja ndërmjet bimëve dhe habitateve të tyre</li><li>• të njihen disa bimë zbukuruese</li><li>• të njihet lidhja midis bimëve, kafshëve dhe habitateve të tyre</li><li>• të kuptohet se për jetën e bimëve nevojitet uji, drita, ajri dhe dheu</li><li>• të kuptohet se toka duhet të mbrohet nga ndotja</li><li>• të vihet re se komunikacioni mundëson transportin e njerëzve e të mallrave</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	tregu i fruta-perimeve, dyqani i fruta-perimeve, kultivimi i bimëve, bimët zbukuruese, drufrutor, frut, hardhi, kopshtar, pemëtar, vreshtar, bujk, drithë, misër, grurë, frigorifer, serrë, magazinë, transport, dëmtues, preparate mbrojtëse



## Veprimtaritë e propozuara:

1. Organizohet vizita në tregun e fruta-perimeve. Shihet oferta në fruta dhe në perime. Ç'loj frutash dhe perimesh ka më shumë? Krahasohen çmimet e llojit të njëjtë të frutave dhe të perimeve? Pse janë të ndryshme çmimet? Nga se varet kjo gjë? Pyetet se ku janë kultivuar frutat dhe perimet? Si transportohen ato deri në treg? Ç'gjë është më e vështirë gjatë transportit? Çfarë bëhet me prodhimet që nuk shiten brenda ditës? Si dhe ku ruhen ato?
2. Përgatitet intervista me prodhuesin e një ferme bujqësore në varësi të sipërfaqes së tokës së punueshme që do të vizitohet (kopsht, pemishte, vresht, arë). Pyetjet për intervistën mund të jenë këto: Çfarë duhet të bëhet me tokën para se të mbillen bimët? Çfarë bëhet pas mbirjes së bimëve? Sa shpesh duhet të vaditen e të prashiten? Ç'masa mbrojtëse merren dhe si merren? Kur piqet bima? Si bëhet magazinimi i prodhimit? Çfarë bëhet me tepricat? A mund të konservohet bima (fruti)? Sa kohë ka që merren me profesionin e fermerit? Kush u ndihmon? Ç'vegla dhe makineri përdorin? A është ky profesion i vështirë ose i rrezikshëm. Ç'pajisje mbrojtëse përdorin gjatë punës? Si ndikojnë kushtet e motit në zhvillimin dhe në rritjen e bimëve? Si i mbrojnë bimët nga kushtet e këqija të motit? Nxënësit duhet të shkruajnë raportin. Nëse është e mundur, çdo paralele viziton sipërfaqe toke të ndryshme, ndërsa më pas, në një orë mësimi të përbashkët, shkëmbehen njohuritë e fituara.
3. Organizohet vizita në serra. Bisedohet me kultivuesin: Pse e kultivon pikërisht këtë bimë? Cilat janë përparësitë e serrës në raport me sipërfaqet e punuara të hapura të tokës? Çfarë nevojitet gjithsej për t'u ndërtuar një serrë? Si e marrin dritën bimët? Si ngrohet serra? Si vaditen bimët në serrë? A duhet të mbrohen bimët në serrë nga sëmundjet dhe nga dëmtuesit njëlloj sikurse bimët e mbjella në sipërfaqe të hapura? Për ç'gjë duhet treguar kujdes i veçantë në serrë? Ku i shet prodhimet e veta? Ku dhe si i magazinon ato?
4. Organizohet vizita në park. Emërtohen bimët dhe kafshët që gjenden në park. Cilat prej tyre i kanë parë në oborret e veta? I krahasojnë bimët për nga pamja. Cilët drurë mund t'i shohim në pyjet tona dhe cilët jo? Kush kujdeset për parkun? Pse i ngrenë parqet njerëzit?
5. Nxënësit ndërtojnë stendat e klasës për të gjitha llojet e tokave të punueshme (puna me grupe).
6. Përgatitet Libri i klasës i bimëve të kultivuara. Libri plotësohet me tekste interesante për bimët e kultivuara.
7. Organizohet vizita në farmacinë bujqësore. Bisedohet për kimikatet për mbrojtjen e bimëve. A do të jetë prodhimi më i mirë, nëse bimët trajtohen shpesh me këto kimikate (spërkatën, vaditen)? Lexohen udhëzimet për përdorimin e kimikateve. Çfarë do të ndodhë, nëse njeriu nuk u përmbahet udhëzimeve për përdorimin e tyre? (Rreziku për njeriun dhe për bimën.)
8. Nxënësit përgatitin prej brumi (ose prej plasteline) fruta të ndryshme të bimëve të kultivuara, i thajnë dhe i ngjyrosin ato.
9. Lexohen në enciklopedi, në revista dhe në botimet e tjera, tekste interesante për kultivimin e bimëve. Si ndikojnë ajri, uji dhe toka e ndotur në zhvillimin dhe në rritjen e bimëve?
10. Bisedohet për atë, sesi ndikon njeriu me veprimtaritë e veta në natyrë ndaj prishjes së ekuilibrit midis bimëve dhe kafshëve; zinxhiri i të ushqyerit (me shfarosjen e një lloji të caktuar mundësohet shtimi i pakontrolluar i një lloji tjetër).
11. Lexohen kuriozitete për kafshët që i dëmtojnë bimët në sipërfaqen e një lloji të caktuar të tokës së punueshme. Thuhet edhe shembulli i kundërt, me të cilin tregohet,



se kafshët mund të jenë edhe të dobishme (urithi i dëmton rrënjët e bimëve, por e ruan ekuilibrin e insekteve dhe e shkrifëron tokën. Termi dëmtues përdoret vetëm në kuptimin i padëshirueshëm ose i papërshtatshëm për zhvillimin e një bime të caktuar, ndërsa jo edhe në kuptimin e përgjithshëm.

12. Mbillet një bimë në klasë dhe ndiqet zhvillimi i saj.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Nxënësit shohin fotografitë e vizatimet, lexojnë tekstet e shkruara dhe i analizojnë ato. Cilët nga frutat dhe perimet e paraqitura rriten në krahinë e tyre? Emërtojnë sipërfaqet e tokave, në të cilat rriten bimët (pemishtja, kopshti, ara). Ç'fruta dhe perime nuk rriten tek ne? Prej nga sillen ato? Si transportohen? Ku kultivohen domatet në dimër? Përshkruhet pamja e serrës dhe nxirret përfundimi, për ç'arsye emërtohet kështu. A keni parë serra në mjedisin tuaj? Kur piqen mollët? Prej nga sillen mollët në pranverë dhe në verë?

Pse bimët që kultivohen në shtëpi, quhen bimë zbukuruese. A keni bimë zbukuruese në shtëpi? Kush kujdeset për to?

Bisedohet për pamjen dhe për funksionin e parkut, për bimët dhe për kafshët që do të ndeshin në të.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Priten figurat në Shtojcën nr. 2 dhe renditen për të treguar kronologjinë e procesit të përgatitjes së bukës. Vizatimet e renditura i ngjyrosin me ngjyrat përkatëse.
2. Në grupin e fjalëve gjejnë fjalën që nuk i përket grupit dhe e qarkojnë atë (misër, rrush, banane).
3. Shkruhet se sa kushtojnë frutat dhe perimet e paraqitura.
4. Qarkohen pohimet e sakta.
5. Pse është e domosdoshme larja e frutave (me spërkatje bimët mbrohen, por rrezikohet shëndeti i njerëzve).

**Mjete ndihmëse:** enciklopedi, miell, plastelinë

## **NË FERMËN BLEGTORALE**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen kafshët e vendbanimit</li><li>• të arrihet në përfundimin se bimët janë ushqim për kafshët</li><li>• të njihen kushtet për jetesën të kafshëve shtëpiake</li><li>• të arrihet në përfundimin se disa kafshë janë kanakarë</li><li>• të emërtohen profesionet (blegtor, veteriner)</li><li>• të vihet re se veprimtaria e kafshëve ndryshon në varësi të stinëve të vitit</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	kafsha shtëpiake, stallë, vathë, koteci i pulave (qymezi), i vogli (zogu), mashkulli, femra, pjell, shputa e këmbës, thundër, gji, krifë, turi, kthetër, lafshë, krahë, sqep, fermë, grazhd, ushqyes, inkubator



## Veprimtaritë e propozuara:

1. Përgatitet intervista me pronarin e një ferme blegtorale: Çfarë duhet të sigurohet për mbarështimin e bagëtive? (lopëve, derrave, deleve...) Me çfarë i ushqejnë kafshët? Sa herë në ditë i ushqejnë? Ku e sigurojnë ushqimin? A munden dhe si mund ta prodhojnë vetë ushqimin? A varet mënyra e ushqimit nga stinët e vitit? Çfarë do të ndodhë, nëse ushqimi i bagëtive është i parregullt dhe jo cilësor? Pse mbarështojnë pikërisht këtë kafshë shtëpiake? Kush u ndihmon? Si e mirëmbajnë ambientin, në të cilin strehohen bagëtitë? Çfarë bëjnë, kur sëmuret bagëtia? Cilat janë sëmundjet më të shpeshta dhe më të rrezikshme të bagëtive?
2. Organizohet vizita në fermën blegtorale ose të shpendëve (ferma e fshatit). Shihen kushtet e jetesës së bagëtive, veprimtaritë e njerëzve, mënyra e ushqimit dhe mirëmbajtja e higjienës në stallat e kafshëve shtëpiake. Bisedohet me pronarin.
3. Nxënësit bisedojnë për fermën, ku kanë qenë. Çfarë kanë mësuar? Ç'gjë tjetër dëshirojnë të mësojnë?
4. Përshkruhet pamja e kafshëve; me çfarë është i mbuluar trupi, emërtohen pjesët e trupit (shputa e këmbës, thundra, kthetrat, brirët, krifa, gjiri, bishti, turiri ose feçka).
5. Organizohet loja me aplikime. Në tre (ose më shumë) flanelografë varen fotografitë e kafshëve shtëpiake (lopa, delja, derri, pula), kurse në kuti vendosen aplikimet me fotografitë e produkteve që merren prej tyre (kosi, gjalpi, mish i thatë, yndyra... ). Detyra e grupit është që aplikimin e tërhequr t'ia bashkangjitet kafshës shtëpiake (ta ngjitet në flanelograf).
6. Përgatitet stenda e klasës me kafshët shtëpiake dhe me të vegjlit e tyre.
7. Kërkohen në enciklopedi dhe në revista detajet interesante lidhur me një kafshë shtëpiake dhe shkruhem informacionet.
8. Ndërtohet grafiku që paraqet kohët e ndryshme të mbarsjes (lopa 9 muaj, pela 12 muaj, delja 5 muaj, qeni 2 muaj ...).
9. Loja me pantomimë. Imitohet lëvizja e kafshëve dhe britmat ose zërat e tyre.
10. Shihet filmi për kafshët shtëpiake. Ç'gjë e re është mësuar?
11. Në orët e mësimit të muzikës këndohen këngë për kafshët shtëpiake.
12. Me plastelinë ose me ndonjë material tjetër, modelohen kafshët shtëpiake dhe të vegjlit e tyre.
13. Hartohen pyetjet për intervistën me veterinerin: Pse e keni zgjedhur pikërisht këtë profesion? Çfarë shkollë keni kryer? Sa zgjat shkollimi për profesionin tuaj? A keni uniformë pune dhe si duket ajo? Ç'instrumente përdorni më shpesh? Ç'gjë është e bukur në profesionin tuaj? Ç'gjë është e vështirë? Na tregoni ndonjë ndodhi interesante.
14. Organizohet vizita në stacionin e veterinarisë dhe ftohet në klasë veterinari.
15. Bisedohet për kafshët kanakare. Pse keni zgjedhur pikërisht këtë kanakar? Ku jeton ai? Ç'pamje ka? Në ç'mënyrë kujdeseni për të (ushqimi, higjiena)? Tregohen ndodhitë e këndshme e të pakëndshme me kafshët kanakare. Nxënësit që nuk kanë kafshën kanakare thonë arsyeën pse nuk e kanë.
16. Vizatohet ose shkruhet për kanakarët shtëpiakë (fëmijët që nuk i kanë, shkruajnë për kanakarët që dëshirojnë të kenë).

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit shohin fotografinë e fermës së lopëve. Vënë re brendësinë e fermës, si janë të vendosura kafshët dhe në ç'mënyrë e marrin ushqimin. Lexohen dhe komentohen tekstet e shkruara.



Çfarë mbarështon gjyshi i Llukës? Si i ushqen lopët? Në ç'gjë i ndihmon Lluka? Ku e vendos sanën? Në ç'mënyrë mund të milen lopët? Si quhet mashkulli i lopës? Si quhet i vogli i lopës? Pyetet, sa muaj zgjat mbarsja e lopës (9 muaj). Ç'dobi kemi nga lopa? Çfarë përftohet nga qumështi? Kush i mjekon bagëtitë e sëmura? Shihet fotografia e fermës së shpendëve. Çfarë mbarështon daja i Anës? Me çfarë është i mbuluar trupi i pulës? Për ç'gjë i shfrytëzojnë puçllat njerëzit? Si quhet mashkulli i pulës dhe si quhet i vogli i saj. A i pjell zogjtë pula? Si vijnë në jetë zogjtë e pulës? Çfarë "pune" bën inkubatori? Me çfarë ushqehen puçllat? Ç'dobi kemi nga puçllat?

Nxënësit emërtojnë kanakarët shtëpiakë. Cilët prej tyre jetojnë në shtëpi dhe cilët mund të mbahen në oborr? Ç'kanakarë të tjerë shtëpiakë njihni? Pse i mbarështon njeriu kanakarët shtëpiakë? A kemi dobi edhe prej tyre?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Në bazë të fjalëve të dhëna, nxënësit njohin kafshën shtëpiake dhe plotësojnë tabelën.
2. Shkruhen pjesët e trupit të gjelit (lafsha, sqepi, krahu, kthetrat).
3. Zgjidhet fjalëkryqi. Shkruhet zgjidhja e fjalëkryqit dhe plotësohet fjalia e filluar (veterinar.... sëmuret bagëtia).
4. Vizatohet kafsha e dashur shtëpiake. Plotësohen fjalitë për kafshën kanakare.

**Mjete ndihmëse:** aplikime me vizatime kafshësh shtëpiake, plastelinë

## **VENDBANIMI IM**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihet re zhvillimi i vendbanimit ku jetohet</li> <li>• të shpjegohet sipas kujt apo sipas ç'gjëje është emërtuar vendbanimi</li> <li>• të dallohet lagjja e vet në vendbanimin ku jetohet</li> <li>• të njihen emërtimet e lagjeve të tjera të vendbanimit</li> <li>• të vihet re se ekzistojnë vendbanimet e mëdha dhe vendbanimet e vogla</li> <li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit mbi ndryshimet në natyrën e vendbanimit</li> <li>• të njihen problemet kryesore lidhur me ndotjet në vendbanimin e vet</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	vendbanim, fshat, qytet, vendbanimi fushor, vendbanimi malor, vendbanimi bregdetar, popullsi

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Mësuesi shkruan në një stendë fjalën fshat dhe në një tjetër fjalën qytet. Stendën e tretë, që gjendet midis dy të parave, e lë të pashkruar. Çdo nxënës shkruan në fletë të veçanta nga dy karakteristika të fshatit dhe të qytetit. Fletët përzihen. Në stenda vendosin fillimisht fletët që përshkruajnë fshatin dhe qytetin, ndërsa në stendën e tretë karakteristikat e përbashkëta të qytetit e të fshatit.
2. Vihen re dallimet midis fshatit e qytetit. Nxirret përfundimi se ekzistojnë vendbanimet e mëdha dhe të vogla. Krahasohet fotografia e vendbanimit të vet me fotografitë e





- shikuara. Nxirret përfundimi, se madhësia e vendbanimit varet nga numri i shtëpive (banesave). Nxirret përfundimi, se jetohet në vendbanime të mëdha ose të vogla.
3. Organizohet vizita në vendbanimin ku jetohet. Në varësi të mundësive, nga ndonjë lartësi, përshkruhet konfiguracioni i terrenit dhe emërtohen pjesët e vendbanimit që shihen. Krahasohen sipas madhësisë objektet e banimit (shtëpitë, ndërtesat). Nxirret përfundimi, se prej cilave ka më shumë. Sa familje jetojnë në shtëpi private dhe sa në banesa të përbashkëta (në apartamente)? Ku jetojnë më shumë banorë, në fshat apo në qytet? Ku ka më shumë ambiente të lira, në fshat apo në qytet? Shihen objektet e reja. Bisedohet për funksionin e tyre. Në cilën pjesë të vendbanimit janë ndërtuar? Pse pikërisht atje? Në cilën pjesë të vendbanimit nuk ka më hapësira për ndërtimin e objekteve të reja dhe pse?
  4. Nëse ka mundësi organizohet ekskursioni në një vendbanim që dallohet mjaft nga vendbanimi ku jetohet (nxënësit nga fshati vizitojnë qytetin, kurse ata nga qyteti vizitojnë fshatin). Pas ekskursionit, thuhet çfarë është parë lidhur me pamjet e ndryshme midis vendbanimit të vet dhe vendbanimit që kanë vizituar.
  5. Bisedohet për mjediset në të cilat njerëzit njihen më mirë me njëri-tjetrin. Pse njihen më pak me njëri-tjetrin njerëzit në qytetet e mëdha? Thuhet mangësitë dhe përparësitë e jetës në vendbanimet e vogla dhe në qytetet e mëdha.
  6. Pyetet për kohën e krijimit të vendbanimit dhe për emërtimin e tij. Si e ka marrë emërtimin vendbanimi? A është ndryshuar emërtimi?
  7. Bisedohet për fabrikat e vendbanimit. Ku janë ngritur ato? A është mirë, që fabrikat të ndërtohen pranë qendrës së banimit? Pse është më mirë, që të jenë larg qendrës së banimit? Çfarë prodhohet në to? A prodhohet edhe ndonjë gjë tjetër përveç gjërave të dobishme? Çfarë do të ndodhë, nëse vendbanimi do të zgjerohet në atë drejtim? Çfarë propozohet në këtë rast? Ç'objekt tjetër në vendbanim ose në rrethinë ndikon në mënyrë të dëmshme mbi botën e gjallë?
  8. Grumbullohen kartolinat dhe fotografitë e vendbanimit të vet dhe bëhet me to stenda e klasës. Nëse është e mundur, fotografohet bashkë me mësuesin vendbanimi. Bisedohet me të moshuarit për të kaluarën e vendbanimit.
  9. Grumbullohen tekste interesante të shkruara për vendbanimin. Bisedohet me të moshuarit për të kaluarën e vendbanimit të vet. Si është quajtur dikur? Si është dukur dikur? Në ç'gjë ka ndryshuar më shumë? Çfarë s'ka qenë dhe çfarë ka qenë më e bukur atëherë...?
  10. Nxënësit ndahen në grupe sipas vendit ku banojnë. Detyrë e çdo grupi është të përshkruajë rrugën nga shtëpia deri në shkollë (larg shkollës, pranë shkollës, kalon një ose disa rrugë, kalon pranë objekteve të rëndësishme).
  11. Çdo nxënës paraqet me vizatim (skicë) rrugën e vet nga shtëpia deri në shkollë (është mirë të shkruhen rrugët kryesore dhe objektet karakteristike).
  12. Bëhet skica e klasës (paraleles) për lagjet e veta në raport me shkollën. Nxënësit që udhëtojnë nga vendbanimet e tjera e plotësojnë skicën me vendndodhjen e vendbanimit të tyre në raport me shkollën.
  13. Paraqitet me vizatim pamja e vendbanimit.
  14. Bëhet maketi (me kuti të vogla të bonboneve ose me kuti shkrepsesh) i objekteve karakteristike të vendbanimit (shtëpitë private, banesat e përbashkëta a apartamentet) dhe plotësohet maket-relievi i klasës.
  15. Bisedohet për lidhjet midis qytetit dhe fshatit. Tregohet përvoja vetjake nga jeta në fshat dhe në qytet (në varësi të vendit ku jetohet). Çfarë i "jep" fshati qytetit, ndërsa çfarë qyteti fshatit?
  16. Jepen shembuj të qëndrimit të rregullt e të parregullt të njeriut ndaj vendbanimit të vet. Si mund të ndihmohet në ruajtjen dhe në mbrojtjen e mjedisit?





17. Shprehen dëshirat vetjake lidhur me vendbanimin që dëshirojnë të vizitojnë duke thënë shkaqet pse e dëshirojnë këtë gjë.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë dhe komentohet përmbajtja e tyre. Vihen re ngjasimet dhe ndryshimet midis fshatit dhe qytetit. Çfarë ka në qytet, ndërsa nuk ka në fshat dhe anasjelltas. Lexohet teksti i shkruar dhe bisedohet për të. Cila fotografi u kujton më shumë vendbanimin e vet?

Bisedohet për mënyrën e të orientuarit në një vendbanim të madh. Vihet re, se ku është vendosur emërtimi i rrugës (në anën e djathtë), në ç'anë janë vendosur numrat çift të objekteve (në anën e djathtë të rrugës) dhe numrat tek (në anën e majtë të rrugës). Pse mund të ndodhë nganjëherë që numri 56 të ndodhet larg numrit 57? Në bazë të fotografive, vihet re lidhja ndërmjet qytetit e fshatit. Çfarë prodhohet në fshat dhe çfarë në qytet?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Qarkohen fjalët, që përshkruajnë vendbanimin e nxënësve.
2. Shënohet numri dhe ngjyroset shtëpia e Lejlës dhe e Filipit, në bazë të adresave të dhëna.
3. Lidhet vizatimi me fshatin ose me qytetin.
4. Plotësohen fjalitë për vendbanimin e vet.

**Mjete ndihmëse:** karton (hamer), kuti kartoni

## **FESTOJMË**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen festat në vendbanimin e vet dhe mënyra e kremtimit të tyre</li><li>• të emërtohen festat: Dita e Shkollës, Dita e vendit, festat më të rëndësishme fetare, Viti i Ri, Dita e Gruas, Dita e Punës ...</li><li>• të njihen kremtimet e ndryshme që organizohen në vendbanim (balloja me maska, karnavali, Ditët e kulturës...).</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	festë, kremtim, Viti i Ri, Një Maji, Dita e Gruas, Krishtlindjet, Bajrami, Pashkët, vendi i festës, festival, manifestim, ngjarje kulturore.

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Bisedohet për festat që festohen në vendbanim. Kur festohen? Pse festohen? Kush i feston? Cila festë u pëlqen më shumë? Pse? Ç'tradita janë të lidhura me atë festë? Nxënësit përpiqen t'i sqarojnë traditat?
2. Shikohet filmi ose fotografitë për festimin e një feste ndërkombëtare në vendet e ndryshme të botës. Bëhet krahasimi me festimin e kësaj feste në vendbanimin e vet.



3. Përgatitet intervista dhe ftohet i ftuari, i cili do të flasë për festimet në të kaluarën. Bëhet krahasimi me festimin tani të këtyre festave.
4. Në Kalendarin e murit gjenden dhe shënohen datat e festave. Festat ndërkombëtare shënohen me një ngjyrë, kurse ato të vendbanimit të vet me një ngjyrë tjetër.
5. Pyetet për festat për ruajtjen e mjedisit natyror; Ditët ekologjike dhe datat e këtyre festave shënohen me ngjyrë të gjelbër.
6. Bëhen përgatitjet për pjesëmarrjen në manifestimet që shoqërojnë festat (përgatiten maskat, shkruhen mesazhet).
7. Grumbullohen fotografitë nga festimet në vendbanim dhe përgatiten me to standat e klasës.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë dhe bisedohet për kremtimin e festave që janë paraqitur në to. Vihet re se disa festa kremtohen në familje, disa në vendbanim, kurse disa në të gjithë botën. Tregohet përvoja vetjake lidhur me festat, në të cilat është marrë pjesë. Cilës festë i gëzohemi më shumë dhe pse? Si përgatiteni për festën? Ku dhe me kë e festoni?

Bisedohet për traditat lidhur me festat fetare? Cilat tradita u pëlqejnë? Vihet re, se çdo festë ka karakteristikat e veta, se festat i lidhin njerëzit e besimit të njëjtë, por edhe ato të besimeve të ndryshme, siç është kremtimi shtatëditor kushtuar Shën Tripunit, pajtorit të qytetit të Kotorit (fillon me 27 janar, në Ditën e Shën Savës, ndërsa përfundon me 2 shkurt, në Ditën e Shën Tripunit, me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të besimit ortodoks e katolik. Cilat festa i festojnë pjesëtarët e të gjitha besimeve (festat shtetërore)

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Shkruhen festat që festohen (kremtohen) në vendbanimin e vet dhe me ato që festohen në të gjithë botën.
2. Shkruhen dëshirat e Vitit të Ri për prindërit, për vëllanë, për motrën, për shokun/shoqen më të mirë ...
3. Në bazë të bisedës me të moshuarit, përshkruhet një festë nga vendbanimi i vet.
4. Kërkohen emërtimet e festave (Viti i Ri, Një Maji, Tetë Marsi, Pashkët, Bajrami) dhe shkruhen.

**Mjete ndihmëse:** film ose fotografi të ndonjë feste ndërkombëtare, karton

## **RRUGA “NJEGOSH”**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihet rëndësia e trashëgimisë</li><li>• të dallohen ndryshimet në pamjen e vendbanimit</li><li>• të njihen disa nga personalitetet e shquara të së kaluarës që janë të lidhura në një farë mënyre me vendbanimin</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	ndërtesa e vjetër, qyteti i vjetër, personaliteti i shquar i së kaluarës, monument, trashëgimi, kështjellë (kala)



### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Vizitohen ndërtesat e vjetra të vendbanimit (shtëpi, ura, objekte kulturi ...). Shikohet pamja e objektit. Dallohet materiali me të cilin është ndërtuar. Përcaktohet funksioni i objektit. Vlerësohet vjetërsia e tij (e kaluara e afërt apo e largët) dhe sa është i ruajtur. Nëse bëhet fjalë për shtëpi, dallohet: materiali prej të cilit është ndërtuar, brendësia e saj, dyshemetë, ambientet dhe funksioni i tyre, forma dhe madhësia e dritareve etj. Ç'ambiente nuk ka shtëpia e vjetër, ndërsa i kanë shtëpitë e reja? Ç'ndryshime të tjera vihen re? Si duket oborri i shtëpisë? Prej se është bërë muri rrethues? Kush kujdeset për shtëpinë? Cili është sot funksioni i saj? Çfarë u pëlqen më shumë tek shtëpia?
2. Vizatohet ose modelohet objekti i vëzhguar (me plastelinë, me argjilë, me karton, me bojëra tempera, me thupra, me parmakë dërrasash).
3. Nxënësit grumbullojnë në grupe informacione për objektet e vjetra (për urat, për objektet e kultit, për shtëpitë e vjetra, për qytetin e vjetër). Hulumtojnë vjetërsinë e objektit, kush e ka ndërtuar dhe për ç'qëllim e ka ndërtuar, materiali prej të cilit është ndërtuar, sa është i ruajtur, kush kujdeset tani për të. Me materialin e shkruar të mbledhur hartojnë Librin e klasës.
4. Mblidhen fotografi ose vizatime të objekteve të vjetra të vendbanimit të vet ose të mjedisit përreth dhe formohet me to stenda e klasës.
5. Bisedohet me të moshuarit për personalitetet e rëndësishme të së kaluarës së vendbanimit të vet. Pse janë të rëndësishëm? Me ç'veprimtari janë marrë?
6. Mblidhen fotografi të personaliteteve të rëndësishme të vendbanimit dhe ngjiten në Librin e klasës.
7. Nëse ka mundësi, shihet filmi për të kaluarën e vendbanimit të vet dhe vihen re ndryshimet në pamjen e vendbanimit të vet tani dhe dikur.
8. Mësuesi organizon konkursin me temë "Çfarë di për të kaluarën e vendbanimit tënd?"

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shikohen fotografitë dhe vizatimet e ndërtesave të vjetra dhe të personaliteteve të rëndësishme të së kaluarës. Nxënësit pyeten, nëse ka objekte të tilla në vendbanimin e tyre. Ç'gjë kanë të përbashkët ato? Ç'objekte të tjera të vjetra ekzistojnë në vendbanimin e tyre, por nuk janë paraqitur në fotografi?

Cilat personalitete të rëndësishme kanë jetuar dhe kanë punuar në vendbanimin e tyre? Me ç'veprimtari janë marrë ata? Si tregohet, se ata kujtohen me nderim? (Emrat e tyre mbajnë ndërtesat e rëndësishme, rrugët, manifestimet kulturore...)

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Plotësohen fjalitë për shtëpinë më të vjetër në vendbanimin e vet ose në mjedisin përreth.
2. Shkruhet për urat në vendbanimin e vet.
3. Vizatohet një objekt i së kaluarës.
4. Shkruhet për personalitetin e shquar të së kaluarës së vendbanimit të vet. Ky mund të jetë një person nga e kaluara e afërt, e largët ose shumë e largët, por edhe nga fushat e ndryshme të veprimtarisë, siç janë sporti, arti, shkenca, kultura etj.
5. Ngjitet fotografia e personalitetit të shquar nga vendbanimi i vet.

**Mjetet ndihmëse:** material për modelim, fotografi të objekteve të vjetra, karton



## UDHËTOJMË

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të vihet re se komunikacioni mundëson transportin e njerëzve dhe të mallrave</li><li>• të dihet sesi zhvillohet komunikacioni në vendbanim</li><li>• të dihet se me ç'mjete komunikacioni qarkullohet</li><li>• të tregohet sjellja e rregullt në mjetet e komunikacionit publik</li><li>• të emërtohen profesionet karakteristike në komunikacion</li><li>• të dallohet sjellja e rregullt dhe e parregullt në rrugën nga shtëpia deri në shkollë</li><li>• të shpjegohet sesi rregullohet qarkullimi rrugor</li><li>• të parashikohen pasojat e mosrespektimit të rregullave në qarkullimin rrugor</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	komunikacion, automjet, mall, ngarkesë, udhëtar, automjeti i udhëtarëve dhe i transportit, profesioni në qarkullimin rrugor (në komunikacion), ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ndotja e tokës

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit nxirren në udhëkryqin më të afërt. U jepet detyrë, që të vëzhgojnë, sesi zhvillohet komunikacioni në udhëkryq, kush janë pjesëmarrësit në komunikacion, kush e rregullon komunikacionin? Vënë re sjelljen e rregullt dhe të parregullt të pjesëmarrësve në komunikacion, numrin e vozitësve dhe të këmbësorëve në momentin e vëzhgimit. E krahasojnë dendësinë e komunikacionit, kur ata vijnë në shkollë dhe kur kthehen në shtëpi. Nxjerrin përfundimin, kur është më i dendur komunikacioni dhe pse?
2. Në klasë shënojnë atë që kanë vëzhguar. Në tabelë, shkruajnë të dhënat për pjesëmarrësin në komunikacion, përshkruajnë sjelljen e tij dhe parashikojnë pasojat e mundshme të mosrespektimit të kulturës së komunikacionit.
3. Bëhet konkretizimi me mjetet e ndryshme të transportit (biçikleta, kamioni, rolerët, aeroplani, helikopteri, treni, autobusi, anija, karrot, triçikli ...). Nxënësve u ndahet nga një mjet konkretizimi. Caktohen kriteret e klasifikimit (lëviz në ajër ..., ka rrota ..., e vë në lëvizje motori ..., nuk e ndot ajrin ..., transporton mallra ...). Nxënësi, me ngritjen e mjetit të konkretizimit, përgjigjet ndaj kërkesave të bëra. Në rastet e gabimeve të mundshme, nga nxënësi kërkohet që të sqarojë pse p.sh. e ka ngritur mjetin konkretizues të biçikletës tek kërkesa "mjet transporti".
4. Nxënësit, në klasë ose në poligon, paraqesin një situatë komunikacioni. Tre nxënës mbajnë në duar kartonët rrumbullakë me ngjyrë të kuqe, të gjelbër dhe të verdhë duke simuluar semaforin, në ç'rast duhet të tregojnë kujdes në sinkronizimin e ndryshimit të ngjyrës në semafor. "Këmbësorët" dhe "shoferët" ndjekin sinjalizimin e komunikacionit dhe përfshihen në komunikacion (nga dy drejtime). Pas kësaj, në komunikacion përfshihet edhe polici rrugor (sinjalizimi me ngjyra vazhdon, ndërsa "pjesëmarrësit" duhet të ndjekin lëvizjet e policit rrugor). Vëzhguesit ndjekin dhe shënojnë sjelljen e "pjesëmarrësve" dhe, pas lojës, komentojnë kush i ka respektuar dhe kush nuk i ka respektuar rregullat.
5. Nxënësit ndahen në katër grupe. Çdo grupi i jepet nga një vizatim, në të cilin është



paraqitur loja me rrezik e fëmijëve ose sjellja e parregullt në rrugë, që mund të sjellë aksidentin. Detyra e çdo grupi është, t'i parashikojë pasojat e sjelljes së parregullt dhe për këtë shkruhet një tregim.

6. Me karton, stiropor, kuti shkrepsesh, shkopinj akulloresh, plastelinë dhe materiale të tjera, përgatitet maketi i udhëkryqit më të afërt. Në maket mund të paraqitet parku, ndërtesat pranë, tregu, monumenti etj.
7. Grumbullohen tekste të shkruara, vizatime e fotografi interesante për komunikacionin dhe për mjetet e komunikacionit si dhe përgatitet stenda e klasës "Komunikacioni dikur dhe sot"
8. Bisedohet për zhvillimin e komunikacionit dhe paraqitet me vizatim përfytyrimi personal për komunikacionin dhe për mjetet e komunikacionit në të ardhmen.
9. Lexohen fragmente (nga revistat, enciklopeditë, të dhënat nga interneti) për ndotjen e ajrit, të ujit dhe të tokës. Çfarë propozojnë nxënësit për pakësimin e ndotjes? Çfarë do të bënin ata vetë për pakësimin e ndotjes?

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Nxënësit shohin vizatimet në të cilat paraqitet, sesi është udhëtuar dikur. Çfarë nga kjo është ruajtur deri sot?

Analizohet udhëtimi dhe mjetet e udhëtimit në kohën e sotme. Komentohet sesi udhëtojnë më shpesh nxënësit. Thuhet shkaqet e zgjedhjes së mjetit të transportit. Nga se varet, nëse do të udhëtojnë në këmbë apo me ndonjë mjet transporti? Cilat mjete transporti transportojnë udhëtarë? Cili prej tyre është më i shpejtë? Kur udhëtojmë me aeroplan?

Cilat mjete transporti transportojnë ngarkesa? Cilat mjete transporti ndeshim më shpesh dhe çfarë transportojnë ato? Shihen fotografitë e mjeteve të transportit dhe komentohet se çfarë transportohet me to?

Cilat mjete transporti transportojnë më shumë udhëtarë. Ku nis udhëtimi me autobus dhe ku nis udhëtimi me tren? Ku blihen biletat? Në ç'mënyra mund të mësohet se kur niset autobusi dhe treni nga stacioni?

Cilat mjete të udhëtimit e ndotin më shumë ajrin? Kur dhe me ç'shqisa mund të ndjehet kjo gjë? (Në kohën e lëvizjes më të madhe në rrugë, kur gjendemi pas kamionit ose kur jemi në kolonën e automjeteve.)

Thuhet profesionet lidhur me komunikacionin.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Plotësohet tabela.
2. Parashikohet se çfarë mund të ndodhë në situatat e paraqitura në figurat ilustruese. Pse gabon fëmija që është mbajtur pas shkallëve të anijes? Çfarë do të ndodhë, nëse anija nis të lundrojë? Çfarë mendoni për veprimin e tij? A keni parë diçka të ngjashme kur keni qenë për pushime verore? Çfarë po luajnë fëmijët në fugurën tjetër ilustruese? Cili prej fëmijëve nuk vepron siç duhet? Pse?
3. Plotësohet tabela. Në rreshtin e fundit shtohet edhe ndonjë mjet udhëtimi më të cilin udhëtohet.
4. Përshkruhet një nga udhëtimet vetjake: Ku keni udhëtuar? Ku ka filluar udhëtimi? Ku ka përfunduar? Çfarë ju ka pëlqyer dhe çfarë nuk ju ka pëlqyer?

**Mjetet ndihmëse:** Skedat me emërtimet ose me figurat e mjeteve të komunikacionit: materiali për punimin e maketit të udhëkryqit, rrathët prej kartoni (i kuq, i gjelbër, i verdhë).



# SHOH DHE DËGJOJ

Kapitulli **Shoh dhe dëgjoj** përmban 6 tema mësimi të përafërta e të lidhura me njëra-tjetrën: *Shikoj, shoh; Vë vesh, dëgjoj; Kujdesem për shëndetin; Ku ka ajër?; Uji ka avulluar; Sheqeri është tretur.*

**Qëllimet:** nxënësit zhvillojnë dhe përvetësojnë nocionet dritë dhe shikim; përvetësojnë nocionin tingull (zë), dinë si krijohet, si transmetohet, cilat janë karakteristikat e tij, si mund t'i shfrytëzojnë këto njohuri në situatat e përditshme; njihen, kuptojnë dhe aplikojnë njohuritë për shkaktarët e sëmundjeve dhe për masat mbrojtëse të shëndetit; përsëritin dhe zgjerojnë njohuritë për ndryshimet e materies nën ndikimin e ajrit, dritës, nxehtësisë dhe ujit; njohin dhe përvetësojnë nocionin gazet, përmes prototipit të ajrit; vënë re dhe shohin procesin e avullimit e të kondensimit si operacione shndërruese; vënë re dhe kuptojnë proceset e tretjes e të kristalizimit si procese të kundërta, por reciprokisht të kushtëzuara e të ndërvarura.

Duke u nisur nga fakti se nxënësit i ndërtojnë fillimisht nocionet sipas përshtypjeve shqisore dhe veprimtarive praktike, duke filluar nga paraqitjet me figura dhe deri tek simbolet, me anën e të cilave ata veprojnë mendërisht, është e qartë se shikimi nuk kërkon një përfshirje të tillë aktive që do të na çonte tek njohja më e thellë dhe tek përpunimi mendor. Nocionet dritë dhe shikim formohen më vonë, në një nivel më të lartë të zhvillimit mendor. Në themel të kuptimit dhe të përvetësimit të vetëdijshëm të nocionit dritë, gjendet përfytyrimi i suksesshëm mendor dhe njohja për lëvizjen e dritës. Që nxënësit t'i kuptojnë nocionet, duhet që t'u afrojmë atyre esencën e procesit të lëvizjes së dritës në mënyrë të kuptueshme dhe interesante, duke u nisur nga përvojat e afërta e të fituara prej tyre. Për këtë arsye, shprehjet: drita lëviz, drita reflektohet, drita përhapet ose drita depërton etj., përshkruajnë lëvizjen dhe ndikojnë gradualisht në formimin e konceptit dritë. Po ashtu, me qëllim të kuptimit të plotë të dritës dhe të procesit të shikimit, nisemi nga njohjet e thjeshta: që të shohim, duhet t'i hapim sytë, në të kundërtën, nëse i mbyllim sytë, nuk shohim. Në errësirë nuk shohim; drita na mundëson që t'i shohim qartë objektet. Në kushte të tilla mund të zhvillohet procesi i shikimit i bazuar në njohjen se rrezet e dritës (drita) reflektohen prej objekteve si edhe në dallimin e asaj që ndriçon (burimi i dritës) nga ajo që ndriçohet. Se drita lëviz në ajër në vijë të drejtë, arrijmë në përfundim duke e shikuar tufën e dritës që kalon nëpër ajrin me grimca pluhuri ose nëpër pikat e ujit. Edhe hijet tregojnë lëvizjen drejtvizore të dritës.

Lidhur me dritën trajtojmë edhe konceptimin e ngjyrës. Në shkencat natyrore, ngjyra nuk trajtohet vetëm si veçori e sendeve, por shihet e lidhur ngushtë me dritën. Kështu, ngjyra e bardhë përmban disa ngjyra. Ngjyra e kuqe e një objekti reflekton ngjyrën e kuqe, kurse të tjerat i thith. Por, nëse ngjyra nuk është e bardhë, por me ngjyra, ndryshe do ta shohim ngjyrën e një sendi. Topi blu nën dritën e verdhë duket i zi, sepse ngjyra blu nuk e reflekton dritën e verdhë, por e thith. Ngjyra nuk është vetia parësore e materies, por rezultati i raporteve midis dritës dhe materies mbi të cilën bie drita.

Organi i shqisës së të parit është syri. Figura që krijohet në sy, vepron mbi nervin e syrit, i cili e përcjell ngacmimin në tru. Shikimi është procesi që përfaqëson lidhjen e



informacioneve që arrijnë në tru me anë të nervit të shikimit. Kjo do të thotë se mësojmë të shohim (hapësirën, të dallojmë forcën e dritës, të dallojmë ngjyrat dhe nuancat e tyre, të përcaktojmë largësinë dhe të vëmë re lëvizjen). Zhvillohet edhe ndjesia për madhësinë e trupit. Informacionet pamore, përveç të të dhënave që përftojmë fillimisht, mund ta na drejtojnë edhe tek disa karakteristika të tjera të objektit a të dukurisë së vrojtuar. Lidhur me këtë, u rikujtojmë fëmijëve disa nga përvojat e tyre, si për shembull, se sipas ngjyrës mund të nxjerrin përfundimin për shijen e ushqimit ose për koncentrimin (koncentrimi më i vogël i lëngut të frutave, pra tretësira më pak e ngjyrosur, do të thotë se lëngu është më pak i ëmbël), për reflektimin e ngjyrës lidhur me atë, nëse sipërfaqja e trupit është e lëmuar ose e zhubravitur.

Këtë vit shkollor nxënësit do të njohin edhe karakteristikat e zërit. Ashtu sikurse edhe drita, zëri udhëton përmes ajrit nga burimi deri tek shqisat tona. Zëri krijohet kur një trup vibron. Kur vala zanore arrin përmes ajrit tek veshët, shkaktohet ngacmimi (sinjali nervor), i cili arrin deri në tru. Kur flasim, vibrojnë kordat zanore, kurse në telefon ose në altoparlant dridhet membrana. Zëri (tingulli) nuk përhapet vetëm në ajër, por edhe përmes lëngjeve dhe materieve të ngurta. Përmes gazeve, zëri “udhëton” relativisht ngadalë. Shpejtësia e zërit në ajër është 340 m/s, në ujë është afërsisht 1500 m/s, ndërsa përmes drurit është 4.000 m/s. Tingulli (zëri) përhapet vetëm përmes materieve, ndërsa në hapësirat pa ajër nuk ekziston (për këtë arsye në kozmos sundon heshtja). Me zmadhimin e largësisë nga burimi, intensiteti i tingullit (zëri) dobësohet.

Lartësia e zërit varet nga frekuenca d.m.th. nga numri i dridhjeve në njësinë e kohës. Nëse frekuenca është e lartë, tingulli (zëri) është më i fortë. Frekuenca shprehet në herc (Hz) – me numrin e dridhjeve në një sekondë. Veshi i njeriut dallon tingujt (zërat) me frekuencë 20-20.000 herc. Tingulli (zëri) me frekuencë mbi 20.000 Hz quhet ultratingull. Ultratingujt përdoren në mjekësi dhe në industri. Fuqia e zërit shprehet me decibel (dB). Biseda me zë ka forcën prej 40 dB. ndërsa uturima e aeroplanit e ka forcën 130 dB; zero decibel shënon heshtjen e plotë. Në aparatet akustike bashkëkohore, forcën e zërit mund ta lexojmë në ekran. Tingulli (zëri) që arrin deri tek veshi ynë, nuk vjen vetëm nga burimi, por duke u reflektuar prej objekteve përreth. Bisedohet për atë se nga se varet akustika e ambientit. Sipërfaqet e lëmuara dhe të ngurta e reflektojnë më mirë zërin. Zëri arrin tek muri dhe pjesërisht reflektohet, ndërsa pjesërisht e vazhdon rrugën përmes murit. Nëse muri është i trashë, zëri shuhet thuajse plotësisht. Nga ana tjetër, materialet e buta, të zhubravitura e të ashpra e thithin më mirë tingullin (zërin).

Tingulli (zëri) ndihmon shumë edhe gjatë orientimit në hapësirë, edhe në komunikacion. Sipas tingullit (zërit), d.m.th. ngjyrës, lartësisë e forcës, mund të përcaktohet lloji i automobilin dhe largësia e tij prej nesh. Po ashtu, sipas tingullit (zërit) mund të përcaktojmë, nëse punon në rregull një motor apo një makineri (ka apo s'ka avari). Shumë zëra të ndryshëm krijojnë zhurmën, e cila e pengon burimin dhe, për këtë arsye, nuk mund ta marrim lehtë informacionin.

Këtë vit shkollor flitet përsëri për mbrojtjen e shëndetit. Nxënësit mësojnë më shumë për shkaktarët e sëmundjeve. Mikroorganizmat, midis tyre edhe patogjenet, janë qenie të vogla, të cilat nuk i shohim me sy, por që gjenden kudo rreth nesh. Kur arrijnë në trupin tonë shtohen ose sekretojnë lëndë helmuese, shkaktojnë kështu sëmundje, të shoqëruara me simptoma të ndryshme. Bisedohet me nxënësit për mënyrën sesi arrijnë në trupin tonë mikrobet. Kjo mund të ndodhë në mënyra të ndryshme:

- përmes organeve të frymëmarrjes (hunda, goja), kur thithim ajrin e ngopur me mikrobe. Nxënësve u rikujtohet se ka rëndësi që kur kolliten ose kur teshtijnë, ta vënë dorën në gojë, të kujdesen për higjienën e përgjithshme, si edhe rëndësia që ka ajrosja e ambienteve për pastrimin e ajrit dhe për krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm.





- Mikrobet i futim në gojë përmes duarve e ushqimeve të palara. Prandaj, ka rëndësi që të mirëmbahet me kujdes higjiena, sepse kështu zvogëlohet numri i mikrobeve. Nxënësit shpjegojnë se pse duhet patjetër t'i lajnë duart para ngrënies dhe pas daljes nga banjoja. Edhe dhëmbët duhet t'i lajmë, në mënyrë që të mos na shtohen mikrobet në gojë dhe të shkaktojmë prishjen e dhëmbëve.

- Kur kemi ftohtë, trupi ynë është më pak rezistues dhe nuk mund të mbrohet me sukses nga mikrobet. Megjithatë ne nuk ftohemi nga që kemi ftohtë, por për arsye sepse na pakësohet rezistenca. Temperatura e ulët shkakton ftohjen e mukozës (nën 37 gradë), e cila mbulon organet e frymëmarrjes. Për këtë arsye është e dobësuar flora mbrojtëse në mukozë, kështu që viruset depërtojnë më lehtë përmes mukozës në indet dhe në lëngjet e trupit.

- Mikrobet mund të hyjnë në trupin tonë edhe përmes plagëve në lëkurë, nëse nuk i mjekojmë me kujdes ato.

- Bartës të sëmundjeve kanë qenë dikur kafshët e ndryshme. Këpushat (rriqnat) e infektuara mund të na ngjitin meningjitin. Nxënësit duhet të dinë se, nëse u ndodh që këpusha (rriqna) t'u ngjitet për lëkurë diku në natyrë, ajo duhet hequr e tëra. Nëse edhe pas heqjes vihen re ndryshime, atëherë duhet t'i drejtohem mjekut.

Për shkak të shtimit të viruseve dhe të mikrobeve vjen deri tek sëmurja e organizmit. Disa baktere sekretojnë lëndë helmuese, të cilat ndikojnë në mënyrë të dëmshme ndaj qelizave dhe ndaj indeve. Si pasojë e kësaj ndjehemi keq dhe temperatura e trupit tonë rritet. Në këtë mënyrë, trupi ynë mbrohet nga lëndët e jashtme. Temperatura e rritur mund të jetë pasojë e toksinave të sekretuara të mikroorganizmave. Viruset mund shkaktojnë dëmtime të mëdha të qelizave në inde dhe asgjësimin e tyre.

Bisedohet me nxënësit për rëndësinë e të ushqyerit të rregullt e të balancuar për shëndetin, për shprehitë e tyre nga këndvështrimi i mënyrës dhe i llojit të ushqimit që konsumohet, si edhe për shqetësimet e mundshme shëndetësore të shkaktuara nga mikrobet. Nëse ushqimi nuk është i freskët, në organizëm shtohen bakteret dhe viruset. Për këtë arsye, mund të kemi pengesa shqetësuese.

Mënyra e mjekimit varet nga shkaku i sëmundjes. Nëse organizmi sulmohet nga bakteret, atëherë mjekohemi me antibiotikë, kurse kundër viruseve nuk ka ilaçe efektive.

Mjekët rekomandojnë shumë lëngje dhe vitamina C, në mënyrë që të plotësojmë mungesën e lëngjeve të humbura si pasojë e temperaturës së lartë. Vitamina C parandalon në disa raste, hyrjen e viruseve në qeliza. Antibiotikët i marrim për një kohë të caktuar, sipas rekomandimit të mjekut. Rëndësi ka që të zbatohet në mënyrë konsekuente rekomandimet e mjekut për afatin e marrjes së ilaçit, sepse bakteret më rezistuese mund të mbijetojnë e të shtohen, kështu që simptomat e sëmundjes mund të rishfaqen përsëri. Prej disa sëmundjeve mund të mbrohemi me sukses me anë të vaksinave, ndërsa të tjerat mund t'i parandalojmë me ushqim të rregullt, me veprimtari fizike në ajër të freskët dhe me pushim. Mikrobet nuk janë vetëm shkaktarë të sëmundjeve, por edhe shpërbërëse të organizmave të vdekur dhe si të tilla janë të rëndësishme për qarkullimin e materies në natyrë. Disa mikrobe i shfrytëzojmë edhe në ushqime (kosi).

Në periudhën e mëparshme nxënësit janë njohur me lëndët e lëngëta dhe të ngurta, i kanë zbratur dhe i kanë përzier lëngjet, i kanë modeluar, i kanë përzier lëndët ose i kanë ndarë pjesët e përzierjeve. Gjithashtu kanë mësuar se lëngjet dhe lëndët e ngurta zënë hapësirë, ndërsa me ngritje, me tërheqje dhe me shtyrje kanë mundur të përcaktojnë se këto materiale kanë peshën dhe masën e vet. Gazet zakonisht nuk i shohim. Meqë densiteti i tyre është i vogël, nuk e ndjejmë sa na duhet fuqia për ngritjen e enës me gaz. Gazet nuk kanë vëllim të përhershëm, sepse mund të mblidhen dhe të përhapen, por edhe ato, ashtu sikurse materiet e tjera, zënë hapësirë. Për praninë e gazeve mësojmë në





bazë të efekteve, të lëvizjes, të aromës etj. Nxënësit e dinë tashmë se gazet janë materie që kanë karakteristika të caktuara: kanë aromë të pakëndshme (kundërmojnë), digjen, dëmtojnë shëndetin ... . Ajri si prototipi i gazeve (prototipi është materia e njohur, që përfaqëson karakteristikat e përbashkëta esenciale të një bashkësie ose të sendeve) është tjetërsoj. Ajri përbëhet nga grimcat e vogla që lëvizin në hapësirën boshe. Midis tyre nuk ka asgjë, gjë që mundëson që masa e njëjtë e gazit të zërë vëllime të ndryshme. Kjo gjë quhet grumbullimi dhe përhapja e gazit. Nxënësve u rikujtojmë përvojën se p.sh. dysheku prej gome fryhet në diell, kurse në ujë e ftohtë, tkurret. Por gazet nuk mund të ngjishen aq sa të mos zënë kurrfarë hapësire. Edhe pse janë të shpërndarë, ato e kanë vëllimin e vet.

Ajri është kudo rreth nesh, bile edhe në disa materie; në bukë dhe në sfungjer mund të shohim hapësirat e vogla të mbushura me ajër. Hapësirat me ajër mund të jenë shumë të vogla që të mos mund t'i shohim me sy. I tillë është rasti me materiet poroze. Prej tyre mund ta nxjerrim ajrin me anë të ujit, sepse dy materie nuk mund ta mbushin njëkohësisht të njëjtën hapësirë, kështu që ajri do të dalë përjashta. Në këtë mënyrë, ajri i "zënë" në fluska bëhet i dukshëm. Që nxënësit t'i kuptojnë këto procese dhe këto dukuri, u ndihmojmë atyre me shembuj nga jeta e përditshme. Nëse bashkojmë dy lëngje që nuk përzihen, do të shfaqen flluskat e njërit lëng në lëngun tjetër.

Ajrin nuk e vëmë re, por në rastin e lëvizjes, ajri mund t'i rrëzojë pemët dhe të tregojë fuqi shumë të madhe. Meqë gazet përzihen me njëri-tjetrin, ndodh që gazet helmuese të futen në ajër dhe të përhapen me anë të erës duke e ndotur atë. Dimë se ndotësit kryesorë të ajrit janë komunikacioni dhe industria. Prandaj sot, automobilat pajisen me katalizatorët gaznxjerrës, vihen në lëvizje me karburant më të pastër, kështu që edhe ndotja e ajrit është pakësuar mjaft.

Nxënësit kanë mësuar qysh në klasën e parë që t'i dallojnë lëndët e lëngëta dhe të ngurta. Procesi i tretjes dhe i ngurtësimit është i afërt dhe i njohur për ta. Ndërkohë, procesin e avullimit e kuptojnë më vështirë. Për të kuptuar procesin e avullimit dhe të kondensimit, nevojiten njohuritë për materiet në gjendje të gaztë. Tashmë është bërë fjalë për ajrin si përzjerje e gazeve dhe për karakteristika të përbashkëta të materieve. Edhe avulli i ujit është materie, ndërsa krijohet me anë të avullimit. Është treguar se kuptimi i disa proceseve të përsëritshme (p.sh. tretja dhe ngurtësimi) është më përfshirës, nëse nxënësit i mësojnë ato paralelisht. Në fazën fillestare nocionin avullim nxënësit e përjetojnë si "zhdukje". Ndiqet procesi, uji hidhet në enë, ngrohet, shfaqen flluskat (vlimi), "tymon", shfaqen pikëzat e vogla të krijuara si pasojë e kondensimit në ajrin e ftohtë. Pason të kuptuarit për "zhvendosjen", uji nuk është zhdukur, por vetëm e ka ndryshuar vendin. Shkallë më e lartë e të kuptuarit është shndërrimi i materies në diçka tjetër, d.m.th. uji si materie transformohet në diçka tjetër. Në fazën më të lartë të të kuptuarit, nxënësit e kuptojnë avullimin si ndryshimi i gjendjes së materies. E kuptojnë se, në varësi të temperaturës, uji mund të jetë lëng, gaz ose akull. Për ta kuptuar avullimin dhe kondensimin, ka rëndësi që të kuptohet se avulli i ujit është i përzier me ajrin dhe se është rreth nesh. Me avullim, uji shndërrohet në gaz të padukshëm, ndërsa me kondensim transformohet përsëri në lëng. Nga përvoja e përditshme nxënësit e njohin nocionin tharje. Zakonisht mendohet për materiet ose sendet që thahen, ndërsa mungon fakti se nga materia me anë të avullimit del uji, Rëndësi ka që nxënësit ta kuptojnë tharjen si avullim. Nxënësit, me anë të hulumtimit e të eksperimentimit të procesit të avullimit, do ta kuptojnë me mirë këtë dukuri. Të kuptuarit e ndihmon analogjia me tretjen dhe me veçimin e materies nga tretësira. Kështu do të shihet se me avullimin e ujit nga tretësira, veçohet sheqeri, ose kur ajri ftohet, në atmosferë veçohet uji në formën e vesës. Avullimi dhe kondensimi janë procese të ripërsëritshme. Avullimi i lëngut kushtëzohet nga pika



e vlimit e këtij lëngu. Nëse pika e vlimit është e lartë, materia avullon më ngadalë. Ka edhe materie të ngurta që i nënshtrohen avullimit. Ripërsëritja, që është karakteristike për ujin, i përket edhe disa materieve të tjera. Para sesa ta ndryshojnë gjendjen e vet agregate, lëndët organike ndryshojnë me ngrohje. Prandaj për to nuk është karakteristike ripërsëritja. Ndryshimet e tilla të materies quhen reaksione kimike. Disa prej materieve (lëndëve), duke u përzier me ujin, shpërbëhen në pjesë përbërëse (në jone ose në molekula), kurse këto përzihen me pjesët e ujit dhe krijohet tretësira. Në këtë proces, materia, në dukje, zhduket. Tretësitat kanë më shpesh lëngje të kthjellëta.

Materia që tretet në ujë ka karakteristika të ngjashme me ujin. Shpejtësia e tretjes përshejtohet me anë të përzierjes, kurse tretja bëhet më shpejt, nëse materia është e grimtuar. Lëngjet dhe gazet gjithashtu treten dhe ky proces zhvillohet shpejt.

Tretja është procesi i ndërveprimit midis dy materieve, asaj që tret dhe asaj që tretet.

Duhet pasur kujdes se për tretjen (e sheqerit e të kripës në ujë) nuk përdoret fjala "është shkrirë", sepse shkrirja ka të bëjë me materiet e ngurta. Nganjëherë mjafton fare pak prej ndonjë materie të tretur në ujë që veprimi i saj të jetë shumë i fuqishëm. Në ujin që në dukje është i kthjellët dhe i pastër, mund të jenë bakteret e dëmshme. Nganjëherë ndotja e ujit dallohet sipas disa shenjave, si për shembull ndryshimi i ngjyrës, shkuma, aroma dhe shija e pakëndshme. Ndotja e burimeve të ujit është bërë sot një temë tepër aktuale dhe serioze që meriton më shumë vëmendje dhe trajtim më të madh. Materiet që nuk treten në ujë, formojnë përzierje.

Materiet e pluhurosura të përziera me ujë formojnë suspensionet (pezulluesit), siç janë për shembull përzierja e ujit me miellin, ilaçet, preparatet e pastrimit etj. Lëngjet e ndryshme që nuk përzihen, formojnë emulsione, siç janë kimikatet e ndryshme të pastrimit, preparatet kozmetike, përzierja e vajit dhe e ujit etj. Ekzistojnë edhe materiet që nuk shpërbëhen në ujë, por nuk bëhet fjalë për tretje. Ato shpërbëhen në pjesë të vogla, të cilat formojnë suspensionin me ujin. Kështu mund t'u tregohet nxënësve sesi vepron letra ose disa pëlhura në ujë; ato shpërbëhen duke u ndarë fjetet e këtyre materieve nga uji, për ato nuk treten. Ka edhe materie të tilla që janë plotësisht rezistuese ndaj ujit. Mbi sjelljen e materies ndikon ajri dhe drita diellore; thahen, ndryshken dhe kalben. Është i paktë numri i materieve në natyrë që mbeten të pandryshuara.

# SHIKOJ, SHOH

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të arrihet në përfundimin se drita vihet re me anë të shikimit dhe se syri është organi i të parit</li><li>• të dallohet largësia në vendbanim (gjatësia)</li><li>• të dihet rëndësia e ruajtjes së syrit të shëndoshë</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	sy, të parit (shikim), dritë, errësirë, burimi i dritës, me dritë (i ndriçuar), i (e) errët, ngjyrë, formë, lëvizje, largësi

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit i vrojtojnë sendet në klasë nga pozicionet e ndryshme; para, anash, me shpinë të kthyer. Herë shohin më mirë, herë shohin më keq dhe herë nuk shohin fare? Nxirret përfundimi se sendet i shohim, atëherë kur i shikojmë ato. Nganjëherë sytë janë të hapur, por megjithatë nuk shohim. Kur nuk shohim? Nxirret përfundimi se shikohet atëherë kur ka dritë.
2. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës. Prekin trungun e drurit me sy të mbyllur. Cilat karakteristika të trungut mund t'i përcaktojnë me shqisën e të prekurit? Çfarë vënë re kur hapin sytë? Në po të njëjtën mënyrë përshkruajnë edhe objektet e tjera në oborrin e shkollës. Vënë re formën, ngjyrën dhe largësinë e objekteve të ndryshme. Cili objekt është më afër dhe cili është më larg?
3. Në një kuti të madhe vendosen disa sende. I emërtojnë sendet në kuti me ndihmën e pasqyrës. Në po të njëjtën mënyrë, me ndihmën e pasqyrës, shikojnë sendet në tavolinë duke qenë të kthyer me shpinë.
4. Vendoset në tavolinë llamba e dorës, folia e aluminit, çanta me "syrin e maces", folia e çokolletës, kutia e biskotave etj. Kush ndriçon, kush e reflekton dritën, kush nuk ndriçon?
5. Nxënësit nxirren në lartësinë më të afërt. Çfarë shohin prej saj? Vënë re se prej së largu madhësia e objekteve zvogëlohet në dukje. Shohin lartësitë më të larta. Prej së largu ndryshon edhe ngjyra, kështu që objektet me ngjyrë bëhen gri. Cila lartësi në largësi është më e shndritshme?

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit shohin fotografinë e ndeshjes së futbollit nën ndriçimin e reflektorëve. Lexohet teksti i shkruar. Komentohej ndryshimet midis syve të vet dhe syve të shokëve. Kuptojnë se sytë ndryshojnë për nga ngjyra (ngjyra e syve është ngjyra e iridit), për nga madhësia, për nga gjatësia e qerpikëve etj. Shohin figurën ilustruese dhe lexojnë pjesët e syrit. I krahasojnë ato me sytë e shokut ose të shoqes së vet.

Shohin dhe komentojnë vizatimet: komentojnë gjerësinë e iridit ditën dhe natën. Bëjnë supozimin se pse iridi është më i zgjeruar kur ka më pak dritë. Theksohet se është e rrezikshme të shihet drejtpërdrejt dielli dhe se është e nevojshme t'i mbrojmë sytë nga rrezet e diellit dhe gjatë kryerjes së punëve të ndryshme. Ç'loj gjyslykësh dielli ekzistojnë? (Gjyslykët për përmirësimin e shikimit dhe gjyslykët për mbrojtje nga dielli.)

Si na duket topi në errësirë dhe si na duket në dritë? Cilat karakteristika të topit mund



t'i njohim në errësirë? Çfarë shohim kur është në dritë?

Komentohet se tek cili top ka më shumë ajër dhe si mund të bëhet e ditur ndryshe kjo gjë.

Shihen sytë e kafshëve të ndryshme dhe lexohet teksti i shkruar. Sytë e kujt ndriçojnë në errësirë? Cilat kafshë shohin më mirë natën? A sheh urithi? Pse i ka rudimentarë sytë urithi?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Plotësohet tabela. Përcaktohet se ç'janë burimet e dritës dhe ç'janë trupat që vetëm e reflektojnë dritën.
2. Shihen vizatimet dhe komentohet se cili prej katrorëve është më i madh. Shkruhet ajo që është vërejtur. Supozohet se pse është kështu.
3. Vizatohet ajo që është më larg dhe më afër në raport me vendin prej nga shikojmë. Duhet të vihet re se objektet e largëta kanë ngjyrë më pak intensive.
4. Nga Shtojca ngjitet dielli në raport me hijen e pemës. Duhet të vihet re/të nxirret përfundimi se hija gjendet gjithmonë në anën e kundërt të diellit.

**Mjetet ndihmëse:** pasqyrat, sendet që e lëshojnë dhe që e reflektojnë dritën

## **VË VESH, DËGJOJ**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallohen burimet e zërit</li> <li>• të mësohet sesi krijohet zëri (me vibrimin e trupit)</li> <li>• të arrihet në përfundimin se veshi është organi i shqisës së të dëgjuarit.</li> <li>• të kuptohet rëndësia e ruajtjes së shëndetit të veshit.</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	zë, tingull, fuqia e zërit, lartësia e zërit, përhapja e zërit, pëshpërimë, zhurmë, vesh, llapa e veshit, instrumenti muzikor

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Nxënësit flasin dhe e mbajnë dorën (gishtat) në fyt. Çfarë ndjejnë? U tërheqim vëmendjen, se tek të folurit lëvizin kordat zanore.
2. Bëhet demonstrimi për udhëtimin e zërit. Sipër një enë të madhe tendoset një folie e hollë plastike. Mbi folie vendosen kokrrat e sheqerit kristal. Përplasen fort shuplakat e duarve pranë folies. Tingulli (lëvizja e ajrit) i zhvendos kokrrat e sheqerit.
3. Lëshohen këngët e njohura të fëmijëve. Një grup nxënësish del para klasës në një largësi të mjaftueshme që të mos mund t'i dëgjojë tingujt e këngës. Nga një nxënës i afrohet klasës dhe ngre dorën kur e njuh këngën. Matim se sa metra larg CD-së ka qenë kur e ka njohur këngën. Disa nxënës e përsëritin të njëjtën gjë. Largohen gjithnjë deri sa të mos e dëgjojnë muzikën. Nxirret përfundimi se tingulli dobësohet duke u larguar nga burimi i tij.



4. Punohen instrumentet e Orfit. Cili instrument prodhon tingullin më të fortë? Nxënësi bën të ditur sesi e ka punuar dhe prej çfarë materiali e ka punuar.
5. Emërtohen tingujt e natyrës dhe kush i prodhon ata: gurgullima – uji; troku – kali; bubullima – rrufeja; shushurima – gjethet ...
6. Nxiten nxënësit që të kujtojnë sesi i dëgjojnë tingujt në hapësirat boshe ose, nëse kanë pasur rastin ta përjetojnë “heshtjen e borës”. Në hapësirat boshe dëgjohet jehona. A e kanë dëgjuar ndonjëherë ehon (jehonën)? Kur e kanë dëgjuar? Kur në klasën e tyre është qetësi, a dëgjojnë tingujt nga klasa fqinje? A do të dëgjonin më mirë, po të ishte muri i trashë apo i hollë? Ç’përfundim nxirret?
7. Tri kuti këpucësh i mbështjellin nga brenda me sfungjer, me stiropor dhe me letër. Mbyllin kutitë. Në çdo kuti vendoset radioja e rregulluar me të njëjtën fuqi zëri. Prej cilës kuti dëgjohet më fort dhe më dobët zëri? Ç’përfundim nxirret? Cili material e izolon më mirë zërin?

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë dhe lexohen tekstet e shkruara. Nxënësit kuptojnë se me tinguj komunikojmë. Komentojnë vizatimet që pasqyrojnë sesi krijohen tingujt në natyrë. Imitohen tingujt e natyrës. Si e prodhon tingullin kitara? Nxënësit kuptojnë se tingulli krijohet kur diçka vibron. Kur zhduket tingulli?

Shihet vizatimi dhe përshkruhet veshi. Bisedohet për burimet e tingullit. Çfarë mund të jetë burim i zërit? A jemi edhe ne burim i zërit? Bisedohet për mënyrat e transmetimit të tingullit. Ku përhapet tingulli? Të gjithë e dijnë se tingulli përhapet nëpër ajër. Flitet edhe për përhapjen e tingullit nëpër ujë, nëpër tokë, nëpër dru, nëpër mur etj. ... Në ç’mënyrë është paraqitur lëvizja e tingullit tek figura e delfinëve? Pse e kanë dëgjuar me vesh tokën indianët? (Për arsye se tingulli përhapet shumë më shpejt nëpër tokë, sesa nëpër ajër.)

Cili tingull quhet pëshpërimë? Flitet për personat që dëgjojnë dobët. Si mund t’i ndihmojnë vetvetes që të dëgjojnë më mirë?

Për cilët tinguj (zëra) thuhet se janë të pakëndshëm? Numërohen disa. Ku mund të dëgjojnë ata? Pse janë të rrezikshëm ata? Pse njerëzit që punojnë në aerodrome mbajnë kufje mbrojtëse? Cilët sportistë mbajnë kufjet mbrojtëse?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Lidhen instrumentet muzikore me veprimet me të cilat prodhohet tingulli.
2. Bëhet eksperimenti dhe shkruhen numrat duke i renditur tingujt nga më i ulëti deri tek më i larti.
3. Plotësohet tabela. Shkruhet edhe një tingull dhe përcaktohet karakteristika e tij.
4. Shkruhen tingujt që mund të dëgjojnë në qytet, në fshat dhe pranë detit. Cilët prej tyre janë të këndshëm dhe cilët janë të pakëndshëm?

**Mjetet ndihmëse:** ena e madhe, folia plastike, sheqeri kristal, CD, instrumentet e Orfit, magnetofoni, tri kuti kartoni, sfungjeri, stiropori, letra



# KUJDESEM PËR SHËNDETIN

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen masat parandaluese, mjekimi dhe kujdesi për të sëmurët</li><li>• të dihet se disa sëmundje i shkaktojnë qeniet tepër të vogla (mikrobet)</li><li>• të dihen sëmundjet më të shpeshta të fëmijëve</li><li>• të zhvillohet mirëkuptimi për ruajtjen e shëndetit</li><li>• të emërtohen disa profesione të rëndësishme për ndërtesat kryesore në vendbanim</li><li>• të njihet rëndësia e vaksinimit</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	sëmundje, mikrob, vaksinim, temperatura e rritur trupore, higjienë, karies, personeli mjekësor, mjek, stomatolog (dentist), infermier, mizë, mushkonjë, këpushë, morr

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit tregojnë, sesi janë ndjerë, kur kanë qenë të sëmurë. Sa e kanë pasur temperaturën e trupit? Si e kanë matur temperaturën? Çfarë kanë bërë kur kanë qenë me temperaturë? A kanë mundur të luajnë? Pse? Sa kohë kanë qëndruar në shtrat? A i kanë vizatuar shokët? Pse?
2. Nxënësit tregojnë përvojën e vet të vaksinimit. Supozojnë se përse vaksinohen njerëzit. Pyesin në shtëpi, se për ç'sëmundje janë të vaksinuar.
3. Bisedohet për kafshët kanakare. Nxënësit që kanë kafshë kanakare tregojnë, nëse kanë qenë të sëmura ndonjëherë. Kush i mjekon ata kur janë të sëmura? A u kanë dhënë ilaçe kafshëve të tyre kanakare? Si mbrohen kafshët kanakare nga sëmundjet? Shpjegohet se kafshët kanakare mbrohen duke i vaksinuar.
4. Bisedohet për këpushat. A i kanë parë ndonjëherë ato dhe ku i kanë parë? A kanë përvojë me këpushat. Ku kanë shkuar atëherë? Çfarë kanë bërë? Bëhet e ditur se këpusha ka në bar dhe se pas çdo daljeje në natyrë, duhet të kontrollojmë, nëse na është ngjitur ndonjë gjë pas trupit. Nëse gjejnë këpushat, duhet t'i drejtohen mjekut. Sot mund të mbrohemi nga këpushat duke u vaksinuar.
5. Në oborrin e shkollës groposet një rriskë molle në një qese najloni. Shënohet vendi ku është groposur. Pas afro dhjetë ditësh verifikohet se çfarë ka ndodhur me rriskën e mollës dhe me qesen e najlonit. Çfarë është dekompozuar më parë? Ç'përfundim nxirret?
6. Organizohet vizita në Shtëpinë e shëndetit ose në ambulancën më të afërt. Bisedohet me personelin shëndetësor për sëmundjet më të shpeshta tek fëmijët, për masat parandaluese dhe për mjekimin.

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit njihen me mikrobet, si shkaktarët më të shpeshtë të sëmundjeve. Shihen vizatimet dhe lexohen tekstet e shkruara. Thuhet se mikrobe ka më shumë në vendet me lagështi dhe në vendet e ngrohta. Bisedohet për atë sesi hyjnë ata në organizmin tonë (përmes duarve të palara, ushqimeve të prishura) dhe se mund të barten nga personi i infektuar tek personi i shëndoshë.



Shihet dhe komentohet vizatimi i fëmijës së plagosur. A u ka ndodhur edhe atyre diçka e ngjashme? Çfarë kanë bërë në këtë rast? Shpjegohet se mikrobet mund të hyjnë në trupin tonë edhe përmes plagëve dhe se duhet t'i drejtohem patjetër mjekut në mënyrë që të mbrohemi nga sëmundjet (infeksionet). Shihet vizatimi i mizës, mushkonjës dhe këpushës. Lexohet teksti i shkruar. Si mund të mbrohemi prej tyre? (Duke mbajtur të pastër ambientin, duke i larguar mbeturinat e ushqimit, duke veshur rroba të përshtatshme, duke kontrolluar gardorobën dhe trupin e vet pas lojës në livadh ose në pyll, duke u mbrojtur me anë të preparateve që i largojnë mushkonjat dhe insektet e tjera).

Komentohet vizatimi i vajzës që ka morra. A kanë patur ata ndonjëherë morra? Si kanë shpëtuar prej tyre? Çfarë kanë bërë atëherë? Ekzistojnë paragjykime për morrat. Duhet të kuptohet se gjithkush mund të ketë morra, pavarësisht se sa shpesh lahen flokët.

Bisedohet për kujdesin ndaj dhëmbëve. A i lani rregullisht dhëmbët? Pse duhen larë dhëmbët pas ngrënies? Si e dijmë se dhëmbin e kemi të prishur? (Na dhëmb, shihet pika e zezë.) Lexohet teksti i shkruar.

Bisedohet për mënyrën e mbrojtjes nga sëmundjet. Shihen vizatimet.

Çfarë bëjmë që të mos sëmurim? Shumë sëmundje mund t'i parandalojmë me mënyrën e shëndetshme të jetesës. Shihen fotografitë. Çfarë do të thotë mënyrë e shëndetshme jetese?

Lexohet teksti i shkruar poshtë fotografisë së jogurtit. Disa mikrobe i përdorim në ushqim.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nxënësit matin temperaturën e trupit dhe plotësojnë tabelën. Temperaturë e rritur është ajo mbi 37 gradë dhe ajo tregon për sëmundjen.
2. Shihen vizatimet dhe shkruhet pse është e rrezikshme situata e paraqitur dhe si duhet të mbrohemi.
3. Bisedohet për sëmundjet me të cilat kemi qenë sëmurë. Kush ka qenë i sëmurë nga gripi, nga grykët (angina) dhe nga fruthi? Shkruhen emrat e nxënësve që kanë qenë sëmurë me këto sëmundje. Shënohet sëmundja me të cilën kanë qenë sëmurë më shumë nxënës. Mbi bazën e grafikut të plotësuar nxirret përfundimi se nga cilat prej sëmundjeve të përmendura kanë qenë sëmurë më shumë dhe më pak nxënës.
4. Shihen vizatimet e fëmijës që rri ulur në karrige. Si rri ulur fëmija në vizatimin e parë dhe si ai në të dytin? Cili pozicion është i rregullt? (Shkruhet kryqi i vogël.). Pse?

**Mjeti ndihmës:** termometri

## **KU KA AJËR?**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihet re se ajri ndodhet kudo rreth nesh</li> <li>• të arrihet në përfundimin se ajri mund të jetë i ndotur dhe, si i tillë, ai është i dëmshëm për shëndetin</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	ajër, gaz, erë, flluskë, ndotje





### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Zhytet shishja në një enë me ujë. Nxënësit shohin se çfarë ndodh. Çfarë del nga shishja (fluskat). Bëhet e ditur se fluskat janë ajri që gjendet në shishe. Kur është ndërprerë dalja e fluskave? (Kur shishja është mbushur me ujë.)
2. Çdo nxënës merr tullumbacen dhe e lidh. E ngjeshin lehtë tullumbacen. Çfarë ndodh? A mund të ngjishet plotësisht tullumbacja? Pse? Çfarë pengon në tullumbace? Kuptohet se tullumbacja është e mbushur me ajër. Çfarë do të ndodhë me ajrin kur të zgjidhet tullumbacja ose kur ajo pëlcet? (Do të përhapet në hapësirë.)
3. Merren dy shishe, dy hinka dhe plastelina. Vihet hinka në të dyja shishet, ndërsa në njëren shishe, hinkën e ngjeshim fort pas grykës së shishes me plastelinë, në mënyrë që ajri të mos mund të dalë anash. Hedhim ujin në shishen me plastelinë. Çfarë vihet re? Me ç'shpejtësi hyn uji në shishe? (Ajri në shishe nuk lejon që uji të hyjë shpejt.) Pse ka hyrë më shpejt uji në shishen tjetër? (Ajri ka dalë midis grykës e hinkës: kjo gjë nuk ka qenë e mundur në shishen e parë, sepse këtë pjesë e kemi mbyllur me plastelinë.)
4. Enën e madhe të tejdukshme prej qelqi e mbushim me ujë. Nxënësit prekin shkumësin, sfungjerin, leckën dhe gurin e lëmuar dhe përshkruajnë karakteristikat e materialit (i lëmuar, i ashpër). Sendet futen në ujë. Prej cilave sende kanë dalë më shumë fluska? (Prej materialeve të ashpra.) Materialet e lëmuara janë zakonisht më pak poroze.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Nxënësit shikojnë fotografinë e peizazhit. Çfarë shihet në fotografi? A ka në fotografi edhe diçka tjetër, të cilën ne nuk e shohim? Si e dimë se ka ajër? (Po të mos kishte ajër, nuk do të ekzistonte bota e gjallë.) A fryn erë? Si mund ta shohim këtë gjë? Lexohet teksti i shkruar.

Shihen vizatimet. Çfarë bën djaloshi? Me se e ka mbushur tullumbacen? Pse ka pëlcitur tullumbacja? Ky ka shkuar ajri nga tullumbacja?

Komentohet vizatimi në të cilin është paraqitur shishja e zhytur në ujë. Çfarë del prej saj? Ç'janë fluskat? A do të shihen ato, kur të dalin nga uji? Pse? Komentohet i njëjti veprim me shkumësin. Nga fëmijët e kësaj moshe pritet që në shishen gjoja boshe të ketë ajër, por para eksperimentit nuk e supozojnë dot se ajër ka edhe në shkumësat (lëndë e fortë). Lexohet teksti i shkruar.

Çfarë hulumtojnë astronautët? Pse veshin kostume speciale kur dalin nga anija kozmike? A ka ajër në kozmos? Si marrin frymë astronautët?

A mundet era t'i vërë në lëvizje sendet? Kur e kanë parë këtë gjë nxënësit? Thuhet se çfarë vë në lëvizje ajri. Vihet re se ajri që lëviz ka energji, e cila mund të shfrytëzohet.

Shihet fotografia e fabrikës. Çfarë ndodh me tymin që del prej saj? Si mund ta ndjejmë tymin? (Me shqisën e nuhatjes dhe me shqisën e të parit.) Pse e shohim tymin e fabrikës, ndërsa ajrin nuk e shohim? (Sepse në tym ka lëndë të dëmshme.) Pse duhet të ndërtohen fabrikat jashtë qendrave të banimit? Komentohet aroma e ajrit në qytet dhe aroma e ajrit fshat.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Duke fryrë, nxënësit zhvendosin topin e pingpongut. Shkruajnë sesa e kanë zhvendosur? Ku gjendej ajri me të cilin e kemi zhvendosur topin e pingpongut?





2. Bëhet eksperimenti. Thithet ajri nga qesja. Çfarë ndodh me qesen? Çfarë nuk ka më në qese? Pse? A është zhdukur ajri nga qesja? Ku është "vendosur" ajri? Qarkohet shkronja para pohimit të saktë. Shkruhet se ku është vendosur ajri nga qesja.
3. Shkruhen shqisat, me të cilat ndjehet tymi (shqisa e nuhatjes dhe shqisa e të parit), era (me shqisën e dëgjimit, të prekjes dhe të të parit), era e parfumit (me shqisën e nuhatjes). Ajrin nuk mund ta ndjejmë me shqisën e shijes.

**Mjetet ndihmëse:** qesja e najlonit, letra ngjitëse, dy shishe, dy hinka, plastelina, ena prej qelqi, shkumësi, sfungjeri, lecka, guri i lëmuar, topi i pingpongut, metri, fshesa elektrike, qesja për heqjen e mbeturinave

## UJI KA AVULLUAR

<b>Qëllimet:</b>	• të vihet re sesi ndryshon materia nën ndikimin e ajrit dhe të dritës
<b>Fjalët kyçe:</b>	avullim, tharje, ngrohje, nxehje, ftohje

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Bisedohet për atë që ndodh me bukën kur mbahet në një vend të hapur. (Thahet.) Si mund të mbrohet buka që të mbesë e freskët për një kohë më të gjatë? Çfarë do të ndodhë me bukën, nëse e mbajmë për disa ditë në qesen e najlonit? (Myket.) Propozohet se ku mund të ruhet më mirë buka. (Në enën prej druri ose në një trastë prej bezeje.)
2. Shishen dhe një enë të madhe të tejdukshme i mbushim me ujë dhe i vendosim në një vend me diell. Shënojmë me flomaster nivelin e ujit në të dyja enët. Çdo ditë përsëritet matja. Çfarë vihet re dhe cili është niveli i ujit në enë? (Më i ulët se në ditët e mëparshme.) Matja përsëritet edhe disa ditë. Çdo matje shënohet me flomaster në enë. Cili është niveli i ujit në enë pas disa ditësh, në raport me matjen e fillimit. Çfarë ka ndodhur me ujin? Prej cilës enë ka avulluar më shumë ujë? Supozohet arsyeja? (Sa më e hapur që të jetë ena, aq më shumë ujë avullon.)
3. Ky eksperiment zhvillohet nga mësuesi. Në një furnelë elektrike vihet ena zjarrduruese prej qelqi me ujë. Ngrohet uji. Shihet se çfarë ndodh. Çfarë del nga ena. (Avulli i ujit.) Ku shkon avulli i ujit? Në enën zjarrduruese prej qelqi vihet kapaku. Ngrihet kapaku pas 30-40 sekondave. Kthehet fundi i kapakut në drejtim të nxënësve. Çfarë shohin nxënësit mbi kapak? (Kapaku është i mbuluar me pikëza uji.) Supozohet se pse ka ndodhur kjo gjë. Derdhet uji nga ena dhe hedhim ujë të ftohtë. Pastrohet kapaku. Kthehet ena zjarrduruese prej qelqi në furnelën elektrike. Hiqet kapaku. Tashti në kapak nuk ka pikëza uji. Supozohet se pse.
4. Bisedohet për vesimin. Kur e kanë vënë re nxënësit se diçka është vesuar në mjedisin përreth tyre? Kur do të mjegullohet qelqi në xhamin e automobilin? (Kur jashtë është ftohtë dhe në automjet është ngrohtë, xhamat janë më të ftohtë se ajri në automobil.) Çfarë ndodh kur lahemi ose kur bëjmë dush? Cilat sende në banjo vesohen? (Pasqyra, pllakat.)



5. Copat e akullit nxirren nga ena për akull dhe vihen në dy gota. Një gotë vendoset në një vend me diell, kurse tjetra vihet në frigorifer. Shihet se çfarë ndodh? Cili akull shkrihet më parë? Ç'përfundim nxirret?
6. Copat e akullit me ngjyrë. Përzihet shurupi i frutave me ujë dhe zbrazet në enën për akull. Kur të ngrijnë, copat e akullit vihen në lëngun e frutave. Akulli mund të bëhet prej shumë llojeve të shurupeve të frutave, në mënyrë që të ketë disa ngjyra.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë e vizatimet dhe lexohen tekstet e shkruara. Ku krijohen pellgjet e ujit? A do të zhduken ato më shpejt në kohën më diell apo në kohën me diell e me erë? E njëjta gjë ndodh edhe me rrobat. Si ndryshon materia në ajër dhe nën ndikimin e dritës e të ngrohjes. Çfarë ndodh me ujin (materien) nën ndikimin e dritës dhe të ngrohjes. (Transformohet.)

Çfarë ndodh me ujin që ngrohet? Në çfarë transformohet avulli i ujit, kur ftohet përsëri? Nxënësit e lexojnë disa herë shkrimin: ujin e ngrohim – kthehet në avull. Avullin e ftohim – kthehet në akull. Akullin e ngrohim – kthehet në ujë. Vihet re se bëhet fjalë për qarkullimin. Lexohet sesi transformohet qiriri – dylli nën ndikimin e ngrohjes.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Matet në peshoren e shtëpisë pesha e sfungjerit të lagur e të thatë. Shënohet pesha. Matet pesha e mollës së freskët, e cila lihet pastaj në një vend me diell për disa ditë. Matet molla përsëri pas disa ditësh. Nxirret përfundimi se cila mollë është më e rëndë.
2. Me një person të rritur përgatitet karamelja. Shkruhet se çfarë ka ndodhur me sheqerin para se të krijohet karamelja (është tretur, ka ndryshuar ngjyrën), çfarë ka ndodhur kur karamelja është ftohur (është bërë gjithnjë e më i fortë, në fund karamelja është bërë material i ngurtë). Nxirret përfundimi se sheqeri (materia) shndërrohet nën ndikimin e ngrohjes.

**Mjetet ndihmëse:** shishja dhe ena plastike e tejdukshme, flomasteri, furnela elektrike, ena zjarrduruese prej qelqi, kapaku, ena e akullit, copat e akullit, peshorja e shtëpisë, sfungjeri, molla, tenxherja, sheqeri

# SHEQERI ËSHTË TRETUR

## Qëllimet:

- të vihet re sesi ndryshon materia nën ndikimin e ujit

## Fjalët kyçe:

materie e përzier, tretje, tretësirë, i (e) kulluar, i (e) turbullt

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Sillen në klasë shurupi, kripa, sheqeri, kanella, grafiti i lapsave të drurit, ndonjë esencë, mielli, lëngjet e pastrimit etj. Në tavolinë vendosen 5-6 gota me ujë. Në çdo gotë hidhet nga pak prej materieve. Përzihen me lugë. Nxënësit shohin se çfarë ndodh, çfarë tretet, çfarë noton dhe çfarë zhytet.
2. Tri gota uji mbushen në 1/3 me ujë dhe në to treten nga një lugë supe me kripë, me sheqer dhe me uthull. Në shishe shënojnë me flamastër se çfarë kanë shtuar në ujë; kripën, sheqerin dhe uthullën. Lihen gotat në një vend të ngrohtë dhe pritet disa ditë që uji të avullohet. Çfarë ka mbetur në fundin e gotave? Vihet re se në gotat ku kanë tretur kripën dhe sheqerin, kanë mbetur kristalet e imta, kurse shishja me uthull ka mbetur e zbrazët.
3. Grumbullohet literatura për ndotjen e ujit. Për cilat ujëra thuhet se janë të ndotura? Kush i ndot ujërat? Si mund të pengohet ndotja e ujërave? Nxënësit duhet të dinë se uji mund të ndotet edhe pa u vënë re kjo gjë me sy (i tejdukshëm dhe pa aromë).

## Puna me Tekstin mësimor:

Shihen vizatimet. Çfarë ndodh me sheqerin dhe me kripën që hedhim në ujë? (Treten.) Lexohet teksti i shkruar. Si duket uji në të cilin hedhim miellin? (Është i turbullt.)

Bisedohet për kripën e detit. Ç'shije ka kripa e detit? Bisedohet me nxënësit për larjen në det. Si mund të nxirret përfundimi se në det ka kripë? (Kur dilet nga deti dhe thahemi, në trupin tonë mbeten gjurmët e kripës.)


Shihet fotografia e vjeljes së kripës dhe komentohet. Lexohen proceset e punës për përfitim të kripës.

Bisedohet për ndotjen e ujit. Cilët ujëra nuk janë të ndotura?

## Puna me Fletoren e punës:

1. Zhvillohet eksperimenti dhe plotësohet tabela: mielli – pjesërisht; mjalti – plotësisht; orizi – aspak; kripa – plotësisht; vaji – aspak; vegeta – pjesërisht; boja për ngjyrosjen e vezëve – plotësisht.
2. Shkruhet se ku tretet më shpejt sheqeri.
3. Shkruhet PO pranë pohimit të saktë dhe JO para pohimit të pasaktë.
4. Shkruhet receta për përgatitjen e limonadës.

**Mjetet ndihmëse:** gotat, shurupi, kripa, sheqeri, kanella, brumi i lapsave, erëza, mielli, lëngje pastrimi, uthulla, limoni




# MJEDISI IM

Kapitulli **Mjedisi im** përbëhet nga 7 tema mësimi: *Malet dhe fushat, Nga burimi deri tek grykëderdhja, Era dhe shiu, Po vjen pranvera, Kompjuteri, Grumbullojmë të dhënat, Matim kohën.*

**Qëllimet:** nxënësit përvetësojnë njohuritë për marrëdhëniet reciproke midis qenieve të gjalla dhe habitateve, nxjerrin përfundimin për mënyrën e ndikimit të njerëzve mbi ndryshimet natyrore, vënë re lidhjen midis qenieve të gjalla; mësojnë për bashkësitë e kafshëve në habitate të ndryshme (pyje, livadhe, ujë); zgjerojnë njohuritë për karakteristikat e ujit; përshkruajnë dhe dallojnë dukuritë natyrore; zgjerojnë njohuritë për erën dhe për lëvizjen e ajrit në natyrë; njihen me mënyrën e ndjekjes së kushteve të motit, por edhe të disa dukurive të tjera; nxjerrin përfundimin për lëvizjen dhe për raportin midis trupave që lëvizin; mësojnë t'i sistemojnë dhe t'i klasifikojnë të dhënat; zgjerojnë njohuritë për llojet e ndryshme të transmetimit të informacioneve si edhe me mënyrën e ruajtjes së informatave.

Në kuadër të këtij kapitulli nxënësit mësojnë për format kryesore të relievit, për karakteristikat e sipërfaqeve të rrafshëta e jo të rrafshëta të tokës. Lartësitë e mëdha që ngrihen prej lartësive të ulëta dhe prej terreneve të sheshta janë malet. Për nga origjina, ato mund të jenë vargje malore, masive malore dhe male vullkanike. Tek çdo mal veçohet rrëza, maja dhe shpatet (faqet). Zakonisht, malet grupohen në sistemet malore, ndërsa sipas lartësisë ndahen në: të larta, mbi 2000 m (të tilla janë Komët, Visitori, Durmitori, Sinjajevina, Hajlla etj.), të mesme, nga 1000 deri në 2000 m (Orjeni, Llovçeni, Rumia, Golia, malet e Pivës ...) dhe të ulëta, deri në 1000 m. Vendi ynë është kryesisht malor. Lartësia deri në 500 m që mund të kenë disa maja, është kodër, ndërsa nëse është lartësi më e vogël, me një majë, atëherë kjo është bregore ose kodrinë. Lartësia më e vogël në formë ovale me më pak se 200 m është breg ose sukë. Pjesët e gjera të sheshta të tokës, sipërfaqja e të cilave zbrit butësisht në një drejtim, janë fushat. Nëse janë në lartësinë nën 200 m mbi nivelin e detit, fjala është për ultësitrat, ndërsa, nëse janë në lartësi më të mëdha, atëherë këto janë rrafshnalta ose pllaja. Në fund, midis faqeve të pjerrëta është e vendosur lugina. Pranë lumit mund të shtrihet sipërfaqja e sheshtë e tokës (p.sh. lugina e Limit). Kur lumi depërton nëpër ngushticat shkëmbore, që ngrihen thik mbi të, atëherë bëhet fjalë për kanionin (kanioni i Moraçës, i Mërtvicës, i Tarës). Nëse lumi depërton midis dy maleve, atëherë është fjala për grykën (Gryka e Tifranit, Gryka e Gjallovicës). Sipërfaqet e sheshta të vendosura brenda maleve shkëmbore janë fushat karstike (gëlqerore). Këto janë thellime mbi të cilat janë faqet e thepisura, ndërsa fundet janë të sheshta dhe të mbuluara me tokë argjilore. Në këto fusha janë të shpeshta bregoret karstike (gëlqerore). Fushat karstike (gëlqerore) kanë rëndësi të madhe ekonomike, sepse në terrenet e tyre gjenden sipërfaqet e gjera të punëshme, të përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore (Fusha e Nikshiqit dhe Fusha e Cetinjës).

Pas njohjes së hollësishme dhe përshkrimit të formave të ndryshme të rrafshëta dhe jo të rrafshëta të relievit, me nxënësit bisedohet për ujërat në vendbanimin e tyre dhe në mjedisin përreth. Ujërat ndahen në ujëra rrjedhëse dhe në ujëra të ndenjura. Masa



e ujit që lëviz nëpër shtratin e lumit, quhet lumë. Reshjet që derdhen mbi sipërfaqen e tokës zënë rrjedha të mëdha ose të vogla uji, siç janë: rrëkeja, përroska, përroi dhe lumi. Pavarësisht nga madhësia, çdo rrjedhë uji përbëhet nga dy elemente; nga masa e ujit dhe nga shtrati në të cilin ajo lëviz.

Rrjedha e ujit nis nga burimi ose nga ama, ndërsa mund të burojë nga liqeni (lumenjtë me dalje nga liqeni), siç është lumi Buna që del nga liqeni i Shkodrës. Vendi ku një lumë derdhet në një lumë tjetër, në liqen ose në det, quhet grykëderdhje ose deltë. Të nëndheshëm quhen lumenjtë që e humbasin ujin nëpër hone, në zonat karstike (p.sh. lumi Zeta në Fushën e Nikshiqit. Gjatë verës, disa rrjedha uji thahen ( përrrenjtë a lumenjtë e thatë).

Gjatësia e rrjedhës së ujit matet nga grykëderdhja deri në burim. Lumi kryesor me degët e veta formon sistemin e lumit. Lartësia e nivelit të ujit në shtratin e lumit quhet shkalla e nivelit të ujit, ndërsa matet me shkallët ujëmatëse prej druri dhe shprehet në centimetra. Niveli i ujit varet nga reshjet dhe nga temperatura. Në pranverë, sidomos në rastet kur vjen tek shkrirja e shpejtë e dëborës, niveli i ujit në lumenj shtohet. Gjatë verës niveli i ujit në lumenj është më i ulët, për shkak të temperaturave të larta dhe të avullimit.


Liqenet janë gropat (thellimet) në tokën kontinentale të mbushura me ujë. Ato përbëhen nga baseni dhe nga ujërat, të cilat vijnë nga reshjet, nga lumenjtë që derdhen në to dhe nga burimet nënujore, ndërsa humbasin nga avullimi, nga rrjedhjet nëntokësore dhe nga lumenjtë që burojnë prej tyre. Liqenet që kanë lumenjtë që derdhen në to dhe që burojnë prej tyre, quhen liqene rrjedhëse. Kënetat ose moçalishtet janë sipërfaqet e tokës me ujë të palëvizshëm, me shtresë torfe dhe me bimë. Ato janë krijuar nga mbushja e liqeneve të cekëta me bimësi moçalore nga bregu në drejtim të qendrës. Lumenjtë, liqenet dhe kënetat janë habitate të shumë bimëve e të shumë kafshëve.

Njeriu e shfrytëzon fuqinë e ujit në mënyra të ndryshme, p.sh. me ngritjen e digave; pendave, janë ngritur liqenet artificiale, janë ndërtuar dhe hidrocentrale (Piva). Nga ana tjetër, njeriu ka ndikuar me sjelljen e vet të papërgjegjshme në pakësimin e sasisë së ujit të pijshëm e të pastër, me ç'gjë është vënë në rrezik ekzistenca e disa llojeve të bimëve e të kafshëve. Si pasojë, njeriu ka vënë në këtë mënyrë në rrezik edhe ekzistencën edhe sigurinë vetjake.

Edhe gjatë këtij viti shkollor me nxënësit do të bisedohet për dukuritë natyrore. Vrojtimi i kujdesshëm, afatgjatë dhe eksperimental mundëson përshkrimin e saktë e të suksesshëm të dukurive të motit. Matjet mundësojnë shënimin me vlera të caktuara ose me njësitë matëse të një sasia a dukurie të caktuar. Në këtë mënyrë, nxënësit kanë rastin të krahasojnë dukuritë e njëjta të motit dhe t'i sistemojnë ato sipas vlerave e njësisive matëse të caktuara. Edhe më parë, nxënësit kanë matur madhësitë konkrete; gjatësinë dhe peshën. Mund të matet sasia e reshjeve të rëna, p.sh. lartësia e ujit në enën për mbledhjen e shiut, ose trashësia e borës së rënë. Sasia e shiut të rënë matet me njësinë matëse të gjatësisë.

Meteorologët e matin dhe e shprehin gjithashtu sasinë e shiut në mm, d.m.th, i paraqitin numerikisht litrat e shiut për m<sup>2</sup> të sipërfaqes. Nxënësit do të njihen dhe do të përdorin mënyrën e re të matjes; temperaturën si madhësi joaditive. Karakteristike është se këto madhësi nuk mund të mblidhen thjesht sikurse madhësitë aditive, d.m.th, nëse në ujin me temperaturë 10° C zbrazim ujin me të njëjtën temperaturë, përzierja nuk do të jetë 20° C, por masa e tij do të jetë e barabartë me shumën e të dy masave së bashku. Njësia matëse e temperaturës që përdoret më shpesh tek ne është gradë Celsius (°C), kurse në shkencat natyrore përdoret Kelvin (K).

Për matjen e temperaturës përdoret termometri. Në termometrin me zhivë ose me alkool, lëngu bymehet, kur nxehet ose tkurret, kur ftohet, kështu që gypi me lëng është



më i gjatë ose më i shkurtër. Gypi më i lartë shënon temperaturën më të lartë. Temperatura e ajrit matet në hije dhe pak mbi sipërfaqen e tokës.

Si pasojë e ndërrimit të temperaturës së ajrit, ajri i ngrohtë ngrihet lart, kurse ajri i ftohtë zbret poshtë. Kështu krijohet era. Drejtimi dhe shpejtësia e erës përcaktohet me erëtragues. Ata janë të kthyer në drejtimin nga fryn era, ndërsa shigjeta ose shenja e caktuar tregon drejtimin nga fryn era. Kështu, nëse fryn veriu, degët, flamujt dhe tymi tregojnë drejtimin e erës nga veriu në drejtim të jugut.

Por, përveç drejtimit, mund të matet dhe të përcaktohet edhe shpejtësia e erës, e cila nxirret nga shuma herë dhe kohë. Në këtë moshë, nxënësit e vlerësojnë dhe e krahasojnë më shumë intuitivisht shpejtësinë e lëvizjeve të ndryshme dhe akoma nuk janë të përgatitur për matje dhe për llogaritje të ndërlikuara. Nëse erëmatësi rrotullohet më shpejt, kjo gjë tregon se shpejtësia e erës është më e madhe. Për këtë arsye, nxënësit e shprehin shpejtësinë e erës si cilësi, d.m.th. e dobët, e fortë, shumë e fortë, e shpejtë/e fuqishme, e dobët/e ngadaltë. Ndërkohë, matjet më të sakta sasiore përdoren nga meteorologët, të cilët e shprehin shpejtësinë e erës me metra në sekondë (m/s) ose me kilometra në orë (km/h). Ekziston edhe shkalla e matjes në bofor, të cilën e përdorin lundërtarët për matjen e shpejtësisë së erës (vlerësimi i lartësisë së dallgëve, lëvizja e drurëve etj.).

Instrumentet e lartpërmendura të matjes; termometri dhe erëtraguesi mundësojnë një matje të saktë dhe objektive. U rikujtohen nxënësve edhe disa mënyra vlerësimi për të cilat është folur më parë, p.sh. vlerësimi në bazë të ngjyrës ose të zërit (tingullit). Nxirret përfundimi se, vlerësimi i bazuar mbi treguesit siç është nuanca e ngjyrës dhe fuqia e zërit, për gjendjen dhe për ndryshimet e një dukurie mund të shprehen subjektivisht nga këndvështrimi i vetë vlerësuesit, por në mënyrë më të saktë e më objektive matet me ndihmën e instrumenteve matëse. Mbi bazën e matjeve të sakta, duke përdorur aparataturat moderne, meteorologët, p.sh., nxjerrin ligjësitë e caktuara që mundësojnë parashikimin më të lehtë të motit. Ndër të tjera, përpjekja për parashikimin e motit, që është një veprim shumë i rëndësishëm në shkencat natyrore, është i bazuar në ndërlidhjen e përvojës e njohurive për ndonjë dukuri. Nxënësve u sugjerohet se ata vetë mund t'i parashikojnë disa dukuri mbi bazën e përvojës ose të eksperimenteve të vogla. Në këtë mënyrë ata e zgjerojnë përvojën e vet dhe i përforcojnë njohuritë për disa dukuri.

Në kuadër të kapitullit të tretë, nxënësit kanë biseduar e kanë mësuar për jetën në pyll. Vazhdohet me njohjen dhe me përshkrimin e botës bimore e shtazore në pyll e në livadh dhe me ndryshimet që ndodhin si pasojë e ndërrimit të stinëve të vitit.

Me nxënësit bisedohet për ndryshimet që ndodhin në pranverë tek bota bimore dhe shtazore. Në fillim të pranverës drurët nuk i kanë nxjerrë akoma gjethet, ndërsa pylli është plot dritë. Atëherë lulëzojnë bimët pranverore. Nxënësit vrojtojnë si duket pylli, kopshti, pemëtorja dhe livadhi në këtë periudhë. Mendohet edhe për mënyrën sesi mund të ndihmohet për ruajtjen dhe për mbrojtjen e mjedisit natyror.

Një nga mjetet më shpesh të përdorura në jetën e sotme të përditshme moderne është kompjuteri, aparatura që ndihmon transmetimin dhe ruajtjen e informatave. Në klasën e parë dhe të dytë, nxënësit kanë mësuar të dërgojnë mesazhe me anë të pllakateve e të vizatimeve, kurse gjatë këtij viti shkollor do të mësojnë sesi bëhet kjo gjë me anë të postës elektronike. Sot as që mund të mendohet funksionimi i institucioneve të ndryshme pa komunikimin elektronik. Ngjashmëria midis postës elektronike e telefonave celular, të cilët gjithashtu janë bërë pjesë e jetës sonë të përditshme, është se kanë operatorin e vet.

Përmes tij, kompjuteri është i lidhur me internetin. Operatori i grumbullon mesazhet për adresën e caktuar në një seksion të veçantë. Kur jemi të lidhur me operatorin, mund ta marrim dhe ta lexojmë postën. Po kështu, kur dërgojmë mesazhe, ato grumbullohen në postën elektronike, ndërsa pastaj, me anë të rrjetit, arrijnë tek marrësi. Përdoruesit e






postës elektronike kanë adresën e vet.

Puna e shpejtë dhe efikase në kompjuter mundësohet falë njohjes dhe përdorimit të simboleve ose të ikonave të ndryshme grafike që shënojnë operacione të caktuara.

Kompjuterët mundësojnë pasjen në dispozicion një baze kolosale të dhënash. Gjithashtu, në kompjuter ruajmë informatat tona të rëndësishme, shkrimet, shënimet e punimet e ndryshme, të cilat i vendosim dhe i sistemojmë në foldera të veçantë. Në këtë mënyrë të dhënat janë të sistemuara, të qarta dhe lehtësisht të përdorura. Sistemimi, klasifikimi dhe ndarja e të dhënave bëhet sipas kriterëve të caktuara, p.sh. sipas rendit alfabetik (p.sh. emrat e abonentëve telefonikë, nocionet në enciklopedi ...). Mund të nisemi edhe nga kriteret e tjera gjatë sistemimit e lidhjes së informatave të ndryshme (radha kur janë shfaqur a bërë publike etj.). Prej të dhënave të sistemuara kështu lind struktura dhe dija e caktuar.

Të dhënat e sistemuara mund të paraqiten edhe në mënyrë tabelare. Gjatë këtij viti shkollor nxënësit do të mësojnë edhe mënyrat më të ndërlikuara të paraqitjes. Me anë të grafikës figurative (piktogrameve) do t'i paraqitin dukuritë me figura, ndërsa në histograme ose në diagrame do të përdorin kolonat (shtyllat). Mbi bazën e pozicionit dhe të formës së grafikëve, nxënësit mund të vërejnë ligjësitë e caktuara dhe të parashikojnë disa mundësi teorike.

Nxënësit edhe gjatë këtij viti shkollor njihen me lëvizjen dhe shohin mundësinë e ndryshimit të lëvizjes. Nëse dëshirojnë të zbulojnë sesi një e ndryshueshme (jokonstante) ndikon mbi lëvizjen, ata duhet të ndërrojnë vlerën e kësaj madhësie, ndërsa gjithçka tjetër mbetet e njëjtë. Kjo është mënyra më e mirë që nxënësit, duke eksperimentuar, të arrijnë vetë deri tek disa njohje e përfundime të dobishme. Por, mbi lëvizjen mund të ndikojnë disa të ndryshueshme (jokonstante). Fillimisht duhet të përcaktohet e ndryshueshmja (jokonstantja) e pavarur dhe sjellja e saj. Njëlloj është edhe me tretjen. Nëse duam p.sh. të dimë a tretet më shumë sheqer apo kripë në ujë, ndërrohet lënda që tretet, ndërsa sasia e ujit, temperatura dhe mënyra e përzierjes mbetën të njëjta. Domethënë, e ndryshueshmja (jokonstantja) e pavarur është lënda (materia), ndërsa e varur është sasia e lëndës (materies). E ndryshueshmja (jokonstantja) e pavarur ka dy vlera: kripën dhe sheqerin. Lëvizja dhe nocioni kohë janë ngushtësisht të lidhur. Për njësitë më të mëdha kohore nxënësit kanë mësuar vitin e kaluar shkollor (viti, muaji, dita). Periudhat më të shkurtra kohore duhet të përcaktohen ndryshe. Shihet ora e rërës dhe lëvizja e njëtrajtshme e rërës. Kohën tek ora (sahati) e përcaktojnë akrepat, kështu që e lexojmë në bazë të madhësisë së këndit që formojnë akrepat në raport me pikën që shënon orën 12. Tek nxënësit e kësaj moshe piqet gradualisht ndërgjegjësimi për relativitetin e ndjesisë personale ndaj kohës. Për vlerësimin preciz e objektiv të kohëzgjatjes së dukurisë, ndihmojnë matjet e ndryshme të kohës. Për këtë qëllim shfrytëzojmë orët (sahatet) me akrepa ose orët digjitale, në të cilat koha është e shkruar me numra.



## MALET DHE FUSHAT

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen sipërfaqet e tokës në vendbanimin e vet</li><li>• të dallohen sipërfaqet e rrafshëta dhe jo të rrafshëta</li><li>• të arrihet në përfundimin se sipërfaqja e tokës mund të jetë e punueshme dhe e papunueshme</li><li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit në ndryshimet në natyrën e vendbanimit</li><li>• të vihet re se sipërfaqja e tokës duhet të mbrohet nga ndotja</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	sipërfaqja e tokës e rrafshët, sipërfaqja e tokës jo e rrafshët, ultësirë, fushë, luginë, kanion, bregore, kodrinë, kodër, mal, zonë shkëmbore; rrëpirë, pjerrësi

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Vizitohet rrethina. Nxënësit vëzhgojnë format e ndryshme të sipërfaqeve të tokës. Nxjerrin përfundimin, se toka mund të jetë e rrafshët dhe jo e rrafshët. Emërtojnë format e rrafshëta dhe jo të rrafshëta të tokës.
2. Vihet re, se disa sipërfaqe toke janë të punueshme, ndërsa disa të papunueshme. Emërtojnë sipërfaqet e punueshme (arë, kopsht, pemishte ...). Shfaqin supozimet e veta, pse disa toka mund të jenë të punueshme, ndërsa disa mund të jenë të papunueshme. Emërtojnë sipërfaqet e tokës së papunueshme (pyll, livadh, moçalishte, zallishte ...). Cila prej këtyre sipërfaqeve mund të kthehet më lehtë në sipërfaqe të punueshme? Pse?
3. Bëhet njohja me hartën fiziko-gjeografike (pa këmbëngulur tek konceptet gjeografike). Gjejnë fushat dhe lartësitë në hartë. Bëjnë supozimin, se ç'kuptim kanë ngjyrat hartografike (e gjelbra tregon fushat, e verdha dhe kafeja tregon lartësitë, bluja tregon detin).
4. Nxënësit e pasqyrojnë me vizatim vendbanimin e vet (fushat dhe lartësitë).
5. Në klasë, me plastelinë ose me argjilë, punohen format e sipërfaqeve të tokës në vendbanim. Në varësi të materialit prej të cilit punohen, ngjyrosen me ngjyrën përkatëse, që i përgjigjet ngjyrës hartografike të këtij tipi.
6. Bisedohet me të moshuarit për pamjen e dikurshme të vendbanimit e të rrethinës. Çfarë ka ndryshuar? Si ka ardhur deri tek ndryshimi (shpyllëzimi, pyllëzimi i vendeve të zhveshura, erozioni...)?
7. Bisedohet për qëndrimet e mira dhe të këqija të njeriut ndaj sipërfaqeve të tokës.


### Puna me Tekstin mësimor:

Shihen fotografitë dhe emërtohen sipërfaqet e paraqitura të tokës. Nxirret përfundimi, se sipërfaqja e tokës mund të jetë e rrafshët dhe jo e rrafshët dhe se ka disa lloje të sipërfaqeve jo të rrafshëta. Emërtojnë format e paraqitura të sipërfaqeve të rrafshëta (ultësirë, fushë). Vihet re, se disa sipërfaqe të rrafshëta janë të punueshme, kurse disa të tjera janë të papunueshme.

Emërtohen të gjitha llojet e sipërfaqeve jo të rrafshëta të tokës, duke i krahasuar ato sipas lartësisë dhe pamjes. Emërtohen pjesët e lartësisë; rrëzë, brinjë (shpat) dhe majë.

Bisedohet për ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet luginës dhe kanionit.





Çfarë u kujton nxënësve zona shkëmbore në figurë (livadhin, gurishtën ...)?  
Komentohet harta fiziko-gjeografike dhe mënyra e paraqitjes së formave të ndryshme të sipërfaqes së tokës.

**Puna me Fletoren e punës:**

1. Shkruhen emërtimet e formave të sipërfaqes së tokës.
2. Shkruhen emërtimet e sipërfaqeve të rrafshëta dhe jo të rrafshëta të vendbanimit ose të rrethinës së vet.
3. Vizatohet, sipas kërkesës, shtëpia, bredhi dhe flamurka. ) Përcaktohet rrëza, brinja (shpati) dhe maja.
4. Zgjidhet fjalëkryqi (pyje, busulla, malesh, shpatet, kanion, majat, jeshile) dhe shkruhet zgjidhja (Pllatije) në vendin e duhur.


**Mjetet ndihmëse:** plastelinë, glinamol, argjilë

## NGA BURIMI DERI TEK GRYKËDERDHJA

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen ujërat përreth vendbanimit</li> <li>• të dallohen ujërat e ndenjura nga ujërat rrjedhëse</li> <li>• të vihet re se ujërat mund të ndoten</li> <li>• të nxirret përfundimi se për pirje përdoret uji i pastër</li> <li>• të kuptohet rëndësia e ujit për qeniet e gjalla</li> <li>• të arrihet në përfundimin se uji duhet të kursehet</li> <li>• të vihet re lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatet e tyre.</li> <li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit ndaj ndryshimeve në natyrën e vendbanimit</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	<p>uji rrjedhës, uji i ndenjtur, burim, grykëderdhje (deltë), dega e lumit, përrua, lumë, liqen, moçal, pus, saranxhë (sterrë), digë (pendë), troftë, guaska e lumit, lundërz, bollëujëse, rosa e egër, krap, lëkoi, shelgje</p>

**Veprimtaritë e propozuara:**

1. Flitet për ujërat e vendbanimit dhe të rrethinës së vet. Vihet re se ujërat janë rrjedhëse ose të ndenjura? A janë këto ujëra natyrore, apo janë ngritur nga njeriu? Nëse janë ngritur nga njeriu, cila ka qenë arsyeja?
2. Vizitohen ujërat e vendbanimit. Përshkruhen ato dhe vihen re disa bimë dhe kafshë në to. Merret uji me një kovë të vogël dhe përshkruhen karakteristikat e tij, emërtohen qeniet që shihen në të. Gërmohet me një lopatë të vogël toka pranë ujit dhe përshkruhet sesi është dheu. Cilat kafshë jetojnë në tokën pranë ujit? Përshkruhet pamja e tyre. Pse jetojnë pikërisht aty? A njohin nxënësit bimë dhe kafshë të tjera që jetojnë në ujë? Dallojnë pjesët e lumit ose të liqenit, ku uji është në dukje më i pastër. Komentohet, nëse uji që vrojtojnë mund të përdoret ose jo për pirje. Ku është më i ndotur uji? (Në afërsi të bregut.) Në cilën pjesë të lumit, rrjedha e ujit është më e shpejtë dhe më e ngadaltë.
3. Shkruhet emërtimi i ujit që kanë vrojtuar dhe banorët e tij. Klasifikohen bimët dhe kafshët e vëna re në ato që jetojnë në ujë dhe në ato që jetojnë pranë ujit.



4. Ndërtohet stenda e klasës me banorët e ujërave rrjedhëse dhe të ujërave të ndenjura.
5. Modelohen me plastelinë kafshët e ujit. Vihet re forma e trupit.
6. Nëse ekziston mundësia, vizitohen ujërat që ka ngritur njeriu. Komentohet pamja dhe funksioni i tyre. Çfarë i është dashur njeriut për t'i ngritur ato? Si i mbron njeriu ujërat artificiale nga ndotja? Si e nxjerr njeriu ujin nga pusi? Pse e nxjerr në këtë mënyrë? Si e nxjerr njeriu ujin nga sterna? Cili ujë është mbledhur në sternë? (Uji i shiut apo uji i borës.) A mund të pihet uji i sternës? Pse nuk mund pihet? Kur mund të pihet uji i sternës? (Pas pastrimit me preparate të ndryshme ose me ndërtimin e filtrave.)
7. Plotësohet relievi i klasës me ujërat e vendbanimit të vet (me plastelinë ose me argjilë të ngjyrosur).
8. Lexohen tekstet e shkruara për rëndësinë e ujit për jetën, për problemet e ndotjes së ujit dhe për mënyrat e mbrojtjes së ujit.
9. Shihet filmi për fatkeqësitë që mund të shkaktojnë përmytjet dhe për mënyrat si mbrohet njeriu prej tyre (penda, rregullimi i shtretërve të lumenjve). Flitet për arsyet e shkaktimit të përmytjeve dhe në ç'stinë të vitit ka më shumë përmytje. Pse pikërisht atëherë? Si i shkakton njeriu përmytjet me veprimtaritë e veta në natyrë?
10. Nëse në vendbanim ekziston shërbimi i veçantë i ngarkuar për mbrojtjen e ujërave, vizitohet ky objekt, ose ftohet për vizitë personi që mund të informojë për ndotësit më të mëdhenj të ujit në vendbanim. Bisedohet për mënyrat më të shpeshta të ndotjes së ujërave dhe për mënyrat e mbrojtjes së tyre.
11. Hartohet lista e propozimeve për mbrojtjen e ujit në vendbanimin e nxënësve.
12. Shihet filmi për vozitjen me trap në lumin Tara ose bisedohet për atë që dihet lidhur me këtë lloj vozitjeje.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë dhe vizatimet, përshkruhen dhe komentohen ato. Lexohen tekstet e shkruara poshtë fotografive. Cilin prej ujërave në fotografi i kanë parë nxënësit në vendbanimin e vet? Ç'bimë dhe kafshë kanë parë? Cilat prej tyre nuk janë në fotografi, por i kanë parë pranë ujërave të vendbanimit të vet? Emërtohen ujërat që janë krijuar në rrugë natyrore dhe ato që janë ngritur nga njeriu. Pse i ngrenë njerëzit këto ujëra artificiale? Si paraqiten ujërat në hartë (reliev)?

Vihet re se uji mund të ndotet. Në ç'mënyra mund të bëhet kjo gjë? A mund të përdoren për pirje të gjitha ujërat? Cili është uji më i sigurt për pirje? Po në natyrë?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Shkruhen emërtimet e ujërave në vendbanimin e vet, duke i klasifikuar ato në ujëra rrjedhëse dhe në ujëra të ndenjura.
2. Shkruhen në vizatim emërtimet përkatëse të pjesëve të lumit. Shihet pellgu ujëmbledhës i ujit.
3. Mbi vijat poshtë vizatimit shkruhet sesi përdoret uji (për pirje, për gatim, për mbajtjen e higjienës, për vënien në lëvizje të gurit të mullirit, për ujitje, për lundrim).
4. Plotësohen fjalitë lidhur me ndotjen e ujit.
5. Zgjidhet rebusi (rrjedha, pika).

**Mjetet ndihmëse:** plastelina, argjila e njomë.

# ERA DHE SHIU


<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të dallohen dukuritë e motit; erë, reshje</li><li>• të paraqiten të dhënat e grumbulluara me tabela dhe në formën e histogramit</li><li>• të përdoren materialet e ndryshme për punimin e sendeve (objekteve) të ndryshme</li><li>• të lidhen materialet e ndryshme dhe mjetet përkatëse të punës</li><li>• vihen re mbeturinat dhe hiqen ato nga vendi i punës</li><li>• të njihet parashikimi i motit</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	matje, sasia e reshjeve, lartësia e nivelit të sipërfaqes, termometër, temperaturë, temperatura e ajrit, gradë Celsius, shpejtësia e erës, drejtimi i erës, erëtragues, helika e erës, parashikimi i motit

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Bisedohet për kushtet e motit. Si është moti sot? Si ka qenë moti dje? Përshkruhen kushtet e motit?
2. Bisedohet për parashikimin e motit. Si mund të mësojmë se ç'mot na pret? Çfarë është shkruar ose çfarë është thënë për parashikimin e motit?
3. Bëhet erëtraguesi. Në një shkop druri vihen shiritat prej letre. Vrojtohet erëtraguesi kur fryn erë. Në ç'drejtim janë të kthyer shiritat? Kuptohet se era fryn nga drejtimi i kundërt me atë në të cilin janë të kthyer shiritat (nëse janë të kthyer në drejtim të jugut, atëherë fryn era e veriut dhe anasjelltas).
4. Përgatitet shimatësi. Merret një shishe plastike dhe pritët pjesa e ngushtë (gryka e shishes). Shënohen me flomastër vijat ndarëse nga 0 deri në 20 cm.
5. Vendoset shimatësi në një vend të hapur (ngulitet ose ngulet në tokë). Ndiqet sasia e ujit të mbledhur gjatë disa ditëve dhe të dhënat shkruhen në tabelë. Pas matjes uji zbrazet dhe shimatësi kthehet përsëri në të njëjtin vend. Vizatohet grafiku i ujit të mbledhur sipas ditëve. Në cilën ditë ka rënë më shumë dhe më pak shi?
6. Nxënësit njihen fillimisht me termometrën dhe me mënyrën e matjes me termometër. Vihet re shkalla e termometrit dhe ndryshimet midis termometrave, nëse ka disa prej tyre.
7. Matet temperatura e ajrit në klasë, në korridorin dhe në oborrin e shkollës. Rezultatet e matjeve shkruhen në tabelë. Ku ka qenë temperatura më e lartë dhe më e ulët?
8. Ndiqet ndryshimi i temperaturës gjatë ditës. Termometri vendoset në një vend të caktuar në oborrin e shkollës. Ndiqet ndryshimi i temperaturës në çdo një orë. Temperaturat shkruhen në tabelë. Komentohet sesi ka ndryshuar temperatura.
9. Maten temperaturat e ajrit çdo ditë gjatë një jave dhe në të njëjtën kohë. Shkruhen rezultatet e matjeve dhe komentohet sesi ka ndryshuar temperatura.

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit shohin fotografinë. Nixirret përfundimi, se ç'mot është. Lexojnë tekstin e shkruar poshtë fotografisë. Çfarë tregon erëtraguesi dhe çfarë erëmatësi? Shohin fotografinë e dallgëve. Lexojnë tekstin poshtë fotografisë.



Bisedohet për reshjet. Ç'reshje njohin nxënësit? Lexohet teksti i shkruar? Çfarë bie prej reve? Tregohet përvoja vetjake për breshrin. Kur ka rënë breshër? A ka bërë ndonjë dëm breshri? Në ç'mënyrë mund të mblidhet uji i shiut?

Në cilën stinë të vitit është temperatura më e lartë dhe temperatura më e ulët. Cilat reshje janë më shpeshta gjatë dimrit? Çfarë mund të bëhet në dëborë? Si duhet të jemi të veshur? Pse duhet të jemi të veshur kështu? Cila është temperatura e ajrit në dimër? Me çfarë e matim temperaturën? Cila është temperatura e ajrit në verë? Ç'mot mban gjatë verës?

Si e dimë se ç'mot do të jetë nesër? Shihet vizatimi i parashikimit të motit dhe lexohet teksti shkruar?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Përgatitet shimatësi. Shkruhet data e matjes. Plotësohet tabela. Shkruhet koha (ora) e matjes dhe sasia e reshjeve të mbledhura në centimetra. Të dhënat e tabelës paraqiten në grafik.
2. Shihet vizatimi dhe shkruhet në katrorë fuqia e erës (nga një deri në 3).
3. Në grafikun e parashikimit të motit, të temperaturave të ajrit, vihet re temperatura më e lartë dhe më e ulët dhe shkruhet data.


**Mjetet ndihmëse:** shkopi prej druri, shiritat prej druri, shishja plastike, flomasteri, termometri.

## **PO VJEN PRANVERA**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të vihen re ndryshimet tek bimët në varësi të stinës së vitit</li><li>• të dallohen bimët gjethembajtëse dhe gjetherënës</li><li>• të vihet re se veprimtaritë e kafshëve ndryshojnë në varësi të stinës së vitit</li><li>• të kuptohet se për jetën e bimëve nevojitet uji, drita dhe ajri</li><li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën</li><li>• të zhvillohet ndërgjegjja ekologjike</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	pyll, pylli halor, pylli gjetherënës, pylli i përzier, drurët me hala, drurët me gjethe, bimët pranverore, erozioni i tokës, barsdita, ditëgjata (solstici i verës)

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Organizohet vizita në pyll ose në park. Çfarë ka ndodhur me parkun në vjeshtë? Çfarë ka qenë ndryshe në dimër? Krahasohet sesa kanë gjethuar drurët? Nxënësit kuptojnë se drurët nuk gjethojnë në të njëjtën kohë. Ç'lule shihen? Ku gjenden ato? (Vendet



e rrahura nga dielli.) Çfarë dëgjohet në pyll (park)? A dëgjojen këngët e zogjve më shumë në pranverë apo në vjeshtë? Pse?

2. Vizatohet në klasë pylli ose parku në pranverë.
3. Organizohet vizita në pemëtore. Si duken drufrutorët në pranverë? Ç'punë kryejnë njerëzit në pranverë në pemëtore?
4. Vizatohet në klasë pemëtorja në pranverë.
5. Kultivohen bimët. Mbillen në klasë bimët e ndryshme. (Shënohet se çfarë është mbjellë në secilin vend.) Saksitë vendosen në një vend ku bie dielli. Nxënësit i ujitin rregullisht bimët dhe ndjekin rritjen e tyre. Cila bimë ka mbirë e para dhe cila ka çelur lule e para? Krahasohet pamja e gjetheve dhe e luleve.
6. Lexohet enciklopedia për kafshët. Vihen re veprimtaritë e kafshëve në pranverë. Pse zgjohen kafshët nga gjumi i dimrit në pranverë?
7. Në klasë sillen dy vazo qelqi me ujë. Në secilën vazo vihen karafilat e bardhë? Në një vazo hidhet boja e shkrimit. Ditën e nesërme shihet se çfarë ka ndodhur. Cilët karafila e kanë ndryshuar ngjyrën? Nxirret përfundimi se bima thith ujin dhe lëndët që gjenden në të. Lidhen veprimtaritë e njerëzve me mjetet e punës që përdoren për shtimin e prodhimit të frutave e të zarzavateve.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihet kalendari. Thuhen muajt e pranverës. Kur fillon pranvera. Sa janë të gjata nata dhe dita me 21 mars? Si quhet kjo ditë? Pse quhet kështu?

Shihet fotografia e pyllit në pranverë. Lexohet teksti i shkruar poshtë fotografisë. Pse është i rëndësishëm pylli për njerëzit? Çfarë ndodh nëse pyjet priten me shumicë? Si mund të pengohet kjo gjë?

Bisedohet për lulet që çelin të parat në pranverë. Shihet agulicja dhe fillikatja e bardhë. Lexohet teksti i shkruar poshtë fotografisë.

Thuhen muajt e verës. Kur fillon vera? Sa janë të gjata nata dhe dita me 21 qershor? Si quhet kjo ditë? Pse quhet kështu?


Shihet fotografia. Kur shkojnë nxënësit më shpesh në piknik? Me kë shkojnë në piknik? Çfarë kafshësh kanë parë gjatë piknikut?

Lexohet teksti i shkruar për zhumbicën. Cilat çaje ju pëlqejnë më shumë që t'i pini? Kur i pini ato?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Shkruhen ndryshimet që ndodhin në pranverë (ndryshimet e motit, ndryshimet në ara, ndryshimet në pyll, ndryshimet tek kafshët).
2. Shkruhen ndryshimet që ndodhin në verë (ndryshimet e motit, frutat e perimet, kafshët; insektet, veprimtaritë e njerëzve gjatë verës, zjarret).

**Mjetet ndihmëse:** dy vazo, karafili i bardhë, boja e shkrimit



# KOMPJUTERI

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen nxënësit me llojet e ndryshme të transmetimit të informacioneve</li><li>• të njihet përdorimi i disa llojeve të transmetimit të informacioneve</li><li>• të mësohet që të ruhen disa të dhëna të medieve të ndryshme</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	informacion, kompjuter, ekran, tastierë, mi, program, ikonë (figurëz), meny, Internet, postë elektronike, sistemim, renditje

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Bisedohet me nxënësit se në ç'mënyrë mund të vihet tek informatat (parashikimi i motit, filmi që mund të shihet në kinema, orari i udhëtimit, shfaqja teatrore).
2. Në ç'mënyrë mund të dërgohen informatat (me telefon celular; me SMS mesazhe ose duke biseduar, me letër, me telegram, duke përdorur kompjuterin).
3. Bisedohet për kompjuterin. Si përdoret kompjuteri? Për ç'qëllime përdoret kompjuteri? Çfarë mund të mësohet me anë të kompjuterit? Si komunikoni me shokët tuaj?
4. Njihet kompjuteri. Vihen re pjesët e kompjuterit dhe komentohet funksioni i tyre. Nxënësit ushtrohen që ta ndezin kompjuterin, të kërkojnë programin që u duhet, ta mbyllin programin dhe ta fikin kompjuterin. Ushtrohen të shkruajnë një tekst të shkurtër, ta ruajnë në folderin përkatës.
5. Dërgohen mesazhe. Nëse në shkollë ekziston klasa e internetit, nxënësit që kanë e-mail adresën u dërgojnë mesazhe shokëve. U shpjegohet nxënësve se internet adresa është e domosdoshme për komunikimin me anë të e-mailit. Që të mund të shfrytëzohen interneti dhe posta elektronike, kompjuteri duhet të jetë i lidhur me rrjetin. Rrjeti është sistemi që lidh me anë të kablove një numër shumë të madh kompjuterësh. Nxënësit e tjerë ndjekin punën në kompjuter. Me leje të prindërve u çelet e-mail adresa nxënësve që nuk e kanë atë, kështu që mund të komunikojnë me njëri-tjetrin.
6. Pas ushtrimit në dërgimin e imejllit, hartohet pyetësori sociometrik. Cili nxënës ka marrë më shumë/më pak imejle nga shokët e vet. Përcaktohet pse është kështu dhe forcohet bashkëpunimi reciprok midis nxënësve.

## Puna me Tekstin mësimor:

Nxënësit emërtojnë pjesët e kompjuterit (ata që kanë përvojë në punën me kompjuter, tregojnë si përdoret kompjuteri, si ndizet, për çfarë shërben miu dhe për çfarë shërben tastiera, si i ruajnë të dhënat, si dërgojnë mesazhet). Komentojnë ikonat, cilën ikonë duhet të klikojmë që të mund ta shkruajmë tekstin, cilën për shfrytëzimin e internetit, cilën që të mund të dërgojmë e të lexojmë postën që kemi marrë. Lexohet teksti poshtë ikonave. Nxënësit e kuptojnë se me ndihmën e postës elektronike i shkëmbejnë mesazhet brenda një kohe shumë të shkurtër, pavarësisht nga largësia.

Çfarë mund të mësohet me ndihmën e kompjuterit? Ueb sajti është forma e paraqitjes së një personi, firme apo institucioni në internet. Mjafton vetëm që të shkruhet internet adresa, e cila fillon zakonisht me www.

Komentohet vizatimi që paraqet fëmijën me kompjuter. Pse nuk duhet të kalohet shumë kohë në kompjuter?

### **Puna me Fletoren e punës:**


1. Lidhen të gjitha mënyrat me të cilat mund të mësohet orari i udhëtimeve (gazetat, telefoni, interneti), receta e tortës (kuzhinieri, interneti), për kafshët (enciklopedia, interneti), parashikimi i motit (radio, TV, interneti).
2. Shkruhet sesi mund t'i urohet ditëlindja shokut.
3. Sistemohen fjalët sipas kriterëve të dhëna. Nxënësit mund të zgjedhin kriterin e vet dhe t'i sistemojnë rë dhënat sipas këtij kriteri.

## **GRUMBULLOJMË TË DHËNAT**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen mënyrat e ndryshme të transmetimit të informacioneve</li><li>• të mësohet përdorimi i ndonjërit nga llojet e transmetimit të informacioneve</li><li>• të zhvillohet aftësia për komunikimin me grafik</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	teksti i shkruar, tabelë, shtyllë, kolonë, histogram, shiriti i kohës

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Bisedohet për kafshët që na pëlqejnë më shumë (thuhet pesë kafshë). Në ç'mënyra mund të paraqitet pëlqyeshmëria e kafshëve të veçanta në klasën e nxënësve? Vizatohet tabela (kolona 1 – emërtimi i kafshës, kolona 2 – numri). Plotësohet tabela. Hartohet histogrami (vertikalisht numrat, horizontalisht emërtimet e kafshëve).
2. Bisedohet për atë se të gjitha kafshët dhe bimët nuk jetojnë njëllë gjatë. Për këtë arsye nxënësit nuk duhet të befasohen, nëse kanakarët e tyre vdesin pas disa vitesh. Hartohet histogrami i jetëgjatësisë së disa kafshëve (breshka – 120 vjet, ketri – 8 vjet, miu – 1 vjet).
3. Mblidhen nga revistat format e ndryshme të paraqitjeve grafike. Sistemohen ato në: piktograme, histograme, tabela...
4. Analizohet grafiku i temperaturës për një periudhë kohore.
5. Ndiqet temperatura në klasën e vet gjatë një jave dhe të dhënat pasqyrohen në mënyrë tabelare në formë grafiku.
6. Hartohet grafiku i strukturës gjinore të klasës së nxënësve.



### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihet vizatimi dhe lexohet teksti i shkruar. Në ç'mënyra do të mësojnë nxënësit diçka më shumë për bletën? Çfarë kanë mësuar? Komentojnë mënyrat në të cilat është paraqitur kjo gjë. Lexohen të dhënat në tabelë.

Bletët kryejnë punë të ndryshme. Shihet tabela dhe lexohen të dhënat për bletën. Thuhen punët (dhe moshën) e bletëve. Mbi bazën e të dhënave të tabelës e të kolonës lidhen emërtimet e bletëve dhe punët që kryejnë ato.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Lexohen të dhënat e tabelës dhe pasqyrohen ato me grafik. Prej nga e kanë më të lehtë nxënësit që të vërejnë se sa kohë nevojitet që të çelin matka, bletët roje, bleta punëtore (nga teksti i shkruar, nga tabela apo nga grafiku)?
2. Bëhen hulumtime për breshkën e moçalishteve. Bisedohet se ku mund të gjenden informacionet e duhura për këtë gjë. Nxënësit lexojnë se çfarë kanë mësuar, ndërsa pastaj shkruajnë në vendin e caktuar. Shkruajnë se çfarë tjetër kanë mësuar për breshkën e moçalishteve.


## **MATIM KOHËN**

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të nxirret përfundimi se mbi lëvizjen mund të ndikohet (të ndryshohet drejtimi, kahja, shpejtësia)</li><li>• të vihet re ndryshimi i lëvizjes në raport me ndikimin e jashtëm</li><li>• të njihen mënyrat e matjes së kohës</li><li>• të dihet të bëhet planifikimi i veprimtarive ditore</li><li>• të përdoren materialet e ndryshme për punimin e sendeve të veçanta</li><li>• të bëhet lidhja midis materialeve dhe mjeteve përkatëse të punës</li><li>• të vihen re mbeturinat dhe të mënjanoen ato nga vendi i punës</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	kohë, orë (sahat), minutë, sekondë, matja e kohës, rrugë, lëvizje, rrotullim, shpejtim, currili i ujit

### **Veprimtaritë e propozuara:**

1. Vozitet biçikleta. Në oborrin e shkollës shënohet korsa me gjatësi 10 metra. Matet me kronometër koha në të cilën nxënësit e përshkojnë korsinë dhe kjo kohë shënohet. Nxënësit nxirren pastaj në një vend me pjerrësi të butë. Përcaktohet fillimi dhe fundi i korsisë (10 m), poshtë së cilës do të zbresin fëmijët. Matet dhe shënohet koha.
2. Shkruhet në klasë në tabelë koha në të cilën e kanë përshkuar korsinë prej 10 m në korsinë e rrafshët dhe korsinë me pjerrësi të butë. Ku kanë lëvizur më shpejt nxënësit? Pse kanë lëvizur më shpejt?



- 
3. Nxënësit hartojnë pyetjet enigme dhe matin kohën. Kush e ka hartuar më parë dhe për sa kohë?
  4. Loja e stafetës. Nxënësit nxirren në oborrin e shkollës. Formohen dy grupe nxënësish. Përcaktohen rregullat e lojës. Të dyja grupet marrin stafetën. Vrapojnë rreth vendeve të shënuara që janë të baraslarguara nga grupet. Cili grup ka qenë më i shpejtë? Nxënësit komentojnë se pse kanë qenë më të shpejtë. A e ka shkaktuar humbjen mungesa e shkathtësisë apo mosrespektimi i rregullave? Si mund të bëhet ndreqja?
  5. Nxënësit sjellin në shkollë orë (sahatë) të ndryshëm: orë zgjimi, orë dore, orë xhepi, orë digjitale, orë rëre. Nga se ngjasojnë? Nga se dallohen? Në ç'drejtim lëvizin akrepat?
  6. Ndërtohet mulliri me ujë? Nevojitet një tapë e madhe dhe lugëzat e akulloreve. Në tapë ngulim lugëzat e akulloreve. Nëpër tapë futim tej përtej një shkop prej druri (si boshti për lëvizje). Në skajet e shkopit ngulen gozhdët e vogla, me qëllim që shkopi të mos bjerë gjatë rrotullimit. Ngulen në tokë dy degë që kanë formën e bigëzave. Vendoset mulliri i vogël në bigëza dhe merret zorra e ujit ose kova e vogël me ujë. Mulliri vihet në lëvizje me anë të ujit. Çfarë ndodh kur shtojmë currilin i ujit? Çfarë ndodh kur e pakësojmë currilin e ujit? Si do ta ndryshojmë kahun e rrotullimit të mullirit? Kur lëviz mulliri në drejtimin e lëvizjes së akrepave të sahatit? Kur lëviz në drejtim të kundërt? Çfarë ka ndikuar në vënien në lëvizje të mullirit?
  7. Ndërtohet sahati prej rëre. Nevojiten dy shishe plastike të vogla. Në njërën shishe fusim rërë. Tapat e shisheve i ngjirim njëra me tjetrën nga ana e sipërme. Me një gozhdë të nxehtë shpojme vrimën, në mënyrë që rëra të mund të rrjedhë. Bashkohen shishet që të qëndrojnë njëra mbi tjetrën. Me këtë "orë" mund të maten veprimtaritë e shkurtra që zhvillohen në klasë.

### **Puna me Tekstin mësimor:**


Bisedohet për mënyrat e matjes së kohës. Si është matur dikur koha? (Me ndihmën e orës me rërë, me anë të shkopinjve; të hijes.) Çfarë orësh (sahatësh) kanë nxënësit në shtëpi? A kanë vetë nxënësit orë dore? Përshkruhet ora e dorës. Çfarë tregon fusha e orës? Kur përdoret kronometri? Lexohet teksti i shkruar.

Shihen fotografitë. Çfarë tregon akrepi i madh dhe çfarë tregon akrepi i vogël i sahatit? Krahasohen lëvizjet e akrepave. Lexohet koha që tregohet në fushat e orëve.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Shënojnë në sahatë kohën a orën kur zgjohen, kur shkojnë në shkollë, kur hanë drekën...
2. Veturat lodra lëshohen poshtë tri rrafshëve. Cila prej veturave lodër ka përshkuar distancën më të madhe? Nxënësit shpjegojnë dhe shkruajnë arsyen se pse ka ndodhur kështu?
3. Lexohet grafiku dhe shkruhet se kush e hartuar më ngadalë dhe më shpejt gjëgjëzën?

**Mjetet ndihmëse:** orë të ndryshme (ora e dorës me akrepa, ora e zgjimit, ora digjitale, kronometri), tapa e shishes, lugëzat e akulloreve, shkopi, gozhdë, shishet plastike, rëra



# KU JETOJNË?

Kapitulli **Ku jetojnë** përmban 5 tema mësimi: *Nën hijen e lisit, Banorët e pyllit, Lindja dhe Perëndimi, Gjithnjë e më pak ka prej tyre, Në breg të detit.*


**Qëllimet:** të njohin e të dallojnë nxënësit disa bimë të ngrënshme e të pangrënshme dhe disa bimë mjekësore; të nxjerrin përfundimin për lidhjen midis gjallesave të ndryshme e habitateve të tyre; të zgjerojnë njohuritë për mënyrat sesi rrezikohet natyra dhe të shpjegojnë sesi ndikojnë njerëzit ndaj ndryshimeve në natyrë, të zhvillojnë vetëdijen ekologjike; të njohin ujërat e ndenjura dhe jetën në to, të përcaktojnë nocionet që kanë të bëjnë me orientimin në natyrë, të dinë më shumë për jetën bimore e shtazore të detit.

Nxënësit kanë mësuar të dallojnë drurët gjetherënës dhe drurët gjethembajtës. Në pyll rriten edhe bimët barishtore, kurse në skaj të pyllit mund të shihen gëmushat. Mbretëri në vete bëjnë kërpudhat. Edhe pse të gjitha kërpudhat mund të mos jenë kërpudha të zakonshme me trup e më kësulë, në orën e mësimi do të flitet për kërpudhat e pyllit. Ato nuk mund ta prodhojnë ushqimin, përkatësisht nuk e kryejnë fotosintezën), sepse nuk e kanë pigmentin e gjelbër (klorofilin). Kërpudhat janë saprofitet që shpërbëjnë mbeturinat e organizmave të ngordhur. Në këtë mënyrë marrin pjesë në çarkullimin e materies në natyrë. Kërpudhat mund të jenë të ngrënshme ose të pangrënshme (helmuese). Nxënësve u tërhiqet vëmendja se është shumë e rëndësishme që të dinë të tregojnë kujdes për konsumimin e sigurt e të duhur të llojeve të ndryshme të kërpudhave, të bimëve e të çajeve (kërpudhat helmuese, drekëza (lerthi i Shëngjergjit), urthi, shpendra ..).

Disa bimë kapen me rrënjë pas trungut të drurëve dhe pas bazamenteve të tjera (shkëmbinjve, mureve). Nxënësit thonë shembuj të bimëve të tilla. Urthi është një nga bimët më të njohura kacavarëse dhe mund të shihet relativisht shpesh. Fryt i tij janë boblat e zeza që janë helmuese. Jo të gjitha bimët kanë lule. Myshqet dhe fieret nuk kanë lule, por shumohen me spore. Myshqet dhe fieret gjenden në vendet e lagështa, sepse lagështia u duhet për shumim.

Bota e gjallë e pyllit është e renditur në kate, kështu që dallohet kati i kurorave, kati i kaçubave dhe i shkurreve të ulëta, kati i bimëve barishtore dhe kati përdhes. Në këtë mënyrë të gjithë organizmat shfrytëzojnë kushtet përkatëse për jetesë.

Livadhi është bashkësia jetësore e bimëve barishtore shumëvjeçare. Më shumë ka barëra, por në livadh rriten edhe shumë bimë mjekësore: lule pezmi, lule balsami (lule gjaku ose balçi), lulequmështorja, zhumbriça, sanëza... Për t'i përdorur siç duhet bimët mjekësore, duhet të mësohet për to (koha e lulëzimit, koha e këputjes, cila pjesë e bimës përdoret, mënyra e tharjes, mënyra e magazinimit, përdorimi siç duhet). Në livadh, përveç bimëve, jetojnë edhe insektet e shumta (karkalecat, gjinkallat, bletët, mollëkuqet, fluturat, milingonat) dhe kafshët e tjera (miu i bardhë, miu i fushës). Në tokë jetojnë krimbat e shiut, urithët... Disa bimë e kafshë jetojnë në gurishte. Në Mesdhe, në vendin e pyjeve të dikurshme, tani shtrihen bashkësitë e gëmushave (shiblakëve) me drurë të rrallë; shkorretet (makija). Makija është shumë e përhapur në jug të Malit të Zi. Ky vegjetacion është vështirë i depërtueshëm, ndërsa është krijuar nga degradimi i pyjeve. Shiblaku është bashkësia e rrallë gjethefortë, që krijohet nga degradimi i makijes.



Ajo përbëhet nga kaçubet e shumta. Me degradimin e mëtejshëm krijohet zona gurore (shkëmbore); ekosistemi që është karakteristik për mjedisin e vendit tonë. Në këto vise të thata shkëmbore jetojnë bimët dhe kafshët që përballojnë mirë thatësinë.


Krahas bimëve në pyll jetojnë edhe kafshët e ndryshme. Ashtu sikurse edhe qenieve të tjera të gjalla, edhe kafshëve u nevojitet për ekzistencë ushqimi, drita, ajri dhe drita. Në çdo kat të pyllit qëndrojnë llojet e ndryshme të kafshëve. Disa gjenden në të gjitha katet (ketri). Nëpër degë lëvizin insektet, merimangat, disa zogj ... Nëpër tokë lëvizin kaprojtë (sorkadhet), dhelprat, iriqët etj. Brenda në tokë jeton një numër i madh kafshësh të imta, të cilat parapëlqejnë kushtet me errësirë dhe me lagështirë. Kafshët i përshtaten mjedisit ku jetojnë me formën dhe me ngjyrën e trupit, me mënyrën e të ushqyerit ... Sipas mënyrës së të ushqyerit kafshët ndahen në: bimëngrënëse (dreri, sorkadhja, lepuri), në mishngrënëse (dhelpra, ujku, gjarpri, rrëqebulli), në gjithçka ngrënëse (ariu, derri i egër). Bashkësitë e kafshëve dhe të bimëve të pyllit janë në lidhje reciproke. Në pyll, si një sistem i madh ekologjik, ndërthuren zinxhirët e ndryshëm të të ushqyerit.

Vitin e kaluar shkollor nxënësit kanë mësuar për ndërrimin ditë dhe natë, kurse në klasën e tretë mësojnë se dielli vetëm në mënyrë imagjinare del në lindje dhe perëndon në perëndim. Për përcaktimin e anëve të horizontit, nisemi nga pozicioni i diellit në qiell dhe përdorim hijen e sendeve. Dielli është në zenit në mesditë. Atëherë, hija është më e shkurtër dhe në drejtim të Veriut. Nëse në mesditë kthehemi me fytyrë nga dielli, atëherë shohim drejt Jugut, ndërsa pas nesh është Veriu, majtas është Lindja, kurse djathtas është Perëndimi. Nxënësve u tërhiqet vëmendja se gjatë vrojtimit (shikimit) nuk duhet ta shikojnë drejtpërdrejt diellin. Për orientim mund të shërbejë edhe pozicioni i hijes në mesditë. Zakonisht nisemi nga Veriu. Përveç se sipas lëvizjes imagjinare të diellit dhe pozicionit të hijes në mesditë, Veriu mund të përcaktohet edhe më anë të myshkut, i cili gjendet në të shumtën e rasteve në anën veriore të drurëve (sepse në atë anë ka më shumë lagështi). Busulla gjithashtu na tregon Veriun, kurse në hartat gjeografike Veriu është gjithmonë lart. Anët e horizontit na ndihmojnë që të orientohemi në hapësirë.

Nëse mjedisi është i njohur, nuk është e domosdoshme njohja e pikave orientuese, por mund të orientohemi në hapësirë me anë të objekteve të njohura. Ndërkohë, në mjedisin e panjohur ku nuk ka pika orientuese nevojitet busulla. Njohja e anëve kryesore të horizontit ndihmon shumë për orientimin në qendrat e mëdha të banimit, ku lagjet dhe pjesët e qytetit janë të përcaktuara shpesh sipas anëve të horizontit. Në këtë mënyrë mund të supozohet sesi, duke u nisur nga një pjesë e qytetit, do të arrijmë në një pjesë tjetër në anën tjetër të botës. Veçmas do të bisedohet me nxënësit për hijet, për të cilat ata kanë tashmë një farë përvoja, por edhe më tej problem përfaqëson paraqitja e raportit midis vendit të objekti dhe burimit të dritës, në mënyrë që të krijohet hija. Pozicioni dhe gjatësia e hijes ndryshon gjatë ditës, por edhe sipas stinëve të vitit. Në mëngjes hija është më e gjatë dhe është e drejtuar nga Perëndimi, ndërsa në mesditë është më e shkurtër dhe është e drejtuar nga Veriu. Hija është më e qartë, nëse moti është i kthjellët dhe me diell.

Për problemin e ndotjes së mjedisit përreth dhe për ndryshimet në natyrë është bërë fjalë në kapitujt e mëparshëm dhe në mësimet e vitit të kaluar shkollor. Gjatë periudhave të gjata të ndryshme të zhvillimit në natyrë kanë ndodhur ndryshime të shumta; janë zhdukur dhe kanë lindur lloje të ndryshme bimësh e kafshësh. Disa lloje në përbërje të botës së gjallë kanë mbijetuar dhe ekzistojnë edhe sot.

Ndryshimet kanë lindur si pasojë e ndodhive (ndryshimeve) ciklike në natyrë. Por, me zhvillimin e qytetërimit, kushtet e jetesës kanë ndryshuar në një masë të madhe nën ndikimin e veprimtarive të njeriut. Janë asgjësuar disa habitate, janë zhdukur disa lloje bimore e shtazore, janë ndotur ujërat ... . Kërcënon rreziku se në të ardhmen do të




ndodhin ndryshimet që mund t'i rrezikojnë kushtet e jetës dhe raportet e përgjithshme në biosferë; ndotja e ujit dhe e tokës, rrezikimi i habitateve, futja e llojeve të tjera në ekosistem... Për këtë arsye, gjithnjë e më shumë po theksohet nevoja për një qëndrim aktiv e të përgjegjshëm të njeriut ndaj mjedisit jetësor, kështu që nxënësve do t'u sugjerohet se ka rëndësi të njohin fushat e rrezikuara të mjedisit jetësor, në mënyrë që mbrojtja e tyre të jetë sa më efikase.

Në kapitullin e mëparshëm është folur për rëndësinë e ujit, d.m.th. për lumenjtë dhe për liqenet, kurse në këtë kapitull vazhdohet njohja me detin. Bëhet dallimi midis fundit të detit (tabanit) dhe ujit të lirë. Në det jetojnë bashkësi (koloni) gjallesash të ndryshme. Në pjesën e ujit të lirë dallojmë zonën e bregut të detit, e cila përfshin thellësinë deri në 200 m. Kjo pjesë quhet edhe zona e dritës, për arsye se rrezet e diellit depërtojnë deri në thellësinë e 200 m. Në brigjet dhe në vendet ku nga deti ngrihen shkëmbinj të lartë ose të ulët, dallgët godasin fuqishëm bregun. Në këto zona jetojnë organizmat e ndryshëm. Ata janë të mbërthyer fort pas bazamentit që të mos i marrin goditjet e fuqishme të dallgëve, ndërsa trupin e kanë të përshtatur që të mund të mbijetojnë për një kohë të shkurtër edhe në mjedisin me ajër (kërmijtë, gaforret, algat e murrme, molusqet). Për këtë arsye, kjo zonë e detit konsiderohet si mjedisi i papërshtatshëm për jetesë. Edhe zona e baticës dhe e zbaticës, për shkak të tërheqjes së ujit, është e papërshtatshme për jetesë. Në periudhën e zbaticës nuk ka ujë, drita e diellit dhe koncentrimi i kripës është i madh, ndërsa temperatura është e lartë.

Disa organizma jetojnë në hapësira të kufizuara në Tokë. Këto janë endemet. Alga e murrme e Adriatikut është lloj endemik i detit Adriatik. Trupi i algës së murrme është degëzuar, ndërsa në majë të çdo dege gjendet një fshikëz e mbushur me ajër. Midhja është guaska e njohur e shijshme që kultivohet në shumë vendkultivime në bregdet dhe që jeton në shkëmbinj. Kërmilli bobla e ujit e ka guaskën që nuk është e përdredhur, por është në formë kupe. Bobla e ujit është e mbërthyer pas bazamentit shkëmbor dhe ushqehet me alga. Oktapodi e ka trupin të butë dhe mund të rritet deri në 2 m (distanca nga njëra këmbëz tek tjetra). Oktapodi është grabitqar i madh. Gjatë ditës fshihet nëpër guvat e shkëmbinjve nënujorë, kurse natën del dhe gjuan gjahun e vet. Në shkëmbinj mund të shihen iriqët e detit. Në afërsi të bregut të detit, në fundin e detit, jeton edhe ylli i detit. Edhe ai është grabitqar i madh, kurse gojën e ka në pjesën e poshtme të trupit dhe lëviz me ndihmën e sistemit të veçantë ujqor. Më shpesh ushqehet me kërmij dhe me guaska, ndërsa mund t'i rrezikojë vendkultivimet e guaskave. Është interesante se nëse kapet ai e shkëput vetë krahun dhe e rigjeneron atë. Peshku shkerpi i kuq jeton në pjesën e cekët të detit. Me ngjyrën e vet ai i përshtatet mjedisit.

Në dete derdhen lumenjtë, të cilët janë shpesh të ndotur dhe i rrezikojnë ekosistemet detare. Materiet e dëmshme arrijnë në lumenj me ujërat industriale e të kanalizimeve, si edhe nga sipërfaqet e punuara të mbushura me insekticide, me pesticide dhe me plehra kimike. Ujërat e ndotura rrezikojnë ekzistencën e botës bimore dhe shtazore në lumenj dhe në dete. Deteve lundrojnë anijet e udhëtarëve e të transportit, të cilët e ndotin ujin e detit. Rrezik të veçantë për botën e gjallë të detit, përfaqësojnë tankerat, të cilët në kuadër të avarive mund ta derdhen naftën, gjë që vepron në mënyrë asgjësuese ndaj bimëve dhe ndaj kafshëve. Materiet e dëmshme në det mund të jenë të rrezikshme edhe për ata që lahen. Sidomos të rrezikshme janë materiet kimike në ujë.




## NËN HIJEN E LISIT

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen bimët karakteristike të vendbanimit</li><li>• të vihet re lidhja e bimëve me habitatet e tyre</li><li>• të vihet re lidhja ndërmjet bimëve dhe kafshëve</li><li>• të dallohen bimët gjetherënëse dhe gjethembajtëse</li><li>• të dallohen bimët ngrënëse dhe jo ngrënëse</li><li>• të njihen disa nga bimët mjekësore të vendbanimit</li><li>• të zhvillohet vetëdija ekologjike</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	bima vetëmbirëse, dru (pemë), trung, lëvore, kurora e drurit (pemës), kaçubishte, bimë livadhi, bimë mjekësore, bimë kacavarëse, shiblak, vend shkëmbor, shkurre

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Organizohet ekskursioni në pyllin më të afërt. Vrojtohen drurët, shkurret dhe bimët e tjera. Emërtohen drurët që njihen. Përshkruhet pamja e tyre. Krahasohet lartësia e drurëve, pamja dhe lartësia e trungjeve, pamja e lëvres, madhësia dhe forma e kurorës, si edhe format e gjetheve. Klasifikohen drurët e vëzhguar në ato gjethembajtëse dhe gjetherënëse. Nxirret përfundimi, pse quhen kështu. Vihet re, se ç'loj drurësh ka më shumë. Vihet re pozicioni i boçave tek drurët e ndryshëm halorë (janë të drejtuara lart apo poshtë; janë të hapura/të mbyllura). Krahasohen kaçubet me drurët; a është më e lartë kaçuba apo druri, prej nga rriten (fillojnë) degët e kaçubës dhe prej nga degët e drurit. Me ndihmën e mësuesit emërtohet ndonjë kaçube. Vihen re edhe banorët e tjerë të pyllit (në drurë dhe poshtë drurit). Kush i ka mbjellë drurët dhe bimët e tjera të pyllit. Nxirret përfundimi, se drurët në pyll kanë mbirë vetë, prandaj edhe quhen drurë vetëmbirës.
2. Nxënësit gërmojnë më një lopatë të vogël gjethet dhe shohin kafshët që jetojnë aty. Komentojnë pamjen e kafshëve të vockla që kanë vënë re dhe emërtojnë disa prej tyre.
3. Krahasojnë degët e vogla të drurëve të ndryshëm halorë. Vërejnë ngjashmëritë (të gjitha gjethet janë të forta ose më të imta se gjethet e drurëve gjethorë) dhe ndryshimet midis tyre (disa gjethet halore janë në formë gjilpëre e të shpojnë, kurse disa janë shpatuke e nuk të shpojnë).
4. Gjejnë dhe vrojtajnë myshket. Në cilën anë të drurit ka më shumë myshk? Shkëputin pak myshk. Në klasë e matin peshën e myshkut të sapo këputur. E lënë atë që të thahet. Pas një farë kohe e matin përsëri peshën e myshkut. Ç'përfundim nxirret?
5. Nxënësit gjejnë fierin. Shohin gjethet e fierit. Çfarë gjendet në anën e poshtme të gjetheve të fierit? Mbi disa gjethet vërejnë pikat e vogla të zeza. Supozohet se çfarë do të zhvillohet prej tyre.
6. Nxënësit kërkojnë një trung të rrëzuar dhe supozojnë pse po dekompozohet. A ka në trung ndonjë kafshë? Emërtojnë ato që njohin.
7. Vrojtohen llojet e ndryshme të kërpudhave. Shihen anët e poshtme të ombrellave dhe i krahasojnë ato.
8. Ndërtohet stenda e klasës e pyllit me kaçube, me barishte dhe me kërpudha. Stenda mund të plotësohet me frytet e bimëve.
9. Grumbullohen e thahen gjethet dhe përgatitet me to koleksioni i klasës.



10. Punohet me gjilpëra me krye dhe me spango rrjeta e merimangës në një pllakë stiropori.
11. Shihet filmi për koloninë e kafshëve të pyllit. Tema mund të jetë pyllëzimi i një terreni të zhveshur ose rrezikimi i pyllit (prerja pa plan, zjarri).
12. Organizohet ekskursioni në livadh dhe emërtohen bimët që njihen. Krahasohen disa bimë të livadhit me bimët e pyllit. Çfarë bimësh nuk ka në livadh, por që janë parë në pyll? Thuhen ndryshimet ndërmjet pamjes së drurëve dhe pamjes së bimëve të livadhit. Kush i ka mbjellë bimët në livadh? Nxirret përfundimi, se edhe bimët e livadhit janë vetëmbirëse. Cila është bima më e përhapur e livadheve?
13. Shihen dhe emërtohen kafshët e njohura të livadhit. Ç'kafshë ka më shumë? (Insekte.) Kush i tërheq ato dhe me se? A kanë dobi bimët prej insekteve? Cilat insekte jetojnë në tokë? Cilat kafshë jetojnë nën tokë? Gjenden në tokë vrimat që dëshmojnë për këtë gjë (vrime e miut të fushës, kanali i urithit, vrima e milingonave).
14. Thahen bimët e livadhit dhe përgatitet herbariumi.
15. Bisedohet për përdorimin e bimëve mjekësore. Tregohet për atë, sesi e kanë fituar emërtimin bimët barishtore: bar pezmi ose bar lunge. Nxënësit emërtojnë bimët mjekësore që përdoren në shtëpitë e tyre. Pyesin për kohën më të përshtatshme për këputjen e bimëve mjekësore. Supozohet se pse është më mirë që ato të këputen para se të bjerë shiu. Si ruhen bimët mjekësore (në qese prej letre ose në ambalazhe prej qelqi). Pse nuk rekomandohet këputja e bimëve mjekësore që rriten pranë rrugës? Sa kohë pas këputjes mund të përdoren bimët mjekësore?
16. Këputen dhe thahen bimët mjekësore.
17. Bisedohet për bimët që përdoren në shtëpi si erëza. Ç'erëza u pëlqejnë nxënësve? Pyetet se prej cilës pjesë të bimës përftohet kjo erëz.
18. Lexohen kuriozitete për bashkësinë e bimëve të pyllit, të livadhit e të gurishtës (zallishtës).

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë e pjesëtarëve të bashkësisë (kolonisë) së pyllit dhe lexohet ajo që shkruhet për to. Cilat bimë dhe kafshë kanë parë në pyll, ndërsa nuk janë midis atyre që janë të paraqitura në libër? Thonë njohuritë e veta për bimën ose për kafshën.

Cilat bimë kanë parë në livadh, ndërsa nuk janë midis atyre që janë paraqitur? Lexohen tekstet e shkruara pranë vizatimeve e fotografive.


Çfarë bashkësie (kolonie) është gurishtja (zallishtja)? Pse quhet kështu? Ç'bimë rriten në të? Cilat kafshë jetojnë në gurishtë (zallishtë)? Nxënësit thonë atë që dinë për këto bimë dhe për këto kafshë.

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nga Shtojca nr. 4 priten figurat ilustruese dhe ngjiten në vendet boshe të caktuara.
2. Shihet dhe vizatohet: kërpudha, fieri dhe lulja qumështore dhe pastaj krahasohen. A kanë të gjitha ato gjethe, rrënjë, kërcell dhe lule? Ç'ngjyrë kanë? Ku rriten? A i nevojitet secilës drita dhe uji.
3. Shënojnë sipas udhëzimit përgjigjet e sakta.
4. Nxënësit mësojnë dhe përshkruajnë se nga ç'gjë dallohen grethi dhe bleta.
5. Zgjidhet rebusi (livadhi, pylli).

**Mjetet ndihmëse:** gjilpërat me kokë, peri, stiropori






# BANORËT E PYLLIT

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të njihen kafshët shtëpiake të vendbanimit</li><li>• të lidhen kafshët dhe habitatet e tyre</li><li>• të dallohen kafshët shtëpiake dhe kafshët e egra</li><li>• të dallohen lidhjet reciproke midis qenieve të gjalla</li><li>• të arrihet në përfundimin se bimët janë ushqim për kafshët dhe se disa kafshë janë mishngrënëse</li><li>• të vërehen kushtet e jetesës së kafshëve</li><li>• të vihet re se veprimtaritë e kafshëve ndryshojnë në varësi të stinëve të vitit</li><li>• të vihet re se të gjitha qenieve të gjalla u duhet për jetesë: ushqimi, uji dhe ajri, si edhe u nevojitet mjedisi i shëndetshëm dhe i pa ndotur</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	kafshë pylli, kafshë e egër, bimëngrënëse, mishngrënëse, gjithçkangrënëse, grabitqar, strofull, rojtar i gjuetisë.

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit nxirren në ekskursion në pyllin më të afërt. Dallohet përbërja e pyllit (gjethembajtës, gjetherënës, i përzier) dhe banorët e tij. Emërtohen kafshët që jetojnë nën tokë, mbi tokë dhe në drurë. Supozohet se kush jeton lart në kurotat e drurëve.
2. Bëhet paraqitja tabelare e kafshëve që janë vënë re. Klasifikohen ato sipas vendit/katit ku janë vënë re; brenda mbi tokë, në tokë, në drurë. Krahasohen kafshët sipas pamjes së jashtme, sipas lëvizjes dhe sipas zërit që lëshojnë.
3. Shihet filmi për kafshët e pyllit dhe nxirret përfundimi se cilat prej tyre jetojnë në mjedisin përreth.
4. Grumbullohen fotografi dhe kuriozitete të shkurtra për kafshët e egra dhe përgatitet me to stenda e klasës. Klasifikohen kafshët në bimëngrënëse, në mishngrënëse dhe në gjithçkangrënëse. Me fotografitë e grumbulluara ndërtohet zinxhiri i të ushqyerit.
5. Në grupe studiohet një kafshë e egër e caktuar. Për këtë sigurohet materiali i nevojshëm informativ (enciklopeditë, revistat, tekstet e zgjedhura), ose jepet udhëzimi sesi mund të gjenden këto informata. Pason raportimi i kryesuesve të grupeve.
6. Bisedohet për ndikimin e njeriut mbi jetën e kafshëve të egra. Nxënësit propozojnë se në ç'mënyrë mund t'u ndihmojnë ata vetë kafshëve të pyllit.
7. Në orët e mësimit të Kulturës së artit figurativ punohen statujat e kafshëve që pëlqehen më shumë. Punohen maskat prej kartoni me fytyrën e kafshëve të egra.
8. Organizohet loja me role e një përralle të dramatizuar.
9. Loja me pantomimë; një nxënës imiton lëvizjen e një kafshe të egër, ndërsa nxënësi që e gjen se për ç'kafshë është fjala, fiton të drejtën që ta luajë rolin me pantomimë.
10. Dëgjohen këngët e ndryshme për kafshët e egra.
11. Nxënësit që e kanë vizituar kopshtin zoologjik, tregojnë për kafshët që kanë parë atje. Ku janë të strehuara, me se ushqehen dhe kush i ushqen ata? Bisedohet për sjelljen e vizitorëve dhe tregohet pse është e rrezikshme të preken kafshët e kopshtit zoologjik.
12. Hartohen tekste të shkurtra për kafshët e egra që pëlqehen.





### Puna me Tekstin mësimor:

Shihen banorët e pyllit. Emërtohen ato. Bisedohet për kafshët: me çfarë e kanë të mbuluar trupin, emërtohen pjesët e trupit, thuhet ajo që dihet tashmë për çdo kafshë, a e kanë parë kafshën në fjalë, ku e kanë parë? Lexohet teksti i shkruar pranë çdo kafshe. Dallohen bimëngrënësit, mishngrënësit dhe gjithçkangrënësit. Cilat prej tyre çelin zogj dhe cilat pjellin të vegjëlit? Cilat kafshë bëjnë gjumin e dimrit? Ku e bëjnë gjumin e dimrit? Kush ua përgatit strofullat? Si e kalojnë dimrin kafshët e tjera? Prej ç'kafshëve duhet të frikësohemi? Pse? Cilat kafshë jetojnë në grupe? Si quhen grupet e tyre (tufë, kope)? Pse jetojnë në grup? Kafshët e pyllit lëvizin shpesh natën. Pse? Cilat shqisa i kanë të zhvilluara? Pse pikërisht këto shqisa? Cila kafshë është më shpesh viktimë e kafshëve të tjera? Pse? Cila prej këtyre kafshëve nuk ka këmbë? Si lëviz? Ku fshihet? Kur është më e rrezikshme? Si mbrohet? Cilat prej kafshëve në figura vizitojnë më shpesh fshatrat dhe kur? Si i quajmë ato atëherë (dëmtues)? Cilat insekte jetojnë në pyll? Kush është armiku i kafshëve të egra? Pse i gjuajnë njerëzit kafshët egra? Kur lindin më shpesh të vegjëlit? Kush kujdeset për to? Të vegjëlit e kujt lindin në dimër? Kush kujdeset për kafshët e pyllit dhe në ç'mënyrë kujdeset?

### Puna me Fletoren e punës:


1. Njohin kafshën dhe shënojnë sesi ushqehet dhe është aktive gjatë dimrit. Në etiketat boshe vizatohet kafsha që zgjedh nxënësi dhe shënohet njëllëj si tek kafshët e tjera.
2. Rrumbullakoset PO ose JO.
3. Zgjidhet asocimi. Zgjidhja e rubrikave: lepuri, kandrra e drurit, iriqi dhe gjarpri.
4. Shënohet me shigjetë se me çfarë ushqehet secili.

## LINDJA DHE PERËNDIMI

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihet re se dielli lind në Lindje dhe perëndon në Perëndim</li> <li>• të emërtohen objektet karakteristike në Lindje dhe në Perëndim në raport me shkollën</li> <li>• të përcaktohet Lindja dhe Perëndimi në raport me shtëpinë/banesën ku jetohet.</li> <li>• të përcaktohet pozicioni i shtëpisë/banesës së vet në vendbanim</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	Lindje, Perëndim, Veri, Jug, hije, myshk, busull, orientim në hapësirë

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit vrojtojnë tek shtëpitë e veta lindjen dhe perëndimin e diellit. Vënë re objektet që ndodhen në lindje dhe në perëndim të shtëpisë së tyre. Informojnë në



klasë se ç'objekte kanë vënë re.


2. Në një ditë të kthjellët me diell, nxënësit nxirren në oborrin e shkollës në mesditë. Kthehen me fytyrë nga dielli. Në këtë mënyrë kanë përcaktuar Jugun. Pas kurrizit të tyre është Veriu, kurse hija e tyre shtrihet në drejtim të Veriut. Djathtas kanë Perëndimin, ndërsa majtas kanë Lindjen. Vizatojnë me shigjeta në rërë ose me shkumës në poligon anët e përcaktuara të horizontit. Nxjerrin përfundimin se Lindja dhe Perëndimi janë anë të kundërta, sikurse janë edhe Veriu dhe Jugu. (Nëse Lindja është në anën e tyre të majtë, Perëndimi është në anën e tyre të djathtë dhe anasjelltas.)
3. Përcaktohen në klasë me anë të busullës anët kryesore të horizontit. Sendeve të klasës u përcaktohet pozicionin sipas anëve të horizontit.
4. Vizatohen sendet e klasës (dërrasa e zezë, dritaret, dera, rafti, etazhetë për libra) dhe përcaktohet pozicioni i tyre sipas anëve të horizontit në vizatim.
5. Përcaktohet pozicioni i klasës dhe i ambienteve të tjera të shkollës në raport me anët e horizontit.
6. Nga oborri i shkollës përcaktohen objektet që ndodhen në afërsi të shkollës dhe përcaktohet se në ç'anë të horizontit në raport me shkollën gjenden ato.
7. Vizatohen në klasë objektet në raport me shkollën (sipas anëve të horizontit).
8. Nxënësit shkojnë së bashku me mësuesin në kodrën pranë më të lartë dhe ndahen në katër grupe. Detyra e grupeve është që nga vende të ndryshme (nga rrëza, nga dy anët dhe nga maja) ta vrojtojnë mjedisin përreth dhe të shkruajnë objektet karakteristike të mjedisit natyror dhe shoqëror që shohin. Takohen në majë të kodrës dhe raportojnë. Vihet re se më shumë ka parë grupi në majë të kodrës, më pak grupi në rrëzë të saj, ndërsa grupet nga anët e ndryshme të kodrës kanë parë objekte të ndryshme. Nxirret përfundimi, se ajo që shohim varet nga vendi prej të cilit vrojtojmë. Nga maja e kodrës përcaktohen anët e horizontit dhe, nëse është e mundur, pozicioni i shkollës dhe i shtëpisë në raport me kodrën prej së cilës vrojtohet.
9. Në klasë vizatohen në stendë objektet karakteristike në raport me kodrën.
10. Në relievin e klasës, përcaktohen anët e horizontit në raport me qendrën e vendbanimit (duke veçuar Lindjen dhe Perëndimin) dhe pozicioni i objekteve gjeografike. Çdo nxënës gjen në relief pozicionin e vendbanimit e të shkollës së vet në raport me qendrën.
11. Grumbullohen fotografi dhe kartolina me pamje nga lindja dhe perëndimi i diellit.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihet vizatimi, analizohet ai dhe vihen re objektet që gjenden lart, poshtë, majtas dhe djathtas në raport me vogëlushin. Lexohen dhe komentohen shenjat në anë dhe përcaktohen anët e horizontit të objekteve të paraqitura. Ku ndodhet në vizatim Lindja? Cila anë e horizontit është përballë Lindjes? Ç'anë të tjera të horizontit janë paraqitur? Në cilën anë lind dhe në cilën anë perëndon dielli? Cilat objekte janë në lindje, në perëndim, në veri dhe në jug të vogëlushit? Në ç'mënyra të tjera mund t'i përcaktohen akoma anët e horizontit në natyrë?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nga Shtojca nr. 5 priten dhe ngjiten vizatimet sipas udhëzimit.
2. Shkruhen objektet e mjedisit natyror dhe shoqëror që nxënësit kanë vënë re në Lindje dhe në Perëndim të shtëpisë (apartamentit) të vet.



3. Përsëritet më nxënësit mënyra e përcaktimit të anëve të horizontit. Nëse kthehemi më fytyrë nga Veriu, prapa nesh është Jugu, djathtas është Lindja, kurse majtas është Perëndimi. Sipas pozicionit të myshkut përcaktohet në raport me drurin ana e Veriut, pastaj e Jugut, e Lindjes dhe e Perëndimit (Veriu para, Jugu prapa, Lindja djathtas dhe Perëndimi majtas drurit).


**Mjetet ndihmëse:** busulla

## GJITHNJË E MË PAK KA PREJ TYRE


<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të bëhet lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatet e tyre</li><li>• të arrihet në përfundimin se qenieve të gjalla u nevojitet, ushqimi, uji dhe ajri, si edhe mjedisi i shëndetshëm dhe i pandotur</li><li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit ndaj ndryshimeve të natyrë në vendbanimin e vet</li><li>• të njihen nxënësit me problemet më të rëndësishme lidhur me ndotjen në vendbanimin e vet</li><li>• të vihet re lidhja reciproke midis qenieve të gjalla</li></ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	Iloji i rrezikuar, lloji i mbrojtur, gjuetia e ndaluar, gjuetari pa leje, llojet e rrezikuara shtazore e bimore, riciklimi

### Veprimtaritë e propozuara:

1. Bisedohet për bimët dhe kafshët që kanë njohur nxënësit në habitatet e ndryshme; në pyll, në park, në livadh, në gurishte (zallishte), në pemishte, në kopsht, në arë, në ujë... Pse jetojnë pikërisht aty? Me se ushqehen? Ku e gjejnë ushqimin? Si lëvizin? Çfarë do të ndodhte nëse një kafshë uji do të zhvendosej në një habitat tjetër që nuk është ujë ose po të zhvendosej një bimë livadhi në liqen? (Nxënësit bëjnë supozimet.) Nxirret përfundimi se bimët dhe kafshët janë të lidhura me habitatin, sepse në të gjejnë ushqimin dhe strehimin.
2. Bisedohet se ç'gjë tjetër, përveç ushqimit, u duhet për jetesë qenieve të gjalla. Bëhet eksperimenti me tuberin e patates që ka çelur sythe. Tuberi vihet në një kuti kartoni, në të cilën është çelur më parë një vrimë. Kutia mbyllet dhe vendoset në një vend me me dritë. Pas disa ditësh vihet re se nëpër vrimën e kutsisë ka dalë filizi i ri. Nxirret përfundimi se bima ka kërkuar dritën që të rritet. Çfarë do të ndodhë me bimën që nuk ka dritë? (Nxënësit bëjnë supozimet e veta.) Bisedohet për bimët që kultivohen në shtëpitë e nxënësve. Ku mbahen ato? Pse mbahen pranë dritareve?
3. Emërtohen bimët që janë parë në kopsht. Kur mbillen ato? Pse pikërisht në pranverë? Çfarë u nevojitet atyre që të rriten? (Duhet të lërohet e të plehërohet toka dhe të bëhet vaditja.) Çfarë do të ndodhë me bimën, nëse papritur bën ftohtë? A do të mbijë bima? Nëse bima do të jetë në serrë, ajo do të mbijë pavarësisht nga të ftohtit. Pse? Nxirret përfundimi se bimëve u nevojitet për jetesë dhe nxehtësia.



4. Nxënësit thonë atë që dinë për mbrojtjen e bimëve. Çfarë do të ndodhë nëse njeriu e tepron me përdorimin e kimikateve mbrojtëse? Bëhet eksperimenti me karafilin e bardhë dhe me bojë shkrimi. Në një enë qelqi zbrazin ujin dhe bojën e shkrimit. Kërcellin e karafilin e vendosin në tretësirën e ujit me bojë shkrimi. Të nesërmen do të vihet re, se karafili ka marrë ngjyrën e bojës së shkrimit. Në bazë të kësaj, nxirret përfundimi se për jetën e bimëve nevojitet uji, por edhe se materiet, që janë në të arrijnë deri tek vetë bima. Njeriu, përmes bimëve që përdor për ushqim, fut në organizëm materiet e dëmshme. Nxënësit japin shembuj që kanë njohur vetë.
5. Bisedohet për format më të shpeshta të ndotjes në vendbanimin e vet. Cilat habitate të bimëve e të kafshëve janë më shumë të rrezikuara? Kush i rrezikon ata? Në ç'mënyrë i rrezikon? Çfarë ndodh me mbetjet e ujit të fabrikave? Kë rrezikon ky ujë? Kë do të rrezikojë nafta që është derdhur nga anijet në det ose në liqen? Ku shkon tymi nga oxhaqet e fabrikave? Ku shkon tymi nga skapamentot e automobilave? Kë, përveç njerëzve, dëmton ky tym? Jepen shembujt nga mjedisi i vet përreth.
6. Ftohet në klasë roja e gjahut (nëse nuk ka mundësi që të ftohet roja e gjahut, ftohet roja e gjuetisë së peshkut). Bisedohet për rolin e rojes së gjahut. Kë ruan ai? Prej kujt ruan? Pse është e ndaluar gjuetia në periudha të caktuara të vitit? Ç'ndëshkime jepen për ata që nuk e respektojnë këtë gjë? Si quhen njerëzit që nuk i respektojnë ndalimet? Në cilën periudhë të vitit është e lejuar gjuetia dhe pse pikërisht atëherë? A mund të gjuajë kushdo? Çfarë duhet për gjuetinë e lejuar? Ku mund të merret leja? A ekzistojnë kafshët, gjuetia e të cilave është e ndaluar përgjithmonë? Cilat janë këto kafshë? Pse është e ndaluar gjuetia e tyre? Pse janë të rralla këto kafshë?
7. Ç'rregulla vlejnë për gjuetinë e peshkut? Në cilën periudhë të vitit është e ndaluar gjuetia e peshkut dhe pse pikërisht atëherë? Kur lejohet gjuetia e peshkut? A mund të peshkohen të gjitha llojet e peshqve? Cilët peshq nuk mund të peshkohen dhe pse? Në cilat liqene dhe lumenj ka më shumë peshk? Nga se varet cilësia e peshkut? Ku nuk peshkohet kurrë peshku dhe pse?
8. Kush tjetër, përveç gjuetarëve pa leje, është armik i kafshëve dhe i bimëve të pyllit? Kush i shkakton zjarret? Si mund ta shkaktojë zjarrin dielli me rrezet e veta? Kush ndihmon në këtë rast? (Njeriu hedh në pyll mbeturina, qelqe, kënaçe, ambalazhe prej letre rrezatuese, të cilat i thithin rrezet e diellit.) A mund të shkaktojë zjarrin vetëtima (shkrepëtima)? Si mund ta shkaktojë njeriu zjarrin me sjelljen e vet të papërgjegjshme? (Me hedhjen e bishtit të cigares, me ndezjen e zjarrit, me hedhjen e mbeturinave që thithin rrezet e diellit.) Çfarë dëmi u shkakton zjarri banorëve të pyllit? (Mbeten pa habitate, pa ushqim ose mund të digjen edhe nga vetë zjarri.)
9. Cili është roli i rojtarit të pyllit? (Cakton, se cili dru duhet të pritët dhe ku duhet të mbillet druri i ri.) Cilat janë dobitë e drurit? (Prodhon oksigjenin dhe lëndën e parë për orendi, për ngrohje, për letër ... ) Çfarë do të ndodhë nëse njeriu i pret në mënyrë të pakontrolluar drurët? (Banorët e pyllit humbasin ushqimin dhe habitatin.)
10. Lexohen kuriozitetet për dobitë e drurit dhe për dëmet që shkakton prerja vetëm e një druri.
11. Lexohet tregimi *Si e shpëtoi drurin lepuri* (Stanka Brdar). Bisedohet për tregimin, për banorët e lisit dhe për rreziqet që i kërcënojnë në çdo hap. Kush qëndron pas gjithë kësaj? Si e rrezikon njeriu lisin, banorët e tij, të gjithë pyllin dhe, bashkë me të gjitha këto, edhe vetveten?
12. Grumbullohen sendet në të cilat është shenja e riciklimit. Çfarë tregon kjo shenjë?
13. Si mund ta shpëtojnë nxënësit drurin? Lexohet receta për punimin e letrës dhe kryhet në klasë riciklimi i letrës.
14. Lexohet në enciklopedi për llojet e kafshëve dhe të bimëve të zhdukura, si edhe për



ato që rrezikohen të zhduken. Kush i rrezikon ata më shumë dhe si? Ftohen në klasë përfaqësuesit e lëvizjeve ekologjike dhe bisedohet për mënyrat sesi i mbrojnë ata llojet e rrezikuara të kafshëve e të bimëve. A mund të jenë nxënësit anëtarë të këtyre lëvizjeve? Si bëhesh anëtar i lëvizjes ekologjike?

15. Nxënësit përgatitin distinktiva (prej kartoni dhe gjilpërash kapëse) për lëvizje të ndryshme ekologjike.
16. Me qese prej letre bëhen maska të ndryshme. Në pjesën e përparme të qeseve vizatohen dhe priten tri vrima (për sytë dhe gojën). Në cepat e sipërm të qeses vizatohen dhe priten veshët, të cilët ngjiten me zam. Në pjesën e përparme të qeses vizatohet koka e kafshës së zgjedhur, e cila ngjyroset. Prej një qeseje tjetër, presin disa pjesë në formë shiritash dhe i ngjiten në të dyja anët e maskës.
17. Nxënësit marrin pjesë në aksionet e grumbullimit të letrave të vjetra.


### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen fotografitë dhe lexohen tekstet e shkruara shoqëruese. Cilat nga bimët dhe kafshët e paraqitura janë parë në natyrë dhe ku i kanë parë ato? Cili është problemi i përbashkët i të gjitha këtyre kafshëve dhe bimëve? Kush i rrezikon ato më shumë dhe për ç'arsye? Çfarë do të ndodhë me to nëse nuk i mbron askush? Cilat janë mënyrat më të cilat mund të mbrohen ato? Si mund të ndihmojnë nxënësit për këtë gjë?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Me ndihmën e materialit të përgatitur (mësuesi përgatit enciklopeditë, fragmentet nga revistat që bëjnë fjalë për llojet e rrezikuara të kafshëve e të bimëve, tekstet e shkruara përkatëse nga interneti dhe nga manuallet ekologjike etj.) Nxënësit shkruajnë tregimin për llojin e rrezikuar të bimës ose të kafshës. Literatura e zgjedhur nuk duhet të ketë të bëjë patjetër me llojin e rrezikuar nga rajoni ynë.
2. Shkruajnë emrat poshtë figurave dhe zgjidhet rebusi (ylli i alpeve, dhia e egër, ujku).
3. Zgjidhet fjalë kryqi (leskërore, rrëqebulli, guaca, vidra, ujku, pelikani, kaprolli, tymi, zjarri). Zgjidhja është riciklimi. Mbi vijë shkruhet, se në ç'ambalazh kanë parë shenjën e riciklimit (në kënaçe, në fletore, në libër, në ambalazhin e çokollatës...) dhe ç'kuptim ka kjo shenjë (se prodhimi është krijuar me ripunim; me riciklim).

**Mjetet ndihmëse:** qeset prej letre, ngjitësi (zami).




# NË BREG TË DETIT

<b>Qëllimet:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen ujërat në vendbanimin e vet</li> <li>• të bëhet lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatin e tyre.</li> <li>• të vihen re kushtet e jetesës së kafshëve</li> <li>• të kuptohet rëndësia e ujit për qeniet e gjalla</li> <li>• të arrihet në përfundimin se të gjitha qenieve të gjalla u nevojitet për jetë: ushqimi, uji e ajri, si edhe mjedisi i shëndetshëm dhe i pa ndotur</li> <li>• të dallohen ujërat rrjedhëse dhe të ndenjura</li> <li>• të zhvillohet vetëdija ekologjike</li> </ul>
<b>Fjalët kyçe:</b>	brezi bregdetar, baticë, zbaticë, përshtatje, bota bimore e detit; alga e murrme, sallata e detit, algë, kafshët e detit; guaskë, kërmill, gaforre, karavidhe, oktapod, iriqi i detit, ylli i detit, peshk

## Veprimtaritë e propozuara:

1. Nxënësit nxirren në bregun e detit. Nëse nuk jetojnë afër detit, kjo gjë mund të bëhet në rastin e ndonjë pikniku ose në kohën e shkollës në natyrë. Bisedohet për bimët që ka nxjerrë deti në breg. Bëhet krahasimi me ndonjë nga bimët që rriten në tokë.
2. Vrojtohet alga në akuarium, d.m.th. mund të nxirret dhe të preket. Çdo të ndodhë me algën, kur është jashtë ujit? Alga kthehet përsëri në ujë.
3. Vrojtohen kafshët në bregun e detit dhe në cekëtinë. Emërtohen ato që njihen dhe përshkruhen; forma e trupit, mënyra e lëvizjes. Bëhen përpjekje që të kapen peshqit e vegjël. Thuhen shkaqet, pse kjo gjë është shumë e vështirë. Krahasohen kafshët e detit me kafshët që jetojnë në tokë; forma e trupit, mënyra e lëvizjes, të ushqyerit.
4. Në mëngjes, kur deti është i qetë, ngulin në plazh shkopin në vendin deri ku arrin uji. Gjatë ditës dhe në mbrëmje, ndjekin ngritjen e ujit.
5. Vrojtohet bota bimore dhe shtazore që lë deti pas baticës. Bëhen supozime, sesi mbeten të gjalla bimët dhe kafshët në të thatë. Si mund t'u ndihmojnë atyre nxënësit?
6. Vihen re në shkëmbinjtë kërmijtë, gaforret, guaskat dhe iriqët. Përshkruhet pamja e tyre, mënyra e lëvizjes dhe mbërthimi pas shkëmbit. Nxënësit tregojnë përvojën e vet të pakëndshme ose atë të tjerëve me iriqët ose me kafshët e tjera të detit.
7. Bisedohet me peshkatarin, me kultivuesin e guaskave (midhjeve) ose me zhytësin për profesionet e tyre. Çfarë është interesante në këtë profesion? Për çfarë duhet të tregojnë kujdes? Ç'pajisje përdorin? Ç'ndodhi interesante u kujtohet? Kur dalin më shpesh për të gjuajtur peshk? Si ndikojnë rrethanat e motit në profesionin e tyre? A mund ta parashikojnë vetë motin dhe si? Çfarë bëjnë, nëse gjenden në det në një mot të keq? Cilat nga kafshët e detit nuk duhet t'i gjuajnë dhe pse? A u duhet atyre leja e gjuetisë dhe nga kush e marrin? Çfarë bëjnë me peshkun që zënë?
8. Mblidhen guacat e guaskave, iriqëve dhe kërmijve. Përshkruhet pamja, ngjashmëritë dhe ndryshimet (përbëhet nga një pjesë, nga dy pjesë, e ashpër, e lëmuar, njëngjyrëshe...). Me materialin e mbledhur zbukurohen kutitë e mjeteve mësimore, stolitë etj.
9. Gjenden qelqe (xhama), të cilët i ka lëmuar uji i detit. Komentohet, se nga ka ardhur qelqi (xhami) në det dhe pse është bërë kështu i lëmuar.
10. Lexohen kuriozitetet për botën bimore dhe shtazore të detit. Kërkohen të dhënat për kafshët; cilat jetojnë në fundin e detit, cilat jetojnë poshtë sipërfaqes së ujit, cilat



jetojnë në cekëtinë, me çfarë ushqehen, si mbrohen nga armiqtë. Prej raportimeve më interesante hartohet Libri i klasës “Bota e detit”.

11. Vizatojnë dhe modelojnë, sipas dëshirës, kafshë të ndryshme deti.
12. Shihet filmi për botën nënujore të detit.

### **Puna me Tekstin mësimor:**

Shihen ilustrimet dhe lexohen tekstet e shkruara përkrah tyre. Në ç’pjesë të detit jetojnë kafshët e paraqitura në ilustrime? Kush është mbërthyer pas shkëmbit? Kush mund të mbijetojë në të thatë edhe me nga disa ditë? Guaska e kujt na kujton pjatën e vogël. Cilat kafshë e kapin ushqimin me tentakule? Me se mbrohet iriqi i detit? Si mbrohet oktapodi?

Çfarë do të ndodhë, nëse ylli i detit humbet një nga krahët? Cilat kafshë i janë përshtatur mjedisit me ngjyrën e trupit të vet? Pse e gjuajnë me kujdes peshkatarët shkërpim e kuq?

### **Puna me Fletoren e punës:**

1. Nga Shtojca nr. 6, priten fotografitë dhe ngjiten në vendet përkatëse (kafshët dhe bimët e detit, bimët e bregut të detit).
2. Shkruhet se çfarë mund të ndodhë në situatat e paraqitura në figura.
3. Lidhen se me çfarë ushqehen (guaska, oktapodi, peshku).



# PROPOZIMI I PLANIT VJETOR

JAVA	KAPITULLI	TEMA	NUMRI I ORËVE	QËLLIMET OPERATIVE
1.	Më shumë di, më shumë njohuri	Pas pushimeve	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihet rëndësia e trashëgimisë</li> <li>të dihen se cilat janë ujërat e vendbanimit</li> <li>të bëhet lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatin e tyre</li> <li>të vihet re sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën e vendbanimit të vet</li> </ul>
1. 2.	Më shumë dije, më shumë njohuri	Më shumë njohuri	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të kuptohet se për një mësim të suksesshëm nevojitet planifikimi i duhur i kohës</li> <li>të mësohet se si duhet të planifikohet në mënyrën e duhur koha për mësim, për lojë dhe për pushim</li> <li>të vihet re se krahas njohurive që merren në shkollë, mund të shfrytëzohen edhe burimet e tjera të njohurive (pjesëtarët e familjes, farefisi, libri, mediat)</li> <li>të dihet të bëhet planifikimi i veprimtarisë ditore</li> </ul>
2.	Më shumë dije, më shumë njohuri	Shtëpia e dijeve dhe e shoqërimit	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dihet emërtimi i lagjes ose i pjesës së qytetit në të cilin gjendet shkolla</li> <li>të dihet emërtimi i rrugës në të cilën gjendet shkolla</li> <li>të dihet të shpjegohet rruga deri në shkollë</li> <li>të dihet sesi është dukur shkolla në të kaluarën</li> <li>të vihen re dallimet në pamjen e shkollës dikur dhe sot</li> <li>të dihet sesi festohet Dita e shkollës</li> <li>të thuhet njerëzit me rëndësi të vendbanimit, që kanë qenë nxënës të shkollës.</li> <li>të dihet se në shkollë mund të luhet dhe të merresh me sport</li> <li>të dihet se në shkollë ekziston koha e punës, e veprimtarive të lira dhe e pushimit</li> </ul>

3.	Më shumë dije, më shumë njohuri	Rregullat dhe marrëveshjet	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të kuptohet se duhet të respektohen kërkesat dhe të drejtat e tjetrit në kolektiv</li> <li>të kuptohet se duhet të ruhet pasuria shkollore</li> <li>të zhvillohet ndjeshmëria për respektimin e rregullave kryesore të shkollës (frekuentimi i rregullt i mësimit, ardhja në kohë në mësime, sjellja në shkollë dhe jashtë shkollës)</li> <li>të arrihet në përfundimin se jeta në shkollë zhvillohet sipas orarit të caktuar, i cili duhet të respektohet detyrimisht</li> </ul>
3. 4.	Më shumë dije, më shumë njohuri	Shoqërimi dhe bashkëpunimi	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallohet kolektivi i klasës si komunitet</li> <li>të zhvillohet të diturit se në shkollë fitohen dije të reja, njohje të reja dhe miq të rinj</li> <li>të vihet re nevoja e bashkëpunimit dhe e tolerancës në kolektivin e klasës</li> <li>të kuptohet se përse duhet të respektohen kërkesat dhe të drejtat e tjetrit në kolektiv</li> <li>të kuptohet se shoqëria nënkupton gatishmërinë për ta ndihmuar tjetrin dhe për të bashkëpunuar me të</li> <li>të kuptohet se në shkollë mund të kërkohet ndihma e mësuesit, e psikologut, e pedagogut, e bibliotekarit dhe e logopedit</li> </ul>
4.	Më shumë dije, më shumë njohuri	Gjyshja ka ditëlindjen	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallohet familja si komunitet</li> <li>të dallohen profesionet e prindërve e të kushërinjve</li> <li>të vihet re nevoja e bashkëpunimit dhe e tolerancës ndërmjet anëtarëve të familjes</li> </ul>

5.	Më shumë dije, më shumë njohuri	Albumet na tregojnë	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallohen e të vlerësohen sendet që i kanë takuar të parëve të nxënësve (reliktet, stolitë dhe veshjet e vjetra)</li> <li>të njihet mënyra e jetesës, e veshjes dhe e argëtimit e gjysheve dhe e gjyshave</li> </ul>
5. 6.	Profesioni dhe hobi	Punët që bën Jovani	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re se disa punë kryhen sepse duhet, ndërsa disa të tjera, sepse ashtu dëshirohet</li> <li>të dallohet puna si veprimtari e domosdoshme nga veprimtaria e lirë</li> <li>të vihet re se të rriturve u duhet të punojnë dhe të fitojnë për të siguruar jetesën</li> <li>të dallohen disa lloje profesioneesh</li> <li>të dallohet profesioni nga hobi</li> <li>të dallohen profesionet e veçanta të prindërve e të kushërinjve të vet</li> </ul>
6.	Profesioni dhe hobi	Dëshiroj të bëhem	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re se njerëzit e vendbanimit kanë detyrimet, të drejtat dhe detyrat e tyre</li> <li>të nxirret përfundimi se të rriturit duhet të punojnë e të fitojnë për të jetuar</li> <li>të emërtohen disa nga profesionet karakteristike për ndërtesat në vendbanimin e vet</li> <li>të vihet re se në qytet ekzistojnë ndërtesat që janë të rëndësishme për jetën e të gjithë banorëve</li> <li>të dallohet funksioni kryesor i ndërtesave të rëndësishme</li> </ul>
7.	Profesioni dhe hobi	Blejmë	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të kuptohet rëndësia e të hollave</li> <li>të arrihet në përfundimin se të rriturit duhet të punojnë dhe të fitojnë për të jetuar</li> <li>të dihet se të hollat fitohen si shpërblim për punën e kryer</li> <li>të njihen njësitë kryesore monetare (monedhat metalike dhe kartëmonedhat)</li> </ul>

7. 8.	Profesioni dhe hobi	Në fabrikë	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të arrihet në përfundimin se njerëzit i prodhojnë të mirat materiale të cilat u nevojiten për të jetuar</li> <li>• të dihet se njerëzit janë edhe konsumatorët e të mirave materiale që prodhojnë</li> <li>• të vihet re se gjatë prodhimit krijohen edhe mbeturinat dhe të bëhet ndërgjegjësimi për nevojën dhe për rëndësinë e kujdesit për mjedisin</li> <li>• të emërtohen disa nga profesionet karakteristike</li> </ul>
8.	Profesioni dhe hobi	Ndihmojmë edhe ne	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihet re nevoja e bashkëpunimit dhe e tolerancës midis njerëzve</li> <li>• të vihet re se çdo njeri jeton në një komunitet të caktuar dhe se askush nuk mund të jetojë i vetëm</li> <li>• të dallohen disa tipa të komuniteteve: familja, kolektivi i klasës (paraleles), banorët e pallatit</li> <li>• të vihet re se është mirë që njerëzit e ndihmojnë njëri-tjetrin</li> <li>• të zhvillohet ndjenja e solidaritetit</li> <li>• të vihet re se komuniteti mbijeton nëse ekziston toleranca, barazia dhe respekti reciprok</li> </ul>
9.	Në fshat dhe në qytet	Moti ndryshon	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihen re ndryshimet tek bimët në varësi të stinëve të vitit</li> <li>• të dallohen bimët gjetherënëse dhe gjethembajtëse</li> <li>• të vihet re se veprimtaritë e kafshëve ndryshojnë në varësi të stinëve të vitit</li> <li>• të kuptohet se për jetën e bimës janë të nevojshëm uji, drita dhe ajri</li> <li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën</li> <li>• të zhvillohet vetëdija ekologjike</li> </ul>

9. 10.	Në fshat dhe në qytet	Në tregun e fruta- perimeve	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen nga nxënësit frutat, perimet dhe drithërat</li> <li>• të vihet re lidhja ndërmjet bimëve dhe habitateve të tyre</li> <li>• të njihen disa bimë zbukuruese</li> <li>• të njihet lidhja midis bimëve, kafshëve dhe habitateve të tyre</li> <li>• të kuptohet se për jetën e bimëve nevojitet uji, drita, ajri dhe dheu</li> <li>• të kuptohet se toka duhet të mbrohet nga ndotja</li> <li>• të vihet re se komunikacioni mundëson transportin e njerëzve e të mallrave</li> </ul>
10. 11.	Në fshat dhe në qytet	Në fermën blegtorale	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen kafshët e vendbanimit</li> <li>• të arrihet në përfundimin se bimët janë ushqim për kafshët</li> <li>• të njihen kushtet për jetesën e kafshëve shtëpiake</li> <li>• të arrihet në përfundimin se disa kafshë janë kanakarë</li> <li>• të emërtohen profesionet (blegtor, veteriner)</li> <li>• të vihet re se veprimtaria e kafshëve ndryshon në varësi të stinëve të vitit</li> </ul>
11. 12.	Në fshat dhe në qytet	Vendbanimi im	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të vihet re zhvillimi i vendbanimit ku jetohet</li> <li>• të shpjegohet sipas kujt apo sipas ç'gjëje është emërtuar vendbanimi</li> <li>• të dallohet lagjja e vet në vendbanimin ku jetohet</li> <li>• të njihen emërtimet e lagjeve të tjera të vendbanimit</li> <li>• të vihet re se ekzistojnë vendbanimet e mëdha dhe vendbanimet e vogla</li> <li>• të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit mbi ndryshimet në natyrën e vendbanimit</li> <li>• të njihen problemet kryesore lidhur me ndotjet në vendbanimin e vet</li> </ul>

12. 13.	Në fshat dhe në qytet	Festojmë	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen festat në vendbanimin e vet dhe mënyra e kremtimit të tyre</li> <li>të emërtohen festat: Dita e Shkollës, Dita e vendit, festat më të rëndësishme fetare, Viti i Ri, Dita e Gruas, Dita e Punës...</li> <li>të njihen kremtimet e ndryshme që organizohen në vendbanim (balloja me maska, karnavali, Ditët e kulturës ...).</li> </ul>
13.	Në fshat dhe në qytet	Rruga "Njegosh"	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihet rëndësia e trashëgimisë</li> <li>të dallohen ndryshimet në pamjen e vendbanimit</li> <li>të njihen disa nga personalitetet e shquara të së kaluarës që janë të lidhura në një farë mënyre me vendbanimin</li> </ul>
14.	Në fshat dhe në qytet	Udhëtojmë	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re se komunikacioni mundëson transportin e njerëzve dhe të mallrave</li> <li>të dihet sesi zhvillohet komunikacioni në vendbanim</li> <li>të dihet se me ç'mjete komunikacioni qarkullohet</li> <li>të tregohet sjellja e rregullt në mjetet e komunikacionit publik</li> <li>të emërtohen profesionet karakteristike në komunikacion</li> <li>të dallohet sjellja e rregullt dhe e parregullt në rrugën nga shtëpia deri në shkollë</li> <li>të shpjegohet sesi rregullohet qarkullimi rrugor</li> <li>të parashikohen pasojat e mosrespektimit të rregullave në qarkullimin rrugor</li> </ul>
15.	Shoh dhe dëgjoj	Shikoj, shoh	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të arrihet në përfundimin se drita vihet re me anë të shikimit dhe se syri është organi i të parit</li> <li>të dallohet largësia në vendbanim (gjatësia)</li> <li>të dihet rëndësia e ruajtjes së syrit të shëndoshë</li> </ul>

15. 16.	Shoh dhe dëgjoj	Vë vesh, dëgjoj	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallohen burimet e zërit</li> <li>të mësohet sesi krijohet zëri (me vibrimin e trupit)</li> <li>të arrihet në përfundimin se veshi është organi i shqisës së të dëgjuarit.</li> <li>të kuptohet rëndësia e ruajtjes së shëndetit të veshit.</li> </ul>
16. 17.	Shoh dhe dëgjoj	Kujdesem për shëndetin	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen masat parandaluese, mjekimi dhe kujdesi për të sëmurët</li> <li>të dihet se disa sëmundje i shkaktojnë qeniet tepër të vogla (mikrobet)</li> <li>të dihen sëmundjet më të shpeshta të fëmijëve</li> <li>të zhvillohet mirëkuptimi për ruajtjen e shëndetit</li> <li>të emërtohen disa profesione të rëndësishme për ndërtesat kryesore në vendbanim</li> <li>të njihet rëndësia e vaksinimit</li> </ul>
17. 18.	Shoh dhe dëgjoj	Ku ka ajër	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re se ajri ndodhet kudo rreth nesh</li> <li>të arrihet në përfundimin se ajri mund të jetë i ndotur dhe, si i tillë, ai është i dëmshëm për shëndetin</li> </ul>
18.	Shoh dhe dëgjoj	Uji ka avulluar	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re sesi ndryshon materia në ndikimin e ajrit dhe të dritës</li> </ul>
19.	Shoh dhe dëgjoj	Sheqeri është tretur	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re sesi ndryshon materia në ndikimin e ujit</li> </ul>
19. 20.	Mjedisi im	Malet dhe fushat	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen sipërfaqet e tokës në vendbanimin e vet</li> <li>të dallohen sipërfaqet e rrafshëta dhe jo të rrafshëta</li> <li>të arrihet në përfundimin se sipërfaqja e tokës mund të jetë e punueshme dhe e papunueshme</li> <li>të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit në ndryshimet në natyrën e vendbanimit</li> <li>të vihet re se sipërfaqja e tokës duhet të mbrohet nga ndotja</li> </ul>



20. 21.	Mjedisi im	Nga burimi deri tek grykëderdhja	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen ujërat përreth vendbanimit</li> <li>të dallohen ujërat e ndenjura nga ujërat rrjedhëse</li> <li>të vihet re se ujërat mund të ndoten</li> <li>të nxirret përfundimi se për pirje përdoret uji i pastër</li> <li>të kuptohet rëndësia e ujit për qeniet e gjalla</li> <li>të arrihet në përfundimin se uji duhet të kursehet</li> <li>të vihet re lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatet e tyre.</li> <li>të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit ndaj ndryshimeve në natyrën e vendbanimit</li> </ul>
21. 22.	Mjedisi im	Era dhe shiu	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallohen dukuritë e motit; erë, reshje</li> <li>të paraqiten të dhënat e grumbulluara me tabela dhe në formën e histogramit</li> <li>të përdoren materialet e ndryshme për punimin e sendeve (objekteve) të ndryshme</li> <li>të lidhen materialet e ndryshme dhe mjetet përkatëse të punës</li> <li>vihen re mbeturinat dhe hiqen ato nga vendi i punës</li> <li>të njihet parashikimi i motit</li> </ul>
22.	Mjedisi im	Po vjen pranvera	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihen re ndryshimet tek bimët në varësi të stinës së vitit</li> <li>të dallohen bimët gjethembajtëse dhe gjetherënëse</li> <li>të vihet re se veprimtaritë e kafshëve ndryshojnë në varësi të stinës së vitit</li> <li>të kuptohet se për jetën e bimëve nevojitet uji, drita dhe ajri</li> <li>të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit mbi natyrën</li> <li>të zhvillohet ndërgjegjja ekologjike</li> </ul>
23.	Mjedisi im	Kompjuteri	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen nxënësit me llojet e ndryshme të transmetimit të informacioneve</li> <li>të njihet përdorimi i disa llojeve të transmetimit të informacioneve</li> <li>të mësohet që të ruhen disa të dhëna të medieve të ndryshme</li> </ul>

23. 24.	Mjedisi im	Grumbullojmë të dhënat	2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen mënyrat e ndryshme të transmetimit të informacioneve</li> <li>• të mësohet përdorimi i ndonjërit nga llojet e transmetimit të informacioneve</li> <li>• të zhvillohet aftësia për komunikimin me grafik</li> </ul>
24. 25.	Mjedisi im	Matim kohën	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të nxirret përfundimi se mbi lëvizjen mund të ndikohet (të ndryshohet drejtimi, kahja, shpejtësia)</li> <li>• të vihet re ndryshimi i lëvizjes në raport me ndikimin e jashtëm</li> <li>• të njihen mënyrat e matjes së kohës</li> <li>• të dihet të bëhet planifikimi i veprimtarive ditore</li> <li>• të përdoren materialet e ndryshme për punimin e sendeve të veçanta</li> <li>• të bëhet lidhja midis materialeve dhe mjeteve përkatëse të punës</li> <li>• të vihen re mbeturinat dhe të mënjanojnë ato nga vendi i punës</li> </ul>
25. 26.	Ku jetojnë?	Nën hijen e lisit	4	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen bimët karakteristike të vendbanimit</li> <li>• të vihet re lidhja e bimëve me habitatet e tyre</li> <li>• të vihet re lidhja ndërmjet bimëve dhe kafshëve</li> <li>• të dallohen bimët gjetherënëse dhe gjethembajtëse</li> <li>• të dallohen bimët ngrënëse dhe jongrënëse</li> <li>• të njihen disa nga bimët mjekësore të vendbanimit</li> <li>• të zhvillohet vetëdija ekologjike</li> </ul>

26. 27.	Ku jetojnë?	Banorët e pyllit	4	<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen kafshët shtëpiake të vendbanimit</li> <li>të lidhen kafshët dhe habitatet e tyre</li> <li>të dallohen kafshët shtëpiake dhe kafshët e egra</li> <li>të dallohen lidhjet reciproke midis qenieve të gjalla</li> <li>të arrihet në përfundimin se bimët janë ushqim për kafshët dhe se disa kafshë janë mishngrënëse</li> <li>të vërehen kushtet për jetesë të kafshëve.</li> <li>të vihet re se veprimtaritë e kafshëve ndryshojnë në varësi të stinëve të vitit</li> <li>të vihet re se të gjitha qenieve të gjalla u duhet për jetesë: ushqimi, uji dhe ajri, si edhe u nevojitet mjedisi i shëndetshëm dhe i pandotur</li> </ul>
28.	Ku jetojnë?	Lindja dhe Perëndimi	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të vihet re se dielli lind në Lindje dhe perëndon në Perëndim</li> <li>të emërtohen objektet karakteristike në Lindje dhe në Perëndim në raport me shkollën</li> <li>të përcaktohet Lindja dhe Perëndimi në raport me shtëpinë/banesën ku jetohet.</li> <li>të përcaktohet pozicioni i shtëpisë/ banesës së vet në vendbanim</li> </ul>
29.	Ku jetojnë?	Gjithnjë e më pak ka prej tyre	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>të bëhet lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatet e tyre</li> <li>të arrihet në përfundimin se qenieve të gjalla u nevojitet, ushqimi, uji dhe ajri, si edhe mjedisi i shëndetshëm dhe i pandotur</li> <li>të shpjegohet sesi ndikojnë njerëzit ndaj ndryshimeve të natyrës në vendbanimin e vet</li> <li>të njihen nxënësit me problemet më të rëndësishme lidhur me ndotjen në vendbanimin e vet</li> <li>të vihet re lidhja reciproke midis qenieve të gjalla</li> </ul>

30.	Ku jetojnë?	Në breg të detit	<p>3</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen ujërat në vendbanimin e vet</li> <li>• të bëhet lidhja e bimëve dhe e kafshëve me habitatin e tyre.</li> <li>• të vihen re kushtet e jetesës së kafshëve</li> <li>• të kuptohet rëndësia e ujit për qeniet e gjalla</li> <li>• të arrihet në përfundimin se të gjitha qenieve të gjalla u nevojitet për jetë: ushqimi, uji e ajri, si edhe mjedisi i shëndetshëm dhe i pandotur</li> <li>• të dallohen ujërat rrjedhëse dhe të ndenjura</li> <li>• të zhvillohet vetëdija ekologjike</li> </ul>
-----	-------------	------------------	---



## LITERATURA:

S. B. Blum: *Таксоманија или класификација образовних и одгојних циљева*, Libri 1. – коиниивно погручје, Enti i Republikës për Zhvillimin e Edukimit dhe të Arsimit, Beograd, v. 1981

U. Bronfrenbrenner: *Is early intervention effective? Fakts and principles of early intervention: a summary*, v. 1974

Xh. Bruner: *Процес образовања. Психолоија у насшави*. Përmbledhja e punimeve të psikologjisë pedagogjike nr. 4. Beograd, v. 1988

K. Burk-Volsh: *Сшваране средине за учење усмерено на геше*, klasa I, Qendra e Pedagogjisë Interaktive, Beograd, v. 2003

Zh. Delor: *Образовање скривена ризница*, Beograd, UNESCO, v. 1996.

J. Delors: *Учење: скривено блао*, Ministria e Shkollimit dhe e Sportit, Lubljanë, v. 1996

Grup autorësh: *Да земља осшане зелена*, Shoqata e ekologëve të rinj të Malit të Zi, Podgoricë, v. 1988

I. Iviq dhe bashkëpunëtorët: *Акшивно учење*, Instituti i Psikologjisë, Fakulteti i Filozofisë, Beograd, v. 2001

I. Iviq, A. Peshikan, S. Antiq: *Водич за добар уџбеник, ошшш сшандарди квалишеша уџбеника*, Platonium, Novi Sad

M. Klarin: *Развој гјеце у социјалном коншекшш*, Universiteti i Zadrit, Naklada sklap. Jastrebarsko, v. 2006

R. Krofliq: *Evalvacija visokoškolskega kurikuluma kot sestavni del planiranja*, Sadobna pedagogika, nr. 5-6, v. 1994

*Креирање васшшшно-образовног шроцеса у којем дијеше има ценшралну улош*, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi.

N. Llaketa, D. Vasilijeвиq: *Основе дидакшике*, Fakulteti i Mësuesisë., Uzhicë, v. 2006

L. Llevkov: *Школски шрошрам (курукулум) и уважавање различшшосшш*; në J. Шефер, С. Максиш dhe С. Јоксимовиш (map.), *Уважавање различшшосшш и образовање*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Beograd, v. 2003

A. N. P. Klermon: *Социјална иншеракција и иншелекшшални развој*, ZUNS, Beograd, v. 2003

*Марзанова шаксономија или научишш како учишш*, Shkolla jonë, Enti i Shkollimit, Podgoricë, v. 2008

S. Mirkov: *Мешакоиниција у образовном сисшему*, Beograd, IPA, nr.1, v. 2006

S. Miliq: *“Индивидуализовани присшшш у васшшшно-образовном шроцесу”*, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi, Podgoricë, 2002

B. Pavlloviq: *Колико је шожелно гечје шшшане у школи*, Përmbledhja e Institutit të Studimeve Pedagogjike, Beograd, v. 2001

J. Peshiq: *Проблемски дискурс уџбеника*, Psikologjia, vëll. 38, nr. 3, fq. 225-237, v. 2005


A. Polak: *Тимско дело v šoli – zakaj, kdo i kako*, Lubljanë, Fakulteti Pedagogjiki Universitetit të Lubljanës, v. 1998

Zh. Piazhe, B. Inhelder: *“Иншелекшшални развој гешеша”*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, v. 1982

S. Razdevshek-Пуqко: *Usposobljanje učiteljev za programsko prenovu osnovne šole*, Në përmbledhjen e studimeve të Kongresit të punonjësve të pedagogjisë të Sllovenisë. V. 1997

Xh. Rotçild, Xh. E. Denijels: *Машеријали и акшивносшш за рад у учионицама у којима дијеше има ценшралну улош*, Qendra Pedagogjike e Malit të Zi, viti, 2002

Z. Rutar Ilc; *Opisni kriteriji kot pogoj kvalitetno povratno informacije*, Lubljanë, në



Problemi ocjenivanja in devetletna osnovna šola, Fakulteti i Pedagogjisë dhe Enti i Shkollimit i RS, v. 2000

Z. Rutar Ilc; S. Sentoçnik: *Koncept znanja, učenje za razumjevanje*, Lubljanë, në Modele të mësimit dhe të edukimit, Përmbledhje e studimeve, Enti i Shkollimit i RS, v. 2001.

M. Scott: *Ekologija*, Tehniška založba Slovenije, Lubljana, 1994

N. Suziq: *Унуџрашња и вањска моџивација у школском посџиџнућу*, Arsimi dhe Edukimi, Podgoricë, nr. 4. Podgoricë, v. 2006

J. Shefer: *Креативне активносџи у џемаџској насџави*, IPA, Beograd, v. 2005

V. Taylor: *Veliki slikovni atlas živali*, Mladinska knjiga, Ljubljanë, 1994

S. L. Vigotski: *Мишљење и џовор*, Nolit, Beograd, v. 2001

S. L. Vigotski: *Когнитивни развој детета*; Пërmbledhja e punimeve të psikologjisë së zhvillimit, Lidhja e Shoqatave të psikologëve të RS të Serbisë, Beograd, 1986

I. Zdanski: *Насџава у џрипроги*, Beograd, v. 1998